



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCE

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM
2008-2010

Paraqitur per informacion Kuvendit

Tetor 2007

Tabela e Permbajtjes

HYRJE	4
A.1 ROLI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM (PBA).....	4
A.2 PBA DHE STRATEGJIA KOMBETARE PER ZHVILLIM DHE INTEGRIM.....	4
A.3 PROCESI I PERGATITJES SE PBA-SE 2008-2010	5
A.3.1 Rishikimi i Politikes se Programit (RPP).....	5
A.3.2 Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve te Programit (PSHIP).....	5
A.3.3 Kerkesat per Shpenzime te PBA	6
A.3.4 Kerkesat Shtese per Shpenzime te PBA.....	6
A.3.5 Miratimi i PBA	6
A.3.6 Roli i Ministrise se Financave.....	6
A.3.7 Roli i Komitetit te Planifikimit Strategjik	6
B. KUADRI MAKROEKONOMIK DHE BUXHETOR PER PERIUDHEN 2008 - 2010	8
B.1 VLERESIMI I PËRGJITHSHËM MAKROEKONOMIK PËR VITIN 2006.....	8
B.2 ECURIA E TREGUESVE MAKROEKONOMIKE PËR VITIN 2007	9
B.2.1 Sektori real:.....	9
B.2.2 Sektori monetar:.....	10
B.2.3 Sektori i jashtem:	11
B.2.4 Punësimi:	11
B.2.5 Sektori fiskal:	12
B.3 PARASHIKIMET MAKROEKONOMIKE 2008-2010	13
B.4 KUADRI BUXHETOR 2008-2010	17
B.4.1 Te Ardhurat Buxhetore.....	17
B.4.2 Shperndarja e Shpenzimeve Buxhetore.....	20
C. PROGRAMET BUXHETORE AFATMESME TE MINISTRIVE	24
C.1 MINISTRIA E SHENDETESISE	24
C.1.1 Misioni i Ministrise:.....	24
C.1.2 Qellimet e Politikes:.....	24
C.1.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise.....	24
C.1.4 KOMENTET E MINISTRISE SE FINANCE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISE SE SHENDETESISE	31
C.2 MINISTRIA E DREJTESISE.....	33
C.2.2 Qellimet e Politikes:.....	33
C.2.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise.....	33
C.2.4 KOMENTET E MINISTRISE SE FINANCE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISE SE DREJTESISE	43
C.3 MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE.....	45
C.3.1 Misioni i Ministrise.....	45
C.3.2 Qellimet e Politikes:.....	45
C.3.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise.....	45
C.3.4 KOMENTET E MINISTRISE SE FINANCE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISE SE MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE	53
C.4 MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJITIKES.....	54
C.4.1 Misioni i Ministrise:.....	54
C.4.2 Qellimet e Politikes:.....	54
C.4.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise.....	54
C.4.4 KOMENTET E MINISTRISE SE FINANCE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISE SE EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES.....	63
C.5 MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME.....	64
C.5.1 Misioni i Ministrise:.....	64
C.5.2 Qellimet e Politikes	64
C.5.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise.....	64
C.5.4 KOMENTET E MINISTRISE SE FINANCE LIDHUR ME KERKESEN.....	70
PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISE SE PUNEVE TE JASHTME.....	70
C.6 MINISTRIA E MBROJTJES.....	71
C.6.1 Misioni i Ministrise:.....	71

C.6.2 Qellimet e Politikës	71
C.6.3 Programet e Shpenzimeve të Ministrisë	71
C.6.4 KOMENTET E MINISTRISË SE FINANCAVE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISË SE MBROJTJES	82
C.7 MINISTRIA E PUNES, CESHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TE BARABARTA.....	83
C.7.1 Misioni i Ministrisë:	83
C.7.2 Qellimet e Politikës	83
C.7.3 Programet e Shpenzimeve të Ministrisë	83
C.7.4 KOMENTET E MINISTRISË SE FINANCAVE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISË SE PUNES, CESHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TE BARABARTA	92
C.8 MINISTRIA E INTEGRIMIT EUROPIAN	93
C.8.1 Misioni i Ministrisë	93
C.8.2 Qellimet e Politikës	93
C.8.3 Programet e Shpenzimeve të Ministrisë	93
C.8.4 KOMENTET E MINISTRISË SE FINANCAVE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISË SE INTEGRIMIT EUROPIAN	98
C.9 MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE.....	99
C.9.1 Misioni i Ministrisë:	99
C.9.2 Qellimet e Politikës:	99
C.9.3 Programet e Shpenzimeve të Ministrisë	99
C.9.4 KOMENTET E MINISTRISË SE FINANCAVE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISË SE TURIZMIT, KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE	106
C.10 MINISTRIA E FINANCAVE	107
C.10.1 Misioni i Ministrisë:	107
C.10.2 Qellimet e Politikës:	107
C.10.3 Programet e Shpenzimeve të Ministrisë	108
C.10.4 KOMENTET E MINISTRISË SE FINANCAVE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISË SE FINANCAVE	121
C.11 MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT	123
C.11.1 Misioni i Ministrisë:	123
C.11.2 Qellimet e Politikës:	123
C.11.3 Programet e Shpenzimeve të Ministrisë	124
C.11.4 KOMENTET E MINISTRISË SE FINANCAVE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISË SE BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT (MBUMK)	136
C.12 MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES	138
C.12.2 Qellimet e Politikës	138
C.12.3 Programet e shpenzimeve të Ministrisë	139
C.12.4 KOMENTET E MINISTRISË SE FINANCAVE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISË SE MINISTRISË E ARSIMIT DHE SHKENCES (MASH)	151
C.13 MINISTRIA E BRENDSHME	152
C.13.1 Misioni i ministrisë:	152
C.13.2 Qellimet e Politikës	152
C.13.3 Programet e Shpenzimeve të Ministrisë	152
C.13.4 KOMENTET E MINISTRISË SE FINANCAVE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISË SE BRENDSHME	165
C.14 MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT	166
C.14.2 Qellimet e Politikës	166
C.14.3 Programet e Shpenzimeve të Ministrisë	167
C.14.4 KOMENTET E MINISTRISË SE FINANCAVE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISË SE PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT	186
D. TAVANET E SHPENZIMEVE BUXHETORE, KERKESAT PER PERIU DHEN 2008-2010 DHE ALOKIMET SIPAS KM PER 2008.....	187
ANEKSI 1	189

PERMBLEDHJE

Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesem (PBA) 2008-2010 perben finalizimin e fazes se dyte te procesit te pergatitjes se Dokumentit te Programit Buxhetor Afatmesem 2008-2010, proces ky i iniciuar permes dy vendimeve te Komitetit te Planifikimit Strategjik (KPS) per percaktimin e Kuadrit Makro-Fiskal 2008-2010 dhe Tavanave Pergatitore te PBA 2008-2010.

Kete vit kerkesat buxhetore te ministrive te linjes jane paraqitur ne menyre me te plote ne krahasim me vitin e kaluar, si edhe brenda afateve te percaktuara ne ligjin organik te buxhetit. Gjithashtu, i gjithë procesi kete vit eshte drejtuar dhe koordinuar nga Grupi per Strategji Buxhet dhe Integrim (GSBI), i cili eshte ngritur ne cdo ministri linje ne baze te Urdherit te Kryeministrit Nr.78, Date 8.5.2006, ku nje rol te vecante ka luajtur koordinatori i GSBI-se (Sekretari i Pergjithshem) ne cdo ministri.

Gjithashtu, ne vitin 2007 ne programin buxhetor afatmesem, pervec 14 ministrive te linjes, u perfshine edhe institucionet buxhetore ne vijim: Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit te Pronave, Drejtoria e Rezervave te Shtetit, Instituti i Sigurimeve Shoqerore, Drejtoria e Metrologjise dhe Kalibrimit dhe Drejtoria e Standartizimit.

Duhet theksuar se, nje prej objektive kryesore te procesit te PBA-se eshte perputhshmeria e buxhetit vjetor me vitin e pare te PBA-se. Ky vit shenoj permiresim te ndjeshem te kerkesave buxhetore ne kete drejtim. Megjithate, si nje process qe perfshiu per here te pare te gjitha ministrive te linjes, bashke me agjensite e tyre vartese, mbetet ende per t'u permiresuar ne menyre qe te siguroje vleren e plote te planifikimit qe pritet. Gjithashtu, kjo vjen edhe si pasoje e nje sere faktoresh te tilla si ndryshimi i kuadrit makro-fiskal si rezultat i realizimit te te ardhurave apo identifikimi i politikave te reja prioritare.

Dokumenti i PBA 2008-2010 paraqet ne detaje qellimet, objektivat dhe produktet e programeve te seciles prej Ministrive te Linjes, ne nivel programi per vitet 2008, 2009 dhe 2010. Keshtu, ky dokument ka mundur te realizoje per nje kuader afatmesem lidhjet mes qellimeve dhe objektiveve te politikave, me alokimin e burimeve buxhetore, perkatesisht ne nivel programi.

Gjykojme se me rritjen progresive te vemendjes kushtuar procesit te PBA-se, kapaciteti i menaxhimit te tij do te permiresohet vazhdimisht me kalimin e kohes. Gjithashtu, Sistemi i Planifikimit te Integruar, dhe vecanerisht miratimi i Strategjise Kombetare per Zhvillim dhe Integrim, do te sherbejne mjaft per te forcuar procesin e PBA-se, nepermjet sigurimit te informacionit te nevojshem ne nivel strategjik te politikave.

Ne vijim, dokumenti i PBA 2008-2010 eshte i strukturuar ne kater kapituj. Kapitulli i pare pershkruan rolin e PBA-se si nje instrument i menaxhimit te shpenzimeve publike, si pjese perberese e Sistemit te Planifikimit te Integruar si edhe, termat kohore qe procesi i PBA-se ka ndjekur gjate vitit buxhetor. Kapitulli i dyte pershkruan kuadrin makroekonomik dhe fiskal, te ardhurat dhe shpenzimet buxhetore te parashikuara per periudhen 2008-2010. Ndersa, kapitulli i trete paraqet ne menyre te permbledhur informacionin e siguruar nga Ministrit e Linjes lidhur me PBA 2008-2010 dhe konkretisht, qellimet dhe objektivat e politikave per secilin prej programeve te tyre per vitet 2008, 2009 dhe 2010. Kapitulli i katert prezanton alokimet e shpenzimeve buxhetore per cdo artikull ne nivel ministrie dhe alokimin e shpenzimeve buxhetore per cdo ministri ne nivel programi per vitet 2008-2010.

Hyrje

A.1 Roli i Programit Buxhetor Afatmesem (PBA)

1. Programi Buxhetor Afatmesem është një instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent kyç i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ai është rezultat i dy proceseve: Rishikimit të Politikave dhe Planifikimit të Shpenzimeve. Planet e shpenzimeve hartohen nga ministrat e linjes brenda burimeve që Qeveria ka në dispozicion. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjere lidhur me planet e shpenzimeve të Qeverisë për tre vitet e ardhshme të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të Buxhetit Vjetor.
2. Qellimet kryesore të PBA janë:
 - *Inkurajimi i efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike;*
 - *Lidhje e drejtperdrejtë ndërmjet prioritetëve strategjiko-politike të Qeverisë me shpërndarjen e burimeve publike dhe kryerjen e shpenzimeve publike;*
 - *Promovimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal;*
 - *Zgjerimi i vizionit të procesit buxhetor duke siguruar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3 vjeçare)*
3. Dokumenti i PBA hartohet nga Ministria e Financave dhe i jep mundësinë Keshillit të Ministrave për të zhvilluar një kuadër të qartë burimesh brenda periudhës afatmesme që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale publike.
4. Gjithashtu, ai i shërben ministrave të linjes pasi mundëson përcaktimin prej tyre të politikave dhe programeve në një strukturë koherente si dhe mundësinë për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritare në periudhën afatmesme.
5. Duhet theksuar gjithashtu që procesi i hartimit të PBA është i orientuar mbi bazën e performancës. Përparesitë e kësaj mënyre të re të konceptimit të planifikimit të shpenzimeve konsistojnë në përfundimin e:
 - *Kontributit të qartë të produkteve në përmbushjen e objektivave të politikës;*
 - *Produkteve të matshme;*
 - *Aktivitetet e kostueshme.*

A.2 PBA dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

6. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, me një horizont planifikimi prej 7 vitesh, përcakton strategjitë dhe synimet afatshkurtra dhe afatgjata për të gjithë sektorët, bazuar në një vizion kombëtar. Në SKZHI përfshihen gjithashtu aspiratat për Integrimin Europian dhe atë në NATO.
7. Për procesin e PBA-së 2008-2010, elementi strategjik i PBA-së u sigurua nëpërmjet konsultimit të strategjive sektorale dhe ndërsektorale përgjatë procesit të Rishikimit të Politikës së Programit – përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave për çdo program shpenzimesh të çdo ministrie. Ky proces u ndërmorr nga një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Integritetit dhe Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, në Kryeministri.

A.3 Procesi i Pergatitjes se PBA-se 2008-2010

8. Tabela 1 paraqet ne menyre te permblendhur hapat kryesore ne procesin e pergatitjes se PBA-se 2008-2010, te ndermarre ne perputhje me kalendarin e Sistemit te Planifikimit te Integruar te miratuar nga Komiteti i Planifikimit Strategjik në mbledhjen e datës 16 mars 2007.

Tabela 1 Fazat e Pergatitjes se PBA-se

FAZAT	KOHA	PERSHKRIM
1. Kuadri makroekonomik, vendosja e prioriteteve dhe pergatitja e tavanëve të PBA-se per secilen ministri	Tremujori I	- Pergatitja e tavanëve të pergjithshme dhe vendosja e treguesve makroekonomike permes parashikimit makroekonomik. - Identifikimi i prioriteteve të politikave dhe zerave me ndikim të rendesishem ne shpenzime e të ardhura (pagat, transfertat vendore, programet e reja, projektet kryesore të investimeve publike) - Vendosja e tavanëve per gatitore të PBA-se - Pergatitja e Udhezimit per Pergatitjen e Buxhetit.
Qeveria miraton parashikimin makro, tavanet e pergjithshme dhe tavanet per gatitore të PBA-se 3-vjecare per cdo ministri		
2. Rishikimi i Politikës së Programit (RPP).	Tremujori II	Ministritë vendosin politikat per cdo program dhe identifikojne qellimet dhe objektivat e programit.
3. Plani i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP).	Tremujori II	- Brenda tavanëve të percaktuara, ministritë zhvillojne PSHIP duke identifikuar produktet dhe duke i kostuar aktivitetet ne baze të fondeve ne dispozicion per cdo program. - Dorezimet e PBA-se janë plotësisht të reflektuara ne Planin e Integruar të Ministrisë.
Qeveria miraton draftin teknik të PBA		
4. Pergatitja e Buxhetit	Tremujori III	- Pergatitja e Udhezimit Plotësues per Pergatitjen e Buxhetit. - Ministritë paraqesin buxhetet e detajuara.
Qeveria miraton draftin perfundimtar të PBA dhe projekt ligjin e buxhetit dhe i dergon ne Kuvend perkatesisht per informim dhe miratim		
5. Shqyrtimi ne Kuvend	Tremujori IV	Shqyrtimi dhe miratimi i ligjit vjetor të buxhetit nga Kuvendi.

Shenim: PBA publikohet ne fillim të vitit pas miratimit të ligjit vjetor të buxhetit nga Kuvendi.

A.3.1 Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)

9. Nevoja kryesore per një manaxhim efektiv të financave publike është percaktimi i qarte i politikave. Per politikat e reja kjo mund të arrihet nepermjet zbatimit të një procesi të mire të percaktimit të politikave, domethene nepermjet permiresimit të hartimit të politikave.
10. Ne praktike, procesi i hartimit të politikave nuk ka qene gjithmone i frytshem persa i perket qartësisë së politikave. Procesi i PBA-se merr një rendesi paresore ne perpjekjet e qeverisë per të lidhur buxhetin vjetor me politikat e tij. Per të arritur kete, politikat duhet të jene të qarta, të kuptueshme dhe të rishikohen rregullisht nepermjet një procesi të rishikimit të politikës së programit i cili është i integruar me procesin e planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve, percaktimit të kostove dhe pergatitjes së buxhetit.

A.3.2 Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP)

11. Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit është pjese e planifikimit strategjik dhe pason Rishikimin e Politikës së Programit. Ai perfaqeson pjesën kryesore të procesit të pergatitjes së PBA-se. PSHIP ndermerret ne kontekstin e politikës makroekonomike dhe veçanerisht të nevojës per stabilitet fiskal.

12. Ai realizohet gjithashtu ne kontekstin e prioriteteve strategjike te Qeverise dhe te qellimeve dhe objektivave te politikave te percaktuara per çdo sektor, domethene, nepermjet Rishikimit te Politikave se Programit. PSHIP reflekton menyren se si Qeveria deshiron t'i alokoje burimet e saj per secilin sektor.
13. Nje hap i rendesishem per te garantuar qe procesi i PSHIP te jete ne perputhje me kuadrin makroekonomik e fiskal dhe prioritetet strategjike te Qeverise, eshte vendosja e taveve te shpenzimeve, qe perben kufirin maksimal qe mund te shpenzohet ose te planifikohet per t'u shpenzuar, per nje qellim te caktuar. PSHIP ndermerret nga ministrit e linjes duke perdorur Sistemin e informatizuar te Ministrise se Finances per Planifikimin e Shpenzimeve dhe Investimeve te Programeve.

A.3.3 Kerkesat per Shpenzime te PBA

14. Pas perfundimit te fazes se PSHIP, ministrit e linjes paraqesin kerkesat perkatese per shpenzime te PBA. Keto kerkesa duhet te jene rigorozisht brenda taveve te percaktuara nga Komiteti i Planifikimit Strategjik prane Keshillit te Ministrave, si dhe te jene te miratuara nga titullaret respektive.

A.3.4 Kerkesat Shtese per Shpenzime te PBA

15. Kerkesat shtese per shpenzime te PBA paraqesin nevojat per financim te programeve perkatese te ministrive te linjes, te cilat nuk mund te mbulohen brenda taveve te percaktuara nga Ministria e Financave. Keto kerkesa perfshijne gjithashtu nje shpjegim se pse ministria perkatese nuk mund te siguroje nje kursim eficient nga Programet e tjera.
16. Miratimi i Kerkesave Shtese te PBA, per nje ose me shume ministri, kerkon rialokimin e burimeve nga programet me pak prioritare te ministrive te tjera te linjes, e cila vendoset nga Keshilli i Ministrave.

A.3.5 Miratimi i PBA

17. Pas shqyrtimit nga ana e Ministrise se Financave te kerkesave per shpenzime te PBA dhe kerkesave shtese te PBA, materiali i permblodhur ne Draft Dokumentin e PBA paraqitet per shqyrtim prane Komitetit te Planifikimit Strategjik dhe me pas per miratim perfundimtar prane Keshillit te Ministrave.

A.3.6 Roli i Ministrise se Financave

18. Roli i Ministrise se Financave eshte kryesor dhe shume i rendesishem. Nuk eshte roli i saj primar per te analizuar objektivat dhe qellimet e politikave te sektorit; kjo eshte pergjegjesia e Keshillit te Ministrave. Roli i saj kryesor eshte qe, gjate fazes se Rishikimit te Politikave se Programit, te siguroje qe politika, objektivat dhe qellimet jane te percaktuara qarte dhe se programet mbeshtetese dhe rezultatet e synuara do te plotesojne objektivat dhe qellimet e politikave ne nje menyre qe krijon vlere per para qe do te thote ne menyre ekonomike, eficiente dhe efektive.
19. Ndersa, roli i Ministrise se Financave ne fazen e Planifikimit te Shpenzimeve dhe Investimeve te Programit eshte i dyfishte. Detyra e saj e pare eshte t'i beje propozime Keshillit te Ministrave per Tavanet e Pergjithshme te Shpenzimeve dhe Tavanet Pergatitore te PBA-se. Ndersa detyra e saj e dyte ka te beje me vleresimin e faktit nese ministrit po arrijne eficienten, efektivitetin dhe ekonomi ne zbatimin e programeve, gje te cilen ajo e mban parasysh kur ben propozim e Taveve Pergatitore te PBA-se.

A.3.7 Roli i Komitetit te Planifikimit Strategjik

20. Komiteti i Planifikimit Strategjik eshte nje strukture e krijuar prane Keshillit te Ministrave e cila kryesohet nga Kryeministri. Roli i ketij Komiteti eshte thellesisht koordinues dhe vendimmarres, pasi te gjitha propozimet e rendesishme qe kane te bejne me Sistemin e Planifikimit te Integruar

ne pergjithesi, dhe Programit Buxhetor Afatmesem ne vecanti, kalojne detyrimisht per shqyrtim prane ketij Komiteti perpara se te marrin miratimin perfundimtar.

21. Ne procesin e pergatitjes se PBA, Komiteti i Planifikimit Strategjik dhe Keshilli i Ministrave luajne nje rol paresor ne drejtim te miratimit te nje sere etapash te rendesishme te tilla si:

- *Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal per periudhen e PBA*
- *Tavani i Pergjithshem i Shpenzimeve*
- *Tavanet Pergatitore te PBA*
- *Kalendarin e SPI*
- *Dokumenti perfundimtar i PBA-se*

B. Kuatrid makroekonomik dhe buxhetor per periudhen 2008 - 2010

22. Kuatrid i rishikuar makroekonomik e fiskal per periudhen 2007-2010 eshte pjese e Sistemit te Planifikimit te Integruar dhe pergatitet nga Ministria e Financave. Kuatrid i rishikuar makroekonomik e fiskal sherben per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem 2008-2010, i cili do te jete subjekt i rishikimeve deri ne momentin e miratimit te PBA-se nga Komiteti i Planifikimit Strategjik.
23. Kuatrid i rishikuar makroekonomik e fiskal per periudhen 2007-2010 perbehet nga dy seksione kryesore. Ne seksionin e pare paraqiten parashikimet e treguesve kryesore makroekonomik per periudhen 2007-2010 dhe seksioni i dyte trajton situaten buxhetore per periudhen 2008-2010. Situata buxhetore paraqet: (i) parashikimin e burimeve ne dispozicion te qeverise per periudhen 2008-2010, dhe (ii) shperndarjen total te burimeve te qeverise sipas zerave kryesore te shpenzimeve.

B.1 Vleresimi i Përgjithshëm makroekonomik për vitin 2006

24. Ekonomia shqiptare **gjate vitit 2006**, u karakterizua nga nje qendrueshmeri e pergjitheshme makroekonomike, e shprehur kryesisht ne sigurimin e ritmeve relativisht te larta te rritjes ekonomike, mbajtjen e inflacionit ne nivele te ulta e nen kontroll, qendrueshmeri te monedhes kombetare, performance te mire te treguesve te tregtise se jashtme, kreditim ne rritje per ekonomine, etj. Tabela 1 paraqet treguesit kryesor makroekonomik per periudhen 2000-2006.

Tabela 2. Treguesit kryesore ekonomike per periudhen 2000-2006

Treguesit	Njesia e matjes	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Rritja reale e PBB-se	%	6,7	7,9	4,2	5,8	5,7	5,8	5,0
PBB-ja me cmime korente	Mln leke	523,043	583,369	622,711	694,098	751,024	817,374	899,700
PBB-ja per fryme	usd	1,189	1,323	1,437	1,831	2,337	2,605	2911
Numri i te punesuarve	mije	1068	921	920	927	931	932	933
Norma e papunesise	%	16.8	16.4	15.8	15.2	14.4	14.2	13.9
Inflacioni mesatar vjetor	%	0.0	3.1	5.2	2.4	2.9	2.4	2.4
Deficiti buxhetor ndaj PBB-se	%	7.5	6.8	6.0	4.9	5.1	3.4	3.17
Borxhi i brendshem/ PBB-se	%	42.4	40.9	41.5	40.5	39.2	39.8	38.8
Borxhi i jashtem/ PBB-se	%	16.6	17.0	21.8	21.1	19.0	16.5	17.1
Deficiti i llogarisë korente ndaj PBB-se	%	4.6	6.9	9.0	6.6	4.9	7.3	8.4
Bilanci tregtar	Mln usd	-821	-1027	-1,155	-1,336	-1,576	-1,820	-1,953
Eksportet	Mln usd	255.4	304.6	330.2	447.1	599.8	656.0	721.0
Importet	Mln usd	1,076.4	1,331.6	1,485.4	1,783.4	2,176.7	2,477.0	2,674.0
Bilanci i sherbimeve	Mln usd	18.1	89.3	-5.2	-82.7	2,044.9	-172.2	-81.0
Transfertat private	Mln usd	432.4	488.1	590.2	809.6	1,020.6	1,146.0	1,216.8
Investimet e huaja direkte	Mln usd	143.0	207.3	135.0	178.0	343.9	277.1	325.3
Kursi mesatar i kembimit	Leke/usd	143.71	143.48	140.15	121.86	102.78	99.86	97.85
Kursi mesatar i kembimit	Leke/euro	132.58	128.47	132.36	137.51	127.67	124.19	123.08

25. Per vitin 2006 te ardhurat e pergjithshme te buxhetit te shtetit arriten ne rreth 25.5 perqind te PBB-se nga rreth 24.8% qe ishin nje vit me pare. Te ardhurat nga taksat qe jane burimi kryesor i te ardhurave te pergjithshme te buxhetit te shtetit arriten ne rreth 22.8% e PBB-se nga 22.4 qe ishin ne vitin 2005. Shpenzimet buxhetore arriten ne rreth 28.8% dhe brenda tyre shpenzimet kapitale arriten ne rreth 5.7% e PBB-se nga rreth 4.7% qe perfaqesonin nje vit me pare. Ne keto kushte deficit i pergjithshem buxhetor arriti te mbahet nen kontroll dhe ne nivelin e 3.3 perqind e PBB-se duke kontribuar ne kete menyre ne ruajtjen e ekuilibrave te pergjithshem makroekonomik si dhe ne kontrollin e inflacionit.

B.2 Ecuria e treguesve makroekonomike për vitin 2007

26. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2007 ekonomia shqiptare shënoi një ecuri pozitive, në drejtim të konfirmimit të ritmit të programuar të rritjes ekonomike, të konsolidimit të mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik dhe të vazhdimit të reformave strukturore në ekonomi. Në tërësinë e tij, zhvillimi ekonomik ka ndjekur kuadrin e parashikuar në programin e zhvillimit ekonomik të vendit, duke respektuar objektivat kryesorë të programit trevjeçar.

B.2.1 Sektori real:

27. **Rritja ekonomike** vazhdon ende të udhëhiqet kryesisht nga kërkesa e brendshme, e cila është mbështetur nga një rritje e shpejtë e kreditimit te ekonomisë. Gjatë periudhës 7-mujore të vitit 2007 rritja ekonomike është mbështetur si nga një përmirësim i prodhimit industrial ashtu edhe nga rritja e eksporteve dhe ajo e investimeve të huaja direkte.
28. Ecuria e përgjithshme e aktivitetit ekonomik, e shprehur nga indeksi i shitjeve të ndërmarrjeve (INSTAT) për 6-mujorin e parë të vitit 2007 ka shënuar një rritje prej rreth 20.7%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kontributin kryesor në rritjen e shitjeve gjatë kësaj periudhe e kanë dhënë degët “tregti, hotele dhe restorante”, “industria” dhe “ndertimi” edhe pse ky i fundit në tremujorin e dytë, kryesisht si pasojë e kufizimit të lejeve të ndërtimit, pati një rritje modeste në krahasim me ç’pritej. Mosrealizimi njëqind për qind i investimeve publike të parashikuara ka dhënë gjithashtu një impakt jo pozitiv në ndërtim. Tregues pozitiv mbi nivelin e planifikuar shfaqen dukshëm në sektorin e transportit.
29. Ndikimi i krizës energjetike që përfshiu vendin gjatë kësaj periudhe ka qenë minimal për sa i takon ecurisë së procesit të prodhimit në të gjithë sektorët e ekonomisë. Kjo në sajë të favorizimit që i është bërë biznesit në shpërndarjen e energjisë elektrike. Me gjithë uljen e ndjeshme në shkallë vendi të furnizimit me energji elektrike, furnizimi i biznesit me energji elektrike gjatë këtij 7 mujori ka qenë 19.6% me i lartë se 7-mujori i vitit të kaluar.
30. Ecuria në sektorin e bujqësisë gjatë pjesës së parë të vitit 2007 ka qenë në ritmet normale të pritshme. Në disa kultura thatësira e këtij viti ka patur një ndikim negativ, por kjo është sheshuar nga ecuria pozitive në të tjera kultura. Në vijim, priten të njëjtat ritme rritjeje si ato të një viti më parë. Faktorët më të rëndësishëm që pritet të mbështesin rritjen e prodhimit bujqësor janë: rritja e rendimentit, shtimi i sipërfaqes së serave dhe faktorë të tjerë që lidhen me ndryshimet potenciale në strukturën e prodhimit për sektorin e bujqësisë.
31. **Produkti i brendshëm bruto**, ne terma nominale, ne vitin 2007, eshte parashikuar te arrije ne 982.2 miliarde leke, me nje rritje prej rreth 9.2 perqind kundrejt vitit 2006. Per rrjedhoje **PBB-ja per fryme**, pritet te arrije ne rreth 3,153 dollare amerikane, me nje rritje prej rreth 8.6 perqind krahasuar me nje vit me pare. Rritja e PBB per 2007 ne terma reale parashikohet te jete 6% (Tabela 3).

B.2.2 Sektori monetar:

32. Deri në muajin qershor 2007, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 199.7 milionë dollare krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 318.2 milionë dollarë dhe rënies së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 118.5 milionë dollarë.
33. Teprica e kredisë për ekonominë deri në muajin qershor 2007 arriti në 234.6 miliardë lekë. Rritja e teprices së kredisë, krahasuar me një vit më parë shënoi vlerën 81.8 miliardë lekë, ose 34.9 përqind. Kredia e akorduar nga sistemi bankar edhe gjatë këtij muaji shënoi rritje, duke ndjekur kështu të njëjtin trend rrites si në muajt paraardhës. Struktura e teprices së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valute, duke përbërë rreth 70.8 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 166.2 miliardë lekë.
34. **Norma vjetore e inflacionit** në muajin Gusht 2007 arriti në 4.2 përqind, nderkohe që norma mesatare e inflacionit për tetemujorin e parë 2007 arriti në 2.53 përqind. Gjate kësaj periudhe indeksi mesatar i cmimeve të konsumit ka shënuar një rritje prej 0.07 pike përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Një vit më parë ky indeks ishte 2.46 përqind. Rolin kryesor në sjelljen e normës së inflacionit po e luajnë grupet “ushqim dhe pije joalkolike”, “qera, uje, lende djegëse dhe energji” si dhe “hotele, kafene dhe restorante”, kjo duke marrë parasysh dhe peshat e larta specifike që ato zënë në shportën e konsumit. Nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar kryesisht në rritjen e cmimit të këtyre grupeve të rrjedhimisht në rritjen e inflacionit mund të përmendim krizën energjitike, thatesirën e zjarret, rritjen e cmimit të drithrave dhe të karburanteve në tregjet ndërkombëtare si dhe bumën në sektorin e turizmit që karakterizoi këtë sezon.
35. Për vitin 2007 objektivi i Politikës Monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë vazhdon të konsistoje në mbajtjen e inflacionit në nivelin 3 përqind me një mundësi luhatje ± 1 pike përqindjeje rreth kësaj vlere qendrore, gjë që do të mundësohet edhe nga ruajtja e stabilitetit makroekonomik dhe e ritmeve të rritjes ekonomike. Për të mbajtur brenda këtij targeti inflacionin së fundmi Banka e Shqipërisë rriti normën e interesit me 0.25 pike përqindje për të dytën herë gjatë vitit duke e çuar atë në 6%.
36. Kursi i këmbimit: Gjate periudhës janar–shtator 2007 Leku pesoi një nënçmim kundrejt monedhës europiane (Euro) prej rreth 1.12 përqind dhe një mbicim të konsiderueshëm kundrejt dollarit amerikan, me rreth 6.34 përqind krahasuar me periudhën janar–shtator 2006.
37. **Kurset mesatare të këmbimit** të Lekut për periudhën janar - shtator 2007 ishin:
 - kundrejt monedhës europiane, **Euro 124.27 leke/euro**;
 - kundrejt monedhës amerikane, **USD 92.56 leke/usd**.
38. Periudha janar – shtator 2007, u karakterizua nga luhatje të kursit të këmbimit për monedhën europiane (Euro), ndërsa për sa i përket dollarit amerikan kursi i këmbimit gjatë kësaj periudhe ka ndjekur një trend rënës. Fillimi i vitit 2007 ishte periudha në të cilën monedha amerikane ishte në pozita të qëndrueshme kundrejt monedhës sonë, Lekut. Pas kësaj periudhe monedha amerikane pati zhvleresime graduale dhe arriti nivelin e saj me të ulët historik pikerisht në muajin korrik '07 me 89.18 leke/usd., i cili rezulton edhe si niveli më i ulët për periudhën 10 – vjeçare (1997–2007). Në ndryshim nga monedha amerikane, monedha europiane Euro, pati një kurs me të luhateshëm. Monedha europiane fitoi pike kundrejt Lekut, gjatë gjithë periudhës janar – shtator e krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë, por duhet theksuar që në këto tre muajt e fundit monedha europiane filloi të humbasë pike kundrejt Lekut, krahasuar kjo me fillimin e vitit 2007.
39. Gjate periudhës Janar 07 - Shtator 07 raporti me të ulët i këmbimit të dy monedhave kryesore, është arritur me 12 janar '07 me nivelin 1.290 euro/usd. Kuotimi maksimal i këtij raporti rezulton me 26 Shtator 07, duke kapur shifrën 1.417 euro/usd.

40. **Faktoret kryesore** qe kane ndikuar ne ecurine e kurseve te kembimit gjate periudhes janar-shtator '07 jane:
- Rritja e normes baze te interesit te marreveshjeve te riblerjes /te anasjellte te riblerjes nga BSh.
 - Rritja e kreditimit nga ana e sistemit bankar ne valute.
 - Shtimi i presioneve inflacioniste si nga ambjenti i jashtem ashtu dhe nga ai vendas.
 - Thellimi i deficitit te llogarise korente.

B.2.3 Sektori i jashtem:

41. **Bilanci i përgjithshëm i pagesave** për gjashtëmujorin e parë të vitit 2007 rezultoi me një teprice prej 37.6 milionë euro. Flukset hyrëse të kapitalit mundësuan në masën 88.6 për qind financimin e deficitit korent.
42. Gjatë periudhës janar - korrik të vitit 2007 u **eksportuan** rreth 57.8 miliarde lekë mallra, duke rezultuar me një rritje rreth 27.3%, krahasuar me periudhen janar - korrik të vitit 2006. Në të njëjtën kohë u **importuan** rreth 206.56 miliarde lekë mallra me një rritje prej rreth 24.4% kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2006. Për rrjedhojë deficitit tregtar në këtë periudhë arriti në 148.76 miliarde lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 23.4%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2006.
43. Tregtia me vëndet e Bashkimit European zuri 65.9% të totalit të tregtisë. Partnerët kryesore tregtare vazhdojnë të jenë Italia dhe Greqia. Me Italinë eksporti është 69.9% dhe importi 28.2%, kurse me Greqinë eksporti është 8.9% dhe importi 14.3%. Disa nga partnerët tanë tregtarë me të cilët eksporti dhe importi janë rritur jane: Itali, Greqi, Gjermani, Kinë, Maqedoni etj. Ndersa per importin jane: Austri, Gjermani, Britani e Madhe etj.
44. Krahasoni janar – korrik ‘07 per disa nga grup mallrat tregon qe eksporti i grupit “minerale, lende djegese, energji elektrike” u rrit me 169.9%, “tekstile dhe kepuce” u rrit me 14.5%, “materiale ndertimi dhe metale” u rrit me 23.5%, etj. Gjate kesaj periudhe te vitit 2007 vihet re nje rritje e importeve per te gjitha grup mallrat, nder te cilat rritjen me te madhe e pesuan importi i grupit “minerale, lende djegese, energji elektrike” u rrit me 47%, importi i grupit “materiale ndertimi dhe metale” u rrit me 31.4 perqind, etj.
45. Flukset e **investimeve të huaja direkte (IHD)** gjatë periudhës së 6-mujorit të parë të 2007, ishin rreth 137.2 milione Euro krahasuar me 122.3 milione Euro të të njëjtit hark kohor të një viti më parë. Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhë të vitit 2007 kjo rritje e flukseve në IHD ka hyrë si në formën e privatizimeve të vogla ashtu edhe me anë të investimeve green-field¹ si pasojë e rritjes së interesit të investitorëve të huaj për të investuar në Shqipëri, gjë që dëshmon progresin dhe stabilitetin makroekonomik që po kalon vendi ynë.

B.2.4 Punësimi:

46. Zhvillimet në tregun e punës gjatë viteve të fundit, megjithëse pozitive, paraqiten të ngadalta krahasuar me rritjen e konsiderueshme të ekonomisë. Nga të dhënat e numrit të të papunëve të regjistruar pranë Zyrrave të Punësimit **norma e papunësisë** shënoi një ulje të lehtë vjetore gjatë tremujorit të parë dhe te dyte të vitit 2007, duke shënuar përkatësisht vlerat prej 13.6 dhe 13.5 përqindësh përkatësisht në krahasim me 14 dhe 13.9 përqind qe shënonte gjatë tremujorit të parë e të dytë të vitit 2006.
47. Me gjithë rënien sezonale gjatë tremujorit të parë të vitit, punësimi në total regjistron rritje në terma vjetorë. Të dhënat e INSTAT tregojnë se **numri i personave të papunë**, që regjistrohen si


¹ *Definicioni:* Investimi i një kompanie të huaj në ngritjen e një projekti që në komponentet bazë të tij. Shembuj të komponenteve bazë mund të jenë: një fabrikë e re, një plantacion energjie, etj.

të tillë në zyrat e punësimit, është 147.7 mijë vetë, duke shënuar një rënie me rreth 5 mijë vetë, në krahasim me një vit më parë. Edhe pse të papunët afatgjatë kanë ardhur në rënie, përsëri ata përbëjnë më shumë se gjysmën e të papunëve (57 për qind). Struktura e papunësisë karakterizohet nga personat arsimi i të cilëve nuk e kalon shkollimin tetëvjeçar dhe që janë mbi moshën 50 vjeç.

B.2.5 Sektori fiskal:

Analiza e te ardhurave


48. **Politika fiskale** e ndjekur gjatë vitit 2007 ka dhënë një kontribut pozitiv në drejtim të kontrollit të inflacionit dhe krijimit të një situatë atraktive për zhvillimin e biznesit.
49. **Te ardhurat totale të buxhetit të shtetit** për këtë periudhë arritën në rreth 181,6 miliarde lekë, nga 183,1 miliardë lekë të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në 99.19% ose me një mosrealizim prej rreth 1.4 miliarde lekë. Të ardhurat janë realizuar rreth 69% të planit vjetor. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat janë rritur me 19,3 miliarde lekë. Të ardhurat për periudhën 9-mujore paraqiten në grafikun e mëposhtëm.
50. **Te ardhurat tatimore** janë rreth 164,1 miliardë leke, duke rezultuar me një mosrealizim prej rreth -2,7 miliardë lekë, megjithatë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ato rezultojnë me rreth 15 miliardë lekë më shumë.
51. **Të ardhurat nga doganat dhe tatimet** arritën rreth 127,6 miliardë lekë, duke rezultuar me një deficit prej -323 milionë lekë, megjithatë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, këto të ardhura u rritën në 15,8 miliardë lekë. Ndërsa realizimi vjetor i të ardhurave nga dogana dhe tatimet është rreth 71%. Të ardhurat totale tatimore, nga tatimet dhe doganat, jepen në grafikun e mëposhtëm:



Analiza e shpenzimeve

52. **Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit** për këtë periudhë kanë arritur në rreth 171.3 miliarde leke nga rreth 192.0 miliardë leke të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 89.2 përqind ose me një mosrealizim prej rreth 20.7 miliardë leke. Krahasuar me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar në rreth 55.3 përqind, ndërsa kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 19.1 miliardë leke më të larta ose rreth 12.5 përqind

me shume. Ecuria e shpenzimeve buxhetore gjate 9 mujoreve ne disa vite jepet ne grafikun e meposhtem:



53. Ne totalin e realizimit te shpenzimeve buxhetore per 9 mujorin 2007, shpenzimet korente zene rreth 87.8 perqind, nga rreth 82.9 perqind te planifikuar, nderkohe qe shpenzimet kapitale zene rreth 12.2 perqind nga rreth 16.9 perqind te planifikuar. Nje vit me pare struktura e shpenzimeve te pergjithshme te buxhetit te shtetit te realizuara si 9-mujor ishte rreth 90.2 perqind shpenzimet korente dhe rreth 9.8 perqind shpenzimet kapitale.
54. **Shpenzimet korente** per 9-mujorin 2007 kane arritur ne rreth 150.4 miliarde leke ose rreth 94.5 perqind te planit te periudhes, duke rezultuar me nje mosrealizim prej rreth 8.8 miliarde leke. Krahasuar me planin vjetor keto shpenzime jane realizuar ne masen 63.8 perqind, nderkohe qe krahasuar me te njejten periudhe te vitit te kaluar keto shpenzime rezultojne rreth 13.1 miliarde leke me te larta ose rreth 9.5 perqind me shume.
55. **Shpenzimet kapitale** deri ne fund te 9 mujorit 2007 jane realizuar ne nivelin 64.4 perqind te parashikimit te periudhes ose rreth 29.9 perqind te planit vjetor duke rezultuar me nje mosrealizim prej rreth 11.6 miliarde leke ndaj planit 9-mujor. Brenda ketyre shpenzimeve, investimet me financim te brendeshem jane realizuar ne masen 63.6 perqind me nje mosrealizim prej rreth 9.1 miliarde leke, nderkohe qe investimet me financim te huaj jane realizuar ne masen 66.8 perqind te parashikimit te periudhes ose me nje mosrealizim prej rreth 2.5 miliarde leke. Ne krahasim me planin vjetor keto investime jane realizuar respektivisht 32.2 perqind dhe 24.4 perqind.
56. Deri ne fund te 9-mujorit 2007, perberja e investimeve kapitale te realizuar eshte 75.6 perqind nga financimi i brendshem dhe rreth 24.4 perqind nga financimi i huaj sic paraqitet edhe nga grafiku i meposhtem.

B.3 Parashikimet makroekonomike 2008-2010

57. Politikat makroekonomike te qeverise per periudhen afatmesme 2008-2010 synojne ne:
- Ruajtjen e stabilitetit makroekonomik nepermjet konsolidimit te metejshem fiskal, reduktimit te vazhdueshem te borxhit te brendshem dhe permiresimit ne balancet korente dhe primare;
 - Mbajtjen ne ritmet relativisht te larta te rritjes ekonomike duke siguruar nje nivel rritjeje mbi 6% ne vit;
 - Mbajtje e nje norme mesatare vjetore te inflacionit brenda intervalit 2-4 perqind;

- Forcim te potenciale te rritjes permes vazhdimi te reformave qe do te nxisin investimet publike dhe private;
- Renie te borxhit publik ne perqindje te PBB-se permes permiresimeve ne administrimin dhe menaxhimin e të ardhurave;
- Politike monetare te kujdesshme qe siguron nje stabilitet afatgjate;
- Pozicion te qendrueshem te bilancit te pergjithshem te pagesave, te shprehur ne rritjen e rezervave valutore dhe ne reduktim te deficitit te llogarise korente;

58. Keto objektiva do te arrihen nepermjet zbatimit te nje politike qe mbeshtet rritjen dhe zgjerimin e sektorit privat te ekonomise; mbeshtetjen e tij me kredi nga sektori bankar; vazhdimin e privatizimeve te ndermarrjeve te rendesishme shtetore; rritjen e kapacitetit të mbledhjes se taksave, ndjekjen e një politikë financiare që do të respektojë një deficit të ulët vjetor, rritjen e investimeve publike, dhe rritjen e efences se shpenzimeve në teresi, duke i destinuar tek ato sektorë që mbështesin rritjen e ekonomisë dhe qe kane impakt të drejtpërdrejtë per një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë të ekonomisë së vendit, e qe jane infrastruktura, shendetësia dhe arsimi. Tabela 3 paraqet treguesit kryesore makroekonomike per periudhen 2007-2010.

Tabela 3. Treguesit kryesore ekonomike per periudhen 2007-2010.

Treguesit	2007	2008	2009	2010
PBB (nominale, me çmime korrente) ne milione leke	982,200	1,075,718	1,176,600	1,293,100
PBB (rritja reale me cmime konstante) ne %	6.0	6.0	6.0	6.0
PBB-ja per fryme ne \$	3,153.5	3,426.0	3,724.0	4,055.0
Inflacioni mesatar vjetor	3.0	3.0	3.0	3.0
Bilanci tregtar ne % te PBB-se	-20.6	-20.1	-19.7	-19.4
Bilanci i llogarise korente ne % te PBB	-7.3	-7.4	-6.9	-6.2

59. **Rritja ekonomike** do te mbështetet si nga sektori i shërbimeve, qe aktualisht perben dhe pjesen me te madhe te PBB, ashtu dhe nga sektoret e ndertimit e te industrise, ku dhe keta te dy po peshojne gjithnjë e me tepër ne PBB.
60. Rritja ne industrine nxjerrese (vecanerisht minierat) dhe ate perpunuese do te qendroje ne nivele relativisht te larta. Kjo pritet te mbeshtetet nga nivele te larte te investimeve, ku keto te fundit, pervec te tjerave, do te nxiten kryesisht nga nismat qe qeveria ka marre per te terhequr investimet ne kete sektor “Shqiperia nje euro” si dhe nga kosto e ulet e faktorit pune ne vendin tone. Industria, e sidomos ajo nxjerrese, kerkon nje force punetore me kualifikim te ulet e qe paguhet relativisht pak dhe eshte evidente qe vendi yne ofron nje faktor te tille nese marrim ne konsiderate faktin qe me te per se gjysma e te papuneve ne vend nuk kane me teper se sa nje arsim tetevjecar. Nga ana tjeter kjo do te ndikojë ne uljen e papunesise e rrjedhimisht te varferise ne vend.
61. Sektori i sherbimit, bazuar ne faktoret e siperpermendur, do te vazhdoje te kete nje rritje te qendrueshme duke kontribuar ndjeshem ne rritjen e PBB. Llojet e sherbimeve qe priten te kene nje zhvillim me te madh ne saje te faktoreve te siperpermendur jane sherbimet e transportit, telekomunikacionit, hotele dhe restaurante, por dhe disa sektore te tjere si ai bankar, arsimi e shendetesia.
62. Eshte evidente qe sektori i bujqesise gjate gjithë ketyre viteve te ekonomise se tregut ka ndjekur nje trend gradual renes, si persa i perket peshes se tij ne PBB, ashtu dhe ne kontributin qe ky sektor ka patur ne rritjen e PBB dhe kjo natyrshem qe është një karakteristike e zakonshme e atyre ekonomive qe nga njëra ane jane ne zhvillim e siper e nga ana tjeter bujqësia nuk perben një nga

- sektoret me konkurueshmeri te larte ne tregjet e huaja. Por me reformat e fundit qe jane marre e vazhdohet te ndermerren ne sektorin e bujqesise ne kuader te perqasjes drejt praktikave te BE, pritet qe eficenca ne kete sektor, e rrjedhimisht konkurrueshmeria e tij ne tregun vendas e ate te huaj te rritet duke e kthyer kete sektor ne nje sektor potencial per zhvillimin ekonomik te vendit.
63. Nga sa thuhet mesiper, sektori i bujqesise pritet te kete nje zhvillim te ndjeshem ne drejtim te eficences se tij duke bere keshtu qe produktet bujqesore te vendit te behen me te konkurueshme ne vend e jashte tij. Keshtu, pritet nje rritje ne kerkesen vendase e te huaj per produktet bujqesore te vendit. Kjo rrjedhimisht do beje qe nga njera ane te rriten eksportet ne bujqesi e nga ana tjeter konsumatori shqiptar te preferoj gjithnje e me teper produktet bujqesore vendase kundrejt atyre te importit, duke pakesuar kete te fundit e duke zhvilluar dhe me tej sektorin e bujqesise.
64. Gjithashtu, pritet qe nje norme rritese midis 11% dhe 13% do te ruhet per eksportet ne tre vitet e ardhshme, si shenje mirebesimi ne rritjen ekonomike dhe ne saje te impaktit te nivelit te larte te investimeve gjate viteve te fundit. **Eksportet** jane parashikuar qe ne vitin 2010 te arrijne ne rreth 10 perqind te PBB-se nga 7.8 perqind qe kane arritur ne vitin 2006, nderkohe qe **bilanci tregtar** parashikohet te arrije ne rreth 19.4 perqind te PBB-se. **Deficiti i llogarise korente** parashikohet te jete rreth 6.2 perqind i PBB-se nga rreth 8.4 perqind qe vleresohet per vitin 2006.
65. Ka nje sere faktoresh per te qene optimist mbi mundesite dhe aftesite e ekonomise shqiptare per te patur nje rritje afersisht te njejte me vitet e meparshme edhe per nje periudhe afatmesme. Stabiliteti makroekonomik qe po kalon vendi, permiresimi i klimes se biznesit si pasoje e nje sere reformash te ndërmarra nga qeveria, reduktimi taksave mbi biznesin, permiresimi i rendit publik e lufta e vazhduar kunder krimit te organizuar e korrupsionit, permiresimet e pritshme ne sektorin e energjetik si nje nga sektoret prioritare te qeverise, permiresimet e pritshme ne drejtesi, si dhe politikat e iniciativat e drejteperdrejta qe qeveria po ndërmerr për te nxitur investitoret e huaj e ata vendas patjetër qe priten te kene nje impakt mjaft pozitiv ne thithjen e investitorëve te huaj e inkurajimin e atyre vendas.
66. Nje tjeter faktor qe na ben te besojme ne nje rritje te tille gjate 3 viteve te ardhshem jane edhe investimet e konsiderueshme ne infrastrukturen rrugore. Keto investime, ku nga me te rendesishmit eshte ndertimi i rruges strategjike Dures–Kukes–Morine, pervecse pritet te zhvillojne ndjeshem biznesin e disa llojeve sherbimesh ne vend, e kryesisht ate te transportit, do te ndikojne gjithashtu ndjeshem ne uljen e kostove te shume bizneseve ne vend duke rritur keshtu eficencen e ekonomise ne teresi.
67. Investimet private kane arritur nivele te larta vitet e fundit, megjithese kane qene me shume te perqendruara ne ndertimin e banesave, te cilat mendohet qe nuk kane produktivitet aq te larte krahasuar me investime te tjera qe mund te ishin bere. Megjithate, nese marrim parasysh kerkesen e larte qe konsumatori shqiptar ka patur gjate ketyre viteve per “sherbimet e banimit”, investimet e larta ne ndertesa banimi kane qene nje prirje e diktuar nga tregu dhe si te tilla produktiviteti i tyre gjate ketyre viteve per te gjithe ekonomine shqiptare ne teresi ka qene relativisht i larte, pasi ka shuar “etjen” e madhe te shume rezidenteve per sherbime banimi, ku keto te fundit edhe per 3-4 vitet e ardhshem do te zene nje peshe te konsiderueshme ne preferencat e konsumatorit shqiptar. Pra, investimet e medha private te bera gjate ketyre viteve ne nderimin e ndertesave te banimit, kane qene e do vazhdojne te jene edhe per disa vite me teper produktive nga c’ka mendohet. Kjo mund te behet dicka me e qarte nese per nje moment mundohemi te llogarisim parate qe rezidentet shqiptar te cilet kane blere keto shtepi banimi do te kishin harxhuar gjate gjith kohes per te paguar per sherbimet e banimit te cilat ata perfitojne nga banesat e tyre.
68. Produktiviteti i fuqise punetore dhe i kapitalit pritet te permiresohet ndjeshem si rezultat i rritjes se numrit te personave qe do kene arsim te mesem e te larte dhe i investimit te kapitalit ne sektore me kthyeshmeri te pritshme te larte, si p.sh. ai i turizmit, energjetikes, etj. Gjithashtu nje rritje e ndjeshme e produktivitetit te kapitalit ne disa sektore te rendesishem te ekonomise shqiptare, si ai i

telekomunikacionit e energjetikes, etj., pritet edhe si pasoje e disa privatizimeve strategjike qe qeveria shqiptare ka bere e do vazhdoje te beje. Nga privatizimet me te rendesishme ketu mund te permendim: kompanine e Albtelekom-it, divizionin e shperndarjes se KESH-it, kompanine e sigurimeve INSIG, etj. Keto privatizime, pervec se do rrisin eficencen sektoriale e rrjedhimisht ate te pergjithshme, do perbejne dhe nje fluks te madh hyres investimesh te huaja direkte, pra do rrisin kapitalin e investuar ne vend duke perbere keshtu nje faktor potencial per rritjen e metejshme te PBB.

69. Faktoret e siperpermendur, por dhe te tjere qe pritet te kene impakt pozitiv ne rritjen ekonomike per vitet 2008-2010 jane permendur ne menyre te sintetizuar me poshte:

- *Permiresime ne klimen e biznesit* per zhvillimin e investimeve te huaja private dhe ato vendase nepermjet reformes ligjore mbi te drejtat e pronesise dhe hapat per uljen e kostove per hapjen e nje biznesi te ligjshem, duke ulur numrin e procedurave administrative dhe duke i bere keto te fundit me eficente ne luften kunder korrupsionit dhe evazionit fiskal, si dhe duke rritur barazine e rregullave te lojes per te gjithë aktoret ne saje te formalizimit gjithnje e me te larte te biznesit.
- *Kerkesa per produkte paresore bujqesore* do te vije si pasoje e rritjes se eficences ne sektorin bujqesor ne saje te nje sere reformash te ndermarra ne kete sektor.
- *Pershpejtimi procesit te privatizimeve.* Pas perfundimit te proceve te rendesishme te privatizimit si ajo e Bankes se Kursimeve dhe e Albtelekomit, qeveria shqiptare po pergatitet te privatizojë kompani me kapital shtetëror ne sektore te rendesishem te ekonomise si eshte ajo e sigurimeve INSIG, 2 kompani ne sektorin e naftes si dhe aksionet ne minorance ne dy banka te nivelit te dyte.
- *Permiresime ne infrastrukture, vecanerisht ne sektorin energjetik dhe ate ujesjellesave.*
- *Vazhdimesia ne reformat ne sektorin financiar* pas zbatimit te metodave te pagesave te RTGS, krijimi i nje tregu dytesor per bonot e thesarit dhe krijimi i skemes se sigurimit te kredive.
- *Pakesimi i taksave qe rendojne biznesin nga njera ane dhe rritja e bazez se tatueshme nga ana tjetër, ne saje te reformave ne administraten tatimore dhe ate doganor, e te cilat konsistojne ne permiresimin e sherbimeve per taksapaguesit, rritjen e transparences, thjeshtimin e procedurave administrative dhe informatizimin e sistemit te taksave.*
- *Fuqizimi i metejshem i reformave institucionale dhe strukture ne administraten publike.*
- *Riorientimi i vazhdueshem i shpenzimeve publike drejt sektoreve te shendetesise dhe arsimit me prioritet permiresimin e infrastruktures dhe mbrojtjen sociale.*

70. E mbështetur nga gjithcka permendet me siper, pritet qe **norma e rritjes** te ruaje ritmin prej 6% ne vit deri ne 2010, e cila do te kete impakt pozitiv mbi punezenien dhe te ardhurat. **PBB-ja ne terma nominale** ne fund te vitit 2010 eshte parashikuar te arrije ne 1293.1 miliarde leke, me nje rritje prej rreth 31.7 perqind kundrejt vitit 2007. PBB-ja per fryme ne fund te vitit 2010 parashikohet te arrije ne rreth 4,055 dollare amerikane, me nje rritje prej rreth 8.9 perqind krahasuar me nje vit me pare.

71. Nga ana tjetër, disa nga faktoret kryesore qe mund te perbejne **risk potencial** ne ruajtjen e nivelit te parashikuar te aktivitetit ekonomik prej 6% jane:

- Mungesat e mundshme ne furnizimin me energji elektrike dhe plotesimin e nevojave te brendshme per shkak te: (i) ritmit te larte te rritjes se kerkeses se brendshme per energji (ii) situates se pafavorshme ne tregun rajonal te energjise (iii) dhenies se pjeses kryesore te efektit pozitiv te projekteve investuese ne sektorin e energjise ne vitet pasuese te vitit 2007.
- Paqendrueshmeria e çmimit te naftes ne tregun botëror. Kerkesa ne rritje per kete produkt ne nivel global dhe brishtesia qe karakterizon zhvillimet gjeopolitike botërore po formon gjithnje e me shume pasiguri ne ambientin e biznesit dhe konsumatoreve persa i perket

kostos se ardhshme te procesit te prodhimit dhe per pasoje edhe vendimet korente ne zgjerimin e kapaciteteve prodhuese jane me te rezervuara.

- Thellimi potencial i bilancit tregtar per shkak te implementimit te Interim Agreement me BE-ne. Nje proces i tille pritet te shoqerohet me penetrim me te larte sesa ne vitet e kaluara te produkteve europiane ne tregun vendas dhe aktivizim jo te mjaftueshem nga ana e eksporteve shqiptare per te kompensuar kete rritje ne periudha afatshkurtra per shkak te nivelit relativisht te ulet te konkurueshmerise qe karakterizon aktualisht ekonomine tone.

B.4 Kquadri Buxhetor 2008-2010

B.4.1 Te Ardhurat Buxhetore

Te ardhurat e buxhetit te shtetit per periudhen 2008-2010 jane parashikuar duke u bazuar ne kuadrin makroekonomik te paraqitur me siper, dhe ne politikën e taksave e cila bazohet në:

72. Mbajtjen kostante te normes se TVSH-se gjate 3 viteve ne vazhdim. Mbajtja e TVSH konstante per tre vitet ne vazhdim eshte bazuar jo vetem ne ndikimet negative qe mund te kete ne te ardhurat e buxhetit te shtetit, por edhe ne jeten sociale. Vendi yne karakterizohet nga nje mjedis i qendrueshem makroekonomik, ku presionet inflacioniste kane rezultuar me te ulta se ato te parashikuara (nen 3%) megjithese qeveria ka ndermarre nje politike ne drejtim te rritjes se pagave dhe pensione. Gjithashtu eshte vertetuar qe sjellja e cmimeve ne drejtim te uljes se tyre shfaqet inelastike, pra, ka shume pak gjasa qe ulja e TVSH-se do te rezultojte me ulje te cmimeve. Nje fenomen i tille nuk eshte vene re as ne situaten aktuale ku ulja e tarifes doganore per shkak te nenshkrimit te MSA dhe zbatimit te detyrimeve te OBT vleresohet rreth 2-2.5%. Nje aspekt tjeter i rendesishem i mosuljes se TVSH-se eshte edhe treguesi i bilancit tregtar. Vendi yne ka nje deficit te larte tregtar dhe ulja e TVSH-se do ndikonte me tej ne rritjen e deficitit tregtar, nepermjet favorizimit te importeve dhe dekurajimit te eksporteve.
73. Parashikimi i te ardhurave nga TVSH eshte bazuar ne rritjen ekonomike prej 6% deri ne vitin 2010, dhe nje norme inflacioni prej 3%, si dhe ne rishikimin e buxhetit fillestar te vitit 2007. Bazuar ne keta tregues, baza e tatueshme e TVSH eshte rritur me rritjen e vleres nominale te PBB dhe per vitin 2008 dhe 2009 parashikohet qe baza e tatueshme do te pesoje edhe nje rritje prej 2%, si pasoje e permiresimit administrativ dhe permiresimit te strukturese PBB-se ne dobi te sektoreve qe paguajne TVSH. Per vitin 2010, kjo rritje eshte supozuar te jete 1%.
74. Pergjysmimi i normes se tatimit te fitimit (nga 20% ne 10%) deri ne vitin 2010, duke filluar aplikimin nga 1 Janari 2008. Kjo mase fiskale parashikohet te kete impakt pozitiv ne ekonomine e vendit, pasi do te rritet baza e taksueshme, biznesi vendas do te inkurajohet te deklarroje shifra reale te bilanceve kontabel, dhe klima do te jete me atraktive per investimet, vecanerisht investimet e huaja direkte dhe indirekte.
75. Parashikimi i te ardhurave nga tatimi mbi fitimin per tre vitet ne vazhdim eshte bazuar ne rritjen e baze tatimore (fitimi total i biznesit) si pasoje e rritjes se ekonomise dhe permiresimit administrativ e strukturor (rritja e GDP orientohet nga sektoret qe paguajne tatim fitimi) si dhe shfuqizimi i perjashtimeve nga tatim-fitimi. Pra, rritja e baze tatimore (fitimi total i biznesit) eshte supozuar te rritet me te njejten rritje si PBB (6% rritje ekonomike dhe 3% inflacion) si dhe me zgjerimin e baze se taksueshme.
76. Realizimi te ardhurave nga tatim-fitimi per periudhen 2007-2010, permban edhe riskun e mosarketimit te te ardhurave nga KESH-i, per shkak te situates se perkeqesuar financiare te kompanise. Megjithate, situata financiare e korporates ka premisa te mira per t'u permiresuar ne 3

vitet e ardhshëm, pavaresisht nga vështësitë energjetike e mund ta shohë vendin edhe për disa vjet. Mendojmë kështu, pra që edhe pse kriza energjetike mund të vazhdojë dhe për disa vite, por jo domosdoshmërisht, do kemi dhe një krizë financiare të korporatës nisur nga dy argumente kryesore. Humbjet e korporatës vijnë për dy arsye kryesore: 1) vjedhja në rrjet 2) blerja e energjisë së importuar me një çmim shumë më të lartë se ai i shitjes. Të dyja këto pritet që të ndryshohen në vitin që vjen. Vjedhja po reduktohet me ritme të krenarshme, falë punës që bëjnë drejtuesit e KESH-it, dhe së dyti rritja e çmimit të energjisë që mendohet të hyjë në fuqi së shpejti do reduktojë humbjet nga diferenca e çmimeve. Kështu gjendja financiare e korporatës pritet të përmirësohet, pavaresisht nga kriza e energjisë që mendohet të vazhdojë të pakten dhe për 2-3 vjet.

77. Gjithsesi, në parashikimet makroekonomike nuk është marrë në konsideratë ky risk, pasi nisur nga tendenca historike e uljes së tatimit-fitimit, kur normat e tatimit-fitimit kanë pësuar ulje, performanca e të ardhurave nga tatimi-fitimi ka pësuar rritje të konsiderueshme mbi mesataren historike.
78. Një rritje e lehtë në akcizën e karburanteve me rreth 4 leke/liter, të pijeve alkoolike, verës dhe birrës, respektivisht, duke filluar nga 1 korriku 2007.
 - 10 leke/litri për birrën e diferencuar sipas sasisë së prodhimit,
 - 15 leke/litri për verën, verërat e gazuara, vermut dhe verëra të tjera me substanca aromatizuese,
 - 50 leke/litri për pijet alkoolike me forca alkoolike ndaj volumit mbi 12%
 - 20 leke/litri për pijet alkoolike me forca alkoolike ndaj volumit deri në 12%
79. Parashikimi i të ardhurave nga Akciza është mbështetur në rritjen e nivelit të akcizës së karburanteve, pijeve alkoolike, verës dhe birrës, duke i përafëruar akcizat e tyre me nivelin e akcizave të vendeve të rajonit, si dhe një rritje të bazës së taksueshme, duke ndjekur trendin e viteve të fundit si dhe ritmet e rritjes së PBB-së. Gjithashtu është parashikuar një rritje prej 11% e të ardhurave nga akciza në mallrat e tjera, e cila reflekton rritjen ekonomike si dhe zgjerimin e bazës së taksueshme.
80. Aplikimi i sistemit taksës së sheshtë për tatimin mbi të ardhurat personale, duke eliminuar shkallët tatimore progresive, dhe duke mbajtur një nivel pragu përjashtues prej 10.000 leke për pagat deri në 30.000 leke. Të gjitha kategoritë e të ardhurave personale do të taksohen në nivelin unik prej 10%, duke filluar nga gjashtëmuji i dytë 2007.
81. Aplikimi i taksës së sheshtë do të japë impakt pozitiv, vecanërisht në kategorinë e të punësuarve me të ardhura të larta, kategori e cila pas aplikimit të kësaj mase fiskale (pjesa e biznesit privat) mendohet se do të jetë plotësisht e motivuar për të deklaruar të ardhurat reale. Me këtë masë, eliminohet tatimi progresiv (duke lënë një prag përjashtues për shumën 10.000 leke për pagat deri në 30.000 leke) dhe shkallët e tatimit zëvendësohen me një të vetme dhe unike, 10% për të gjithë kategoritë e pagave, duke thjeshtuar edhe procedurat e deklarimit dhe llogaritjes së këtij tatimi.
82. Parashikimi i të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale për tre vitet në vijim do të ruajë trendin pozitiv dhe merr në konsideratë rritjen e numrit të punonjësve të deklaruar, rritjen e pagave si dhe rishikimin e pagave referuese minimale për efekt të tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore.
83. Norma e kontributit për sigurime shoqërore është parashikuar të mbetet e njëjta me nivelin e aplikuar në shtator të vitit 2006, si pasojë e rishikimit të skemës ekzistuese.
84. Parashikimi i të ardhurave është bazuar në rritjen e numrit të të punësuarve që do të përfshihen në sektorin formal, ashtu edhe në uljen e evazionit si pasojë e deklarimit të saktë të nivelit të pages. Megjithatë këto të ardhura do të jenë subjekt ndryshimi për shkak të ndryshimit të skemës ekzistuese të pensioneve.

85. Eshte parashikuar edhe nje rritje ne nivelin e taksave nacionale, duke konsideruar nje rritje te takses se importit te automjeteve te perdoruara, reduktim te takses se diteqendrimit te automjeteve te huaja, takses konsullore si dhe atyre portuale (duke filluar nga 1 korriku 2007).
86. Parashikimi i te ardhurave nga taksat nacionale eshte bazuar ne trendin historik te ketyre te ardhurave. Ne parashikimin e te ardhurave nga taksat nacionale eshte marre parasysh edhe nje rritje e takses se importimit te automjeteve te perdoruara, reduktim te takses se diteqendrimit te automjeteve te huaja, takses konsullore si dhe atyre portuale, si dhe ritmet e rritjes se PBB-se.
87. Eshte parashikuar gjithashtu nje rritje ne nivelin e taksave vendore, respektivisht taksa e pasurise per ndertesat te cilat ndodhen ne pronesi apo perdorim brenda teritoreve te fshatrave turistike (duke filluar nga 1 korriku 2007).
88. Parashikimi i te ardhurave te pushtetit vendor eshte bazuar ne rritjen e bazez tatimore si pasoje e rritjes ekonomike dhe trendit historik te te ardhurave nga Pushteti Vendor. Tek taksa e pasurise kemi parashikuar nje rritje mbi mesataren e trendit historik, duke marre ne konsiderate aplikimin e nje takse shtese per te gjitha ndertesat te cilat ndodhen ne pronesi apo perdorim, brenda teritoreve te fshatrave turistike.
89. Eshte parashikuar nje reduktim ne taksat doganore si pasoje e berjes zero te takses doganore per automjetet (duke filluar nga 1 korriku 2007).
90. Parashikimi i te ardhurave nga taksa doganore bazohet ne rritjen e bazez se taksueshme dhe efekteve me impakt negativ ne te ardhurat nga reduktimi i tarifave doganore, per shkak te OBT dhe MSA. Gjithashtu eshte marre ne konsiderate edhe reduktimi ne zero i taksave doganore per automjetet e reja si dhe automjetet e perdoruara, per te cilat aplikohet taksa e importimit te automjeteve te perdoruara (mjedisit). Trendi i te ardhurave nga taksa doganore eshte nje trend ne rnie, si pasoje e reduktimit te normes se tarifave doganore (angazhimet e OBT-se dhe MSA-se).
91. Parashikimi i te ardhurave jotatimore eshte bazuar ne supozimin qe transferimi i fitimit nga BSH per tre vitet e ardhshme do te jete 5,500 milione leke; te ardhurat nga institucionet buxhetore do te rriten me 6% ne vit duke reflektuar, si rritjen e inflacionit ashtu edhe rritjen e sherbimeve ndaj publikut. Te ardhurat per periudhen e mbetur 2008-2010 do te jene perseri objekt rishikimi, per shkak te procesit te privatizimit te aksioneve te Qeverise ne ndermarrjet publike. Te ardhurat e tjera parashikohen te jene 1 miliarde leke per tre vitet e fundit.
92. Parashikimi i te ardhurave nga ndihmat dhe grantet eshte bazuar ne parashikimet e nivelit te disbursimeve te projekteve te financuara nga donatoret si dhe ne marreveshje me FMN.
93. Te ardhurat nga privatizimi per periudhen 2008-2010 jane parashikuar ne nivelin prej 1 miliarde leke ne vit, ku privatizimi i sektoreve strategjike nuk eshte perfshire.
94. Niveli i huamarrjes se brendshme parashikohet qe ne vitin 2010 te arrije ne 2.3% te PBB, nivel i cili eshte negociuar dhe rrene dakort ne programin me FMN.
95. Niveli i huamarrjes se huaj eshte parashikuar ne baze te informacionit qe kane sjelle ministrite e linjes gjate pergatitjes se buxhetit te vitit 2008.
96. Eshte draftuar nje pakete ligjore e cila shfuqizon disa nga perjashtimet e dhena me ligjet fiskale apo ligje te tjera te vecanta, te cilat do te kene impaktin e vet pozitiv ne buxhetin e shtetit, duke siguruar te ardhura shtese jo vetem nga eliminimi i tyre, por gjithashtu edhe nga permiresimet ne administrimin e burimeve te tjera, te cilat linin shteg per abuzime.

B.4.2 Shperndarja e Shpenzimeve Buxhetore

97. Parashikimi i shpenzimeve eshte mbeshetur ne procedurat e buxhetimit mbi baza objektivash e produktesh te vena ne zbatim ne te gjitha ministrte e linjes per here te pare kete vit.
98. Vleresimet per shpenzimet per vitin 2008 mbesheten kryesisht ne tavanet e parashikuara ne Programin Buxhetor Afatmesem 2008-2010, duke mbajtur ne konsiderate ne kete menyre deklaratat e politikave te secilit institucion. Gjithashtu, keto parashikime te shpenzimeve te buxhetit te shtetit per vitin 2008 reflektojne edhe burimet ne rritje te buxhetit si rezultat i politikave fiskale te ndermarra dhe atyre te reja, si dhe mireadministrimit ne rritje te te ardhurave tatimore dhe doganore. Ky projektbuxhet mban parasysh objektivat e qeverise te percaktuara ne programin e saj, si dhe ne dokumentat e tjere strategjike apo ne marreveshjet me institucionet nderkombetare.
99. Shpenzimet e pergjithshme te buxhetit te shtetit per vitin 2008 parashikohen ne masen 369 miliarde leke, me nje rritje prej rreth 19% krahasuar me buxhetin suplementar te vitit 2007, ose ne shume absolute rreth 59.3 miliarde leke me shume. Ato jane parashikuar te perfaqesojne rreth 34.3 perqind te PBB, nga rreth 31.5 qe jane parashikuar ne buxhetin suplementar te vitit 2007.
100. Shpenzimet buxhetore mundesojne rritjen e sektoreve prioritare ekonomike, si me poshte ne tabelen 4.

Tabela 4 Shpenzimet buxhetore ne sektoret prioritare

	njesia	2006 (fakt)	2007 (i pritshmi)	2008 (plan)	2009 (plan)	2010 (plan)
Arsimi*	million leke	28.515	35.486	43.049	46.812	53.311
ne % te PBB	%	3,2%	3,6%	4,0%	4,0%	4,1%
Shendetesia**	million leke	21.715	25.986	30.929	34.073	38.429
ne % te PBB	%	2,4%	2,6%	2,9%	2,9%	3,0%
Infrastruktura*** ****	million leke	32.460	40.564	73.343	50.622	58.944
ne % te PBB	%	3,6%	4,1%	6,8%	4,3%	4,6%
Mbrojtja	million leke	13.816	17.619	21.650	23.521	26.407
ne % te PBB	%	1,5%	1,8%	2,0%	2,0%	2,0%

*ne shpenzimet per arsimin jane perfshire dhe shpenzimet e pushtetit vendor, Ministrise se Mbrojtjes dhe asaj te Brendshme per arsimin

**ne shpenzimet per shendetesine jane perfshire dhe shpenzimet e pushtetit vendor dhe Ministrise se Mbrojtjes per shendetesine

***ne shpenzimet per infrastrukturen jane perfshire shpenzimet totale te Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

****shpenzimet per sektorin e infrastruktures ne vitin 2008 ndikohen nga financimi i huaj shtese i parashikuar per ndertimin e rruges Durres - Kukes - Morine

101. Shpenzimet per personelin per vitin 2008 kane marre ne konsiderate politiken e kompensimit per efekt te vendosjes se takses se sheshte dhe politikat e deklaruar te rritjes se diferencuar sipas sektoreve te ekonomise. Per vitet ne vazhdim ne shpenzimet e personelit eshte perfshire edhe fondi kontigjence per politikat e reja te pagave. Perdorimi i ketij fondi do te analizohet ne cdo buxhet vjetor ne funksion te politikave te rritjes se diferencuar te pagave ne sektoret prioritare.
102. Parashikimi i shpenzimeve per interesa eshte bazuar ne strategjine e borxhit te Ministrise se Financave.
103. Shpenzimet operative dhe te mirembajtjes parashikohet te rriten me rreth 12% ne vit per tre vitet e ardhshme. Kjo rritje do te orientohet ne rritjen e shpenzimeve te mirembajtjes, si rrjedhoje e rritjes se nivelit te investimeve gjate ketyre viteve, ne perputhje edhe me rekomandimet e raportit PEIR te BB.

104. Shpenzimet per subvencione jane parashikuar duke u bazuar ne politiken ekzistuese te subvencioneve dhe ne politikat per reduktimin e tyre te metejshem. Keshtu, ne projektbuxhetin e vitit 2008 eshte planifikuar qe subvencionet te ulen me 13.3% ne krahasim me vitin 2007. Fushat e financimit te subvencioneve do te vazhdojne te jene: uji i pijshem, hekurudhat, librat shkollore, ndermarrjet e trajtimit te studenteve etj.
105. Shpenzimet per pagese papunesie, ndihme ekonomike dhe paaftesi, parashikohen te rriten me rreth 10% ne vit. Ketu do te mbahet parasysh politika per nje rritje te diferencuar midis zerave perberes te ketyre shpenzimeve. Ndersa ndihma ekonomike, si rezultat i permiresimeve ligjore dhe administrative do te vije duke u ulur (ne terma relative) pjesa me e madhe e rritjes do te shkoje per pagesen e paaftesise, si rezultat i indeksimit te saj dhe rritjes se numrit te perfituesve.
106. Shpenzimet kapitale per tre vitet e ardhshme parashikohen ne nivelet 6.5-6.6% e PBB-se, ne varesi edhe te financimeve te huaja. Rritja e burimeve te huaja te financimit ne vitin 2008 permes prezantimit te instrumentave te rinj te borxhit, ka shkaktuar nje rritje prej 50.6% ne shpenzimet kapitale ne krahasim me vitin 2007. Per periudhen 2008-2010 shpenzimet kapitale do te vazhdojne te rriten me perparesi ne sektoret prioritare si: infrastruktura, arsimi, shendetesia.

Tabela 5. Treguesit Fiskale te PBA 2008-2010 (ne milione leke)

TREGUESIT FISKALE TE PBA 2008-2010
(FISCAL INDICATORS FOR MTBP 2008-2010)
ne milion leke (in million of leks)

Nr.	E M E R T I M I	Fakt	Buxheti i Rishikuar	Fakt 8- mujo 2007	P/Buxheti 2008	P/Buxheti 2009	P/Buxheti 2010	I T E M S
		2006	2007	mujo 2007	2008	2009	2010	
	TOTALI TE ARDHURAVE	229.444	264.288	156.376	283.686	314.317	353.762	TOTAL REVENUE
I.	Te ardhura nga ndihmat	8.025	3.928	1.334	4.733	3.055	2.465	Grants
	Nga kjo:Mbeshtetje buxhetore				0			From which: Budget Support
II.	Te ardhura tatimore	205.522	236.114	143.595	262.352	293.252	332.098	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	155.102	179.975	110.942	195.711	214.379	242.210	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	74.268	87.783	55.341	99.903	108.149	121.126	V.A. T & Turnover Tax
2	Tatimi mbi Fitimin	22.258	22.900	13.755	14.420	17.699	20.841	Profit Tax
3	Akcizat	22.997	28.837	18.012	38.493	41.421	46.392	Excise Tax
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	8.580	13.000	7.330	16.272	19.788	24.340	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	13.008	16.400	9.902	17.212	21.522	23.936	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	13.991	11.055	6.602	9.411	5.800	5.575	Customs Duties
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	11.112	13.339	6.711	15.582	18.555	21.728	Local Taxes
1	Taksa Lokale	7.198	8.383	4.856	9.487	10.910	12.001	Local Taxes
2	Tatimi mbi Pasurine(ndertesat)	1.288	2.266	689	3.136	4.390	6.147	Property Tax
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	2.626	2.690	1.166	2.959	3.255	3.580	Small Business Tax
II.3	Te ardh. Buxh. Pavarur (kontribute)	39.309	42.800	25.942	51.059	60.318	68.159	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shogoror	35.743	38.263	23.077	45.836	54.146	61.185	Social Insurance
2	Sigurimi Shendetesor	3.566	4.537	2.865	5.223	6.172	6.975	Health insurance
III.	Te ardhura Jotatimore	15.896	24.246	11.447	16.601	18.010	19.199	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	5.211	5.100	1.010	5.500	5.700	5.800	Profit transfer from BOA
2	Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	8.234	10.535	6.314	10.000	11.037	12.047	Income of budgetary institutions
3	Dividenti		7.261	3.339	101	273	352	Divident
4	Te tjera nga ISSH	0	300		0			Other/not allocated
5	Te tjera	2451	1050	784	1000	1000	1000	Other/not allocated
	TOTALI I SHPENZIMEVE	258.816	309.727	149.101	369.034	360.212	400.701	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	204.860	235.846	131.817	252.915	277.208	307.256	Current Expenditures
1	Personeli	56.709	63.286	34.945	67.957	71.710	80.343	Personnel expenditures
	Paga	45.575	49.230	29.055	57.074			Wages
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	11.134	9.910	5.890	10.882			Social insurance contributions
	Politikat e reja pagash		4.146					Of which: Contingency for new policies
2	Interesat	25.006	28.150	16.900	33.300	36.356	38.481	Interest
	Te Brendshme	22.978	24.750	15.655	29.000	30.500	32.000	Domestic
	Te Huaja	2.028	3.400	1.245	4.300	5.856	6.481	Foreign
3	Shpenzime Operative Mirembajtje	22.800	24.862	13.432	27.871	32.130	37.377	Operational & Maintenance
	Nga e cila: Financim i Huaj	0	216		225			From which: Foreign Financing
	Kontigjence							From which:Contingency
4	Subvencionet	3.829	2.625	1.539	2.276	2.785	2.868	Subsidies
5	Mbeshtetje per energjine	0	5.000	2.500	0	0	0	Support for energy
5	Shpenzime per Sig.Shog e Shendet	60.029	71.095	44.431	76.003	82.112	89.332	Social insurance outlays
	Sigurime Shoqerore	53.783	61.013	39.072	64.913	69.913	75.713	Social insurance
	Sigurime Shendetesore	6.246	10.082	5.360	11.090	12.199	13.619	Health insurance
6	Shpenzime per Buxhetin Lokal	22.713	26.214	10.840	29.566	33.850	38.538	Local Budget expenditure
	Buxheti lokal (Granti)		12.875		13.984	15.295	16.810	Local Budget (Grant)
	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta)		13.339		15.582	18.555	21.728	Local Budget (Own revenues)
7	Shpenzime te tjera	13.775	14.114	7.230	15.442	17.766	19.716	Other expenditures
	Pagesa e Papunesise	937	1.102	580	1.000	1.230	1.367	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike dhe paaftesia	12.838	10.856	6.650	12.042	13.536	15.349	Social assistance
	Kompensim per ish te perndjekurit politike		400		1.000	1.000	1.000	Compensation for ex political prisoners
	Kompensim per energjine elektrike		1.756		1.400	2.000	2.000	Compensation for electricity
8	Kompensim ne vlore i pronareve	500	500	500	500	500	600	Property Compensation
II.	Fondi Rezerve, Kontigjencia	3.800	0	10.600	10.700	11.300	11.300	Reserve fund, Contingency
	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	1.800		2.000	2.500	2.500	2.500	CoM Reserve Fund
	Fondi Kontigjence per Politika Pagash&Pensionesh		0	4.600	4.000	4.000	4.000	Contingency for Wages and Pensions Increase
	Fond Kontigjence		2.000	4.000	4.200	4.800	4.800	Contingency for Deficit
III.	Shpenzime Kapitale	51.108	70.081	17.284	105.520	72.304	82.145	Capital expenditures
	Financimi Brendshem	35.440	49.130	12.586	38.783	45.437	56.556	Domestic financing
	Nga e cila: Kontigjence per inv.publike		1.000		4.000	5.000	6.000	Of which: Contingency
	Grant Konkurses per Arsimin (P.Vendor)		1.600		2.029			Competition Grant for Education (Loc. Gov.)
	Grant Konkurses per Shendetesine (P.Vendor)		800		380			Competition Grant for Health (Loc. Gov.)
	Grant Konkurses per Ujesj.Kanalizime (P.Vendor)		1.000		1.000			Competition Grant for Water Supply (Loc. Gov.)
	Grant Konkurses per Thertore dhe Tregje (P.Vendor)				100			Competitive Grant for constr. of wholesale agric. markt.
	Financimi Huaj	15.668	20.951	4.698	66.737	26.867	25.589	Foreign financing
IV	Transferte kapitale	2.848	0	0	0	0	0	Capital Trans/Guarantee Fond
	DEFICITI	-29.372	-45.439	7.275	-85.348	-45.895	-46.940	Cash balance
	FINANCIMI DEFICITIT	29.372	45.439	-7.275	85.348	45.895	46.940	Financing (Cash)
	Brendshem	23.623	32.400	-8.183	29.420	28.583	30.816	Domestic
	Te ardhura nga privatizimi	1.972	14.600	65	4.140	1.000	1.000	Privatization receipts
	Hua-marje e brendshme	20.742	17.800	11.733	25.279	27.583	29.816	Domestic borrowing
	Te tjera	909		-19.982				Other
	I Huaj	5.749	13.039	908	55.929	17.312	16.124	Foreign
	Hua afatgjate (e marre)	9.936	17.239	3.936	62.229	23.812	23.124	Long-term Loan(Drawings)
	Mbeshtetje buxhetore (DPL)		900					
	Ndryshimi i gjendjes se arkesh*	403		-495				Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-4.590	-5.100	-2.533	-6.300	-6.500	-7.000	Repayments
	Mbeshtetje buxhetore							Budget Support
	Produkti i Brendshem Bruto (PBB)	899.700	982.200	0	1.075.718	1.176.600	1.293.100	Gross Domestic Product (GDP)

Tabela 6. Treguesit Fiskale te PBA 2008-2010 (ne % te PBB)

TREGUESIT FISKALE TE PBA 2008-2010
(FISCAL INDICATORS FOR MTBP 2008-2010)
ne % te PBB (in % of GDP)

Nr.	E M E R T I M I	Fakt	Buxheti 2007	Buxheti i Rishikuar	P/Buxheti 2008	P/Buxheti 2009	P/Buxheti 2010	I T E M S
		2006	2007	2007	2008	2009	2010	
	TOTALI TE ARDHURAVE	25,50%	25,84%	26,91%	26,37%	26,71%	27,36%	TOTAL REVENUE
I.	Te ardhura nga ndihmat	0,89%	0,65%	0,40%	0,44%	0,26%	0,19%	Grants
	Nga kjo:Mbeshtetje buxhetore	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	From which: Budget Support
II.	Te ardhura tatimore	22,84%	23,42%	24,04%	24,39%	24,92%	25,68%	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	17,24%	17,71%	18,32%	18,19%	18,22%	18,73%	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	8,25%	8,69%	8,94%	1,34%	9,19%	9,37%	V.A. T & Turnover Tax
2	Tatimi mbi Fitimin	2,47%	2,33%	2,33%	3,58%	1,50%	1,61%	Profit Tax
3	Akcizat	2,56%	2,75%	2,94%	#REF!	3,52%	3,59%	Excise Tax
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	0,95%	1,10%	1,32%	1,51%	1,68%	1,88%	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	1,45%	1,63%	1,67%	1,60%	1,83%	1,85%	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	1,56%	1,20%	1,13%	0,87%	0,49%	0,43%	Customs Duties
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	1,24%	1,35%	1,36%	1,45%	1,58%	1,68%	Local
1	Taksa Lokale	0,80%	0,85%	0,85%	0,88%	0,93%	0,93%	Local Taxes
2	Tatimi mbi Pasurine(ndertesat)	0,14%	0,22%	0,23%	0,29%	0,37%	0,48%	Property Tax
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	0,29%	0,27%	0,27%	0,28%	0,28%	0,28%	Small Business Tax
II.3	Te ardh. Buxh. Pavarur (kontribute)	4,37%	4,36%	4,36%	4,75%	5,13%	5,27%	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shogoror	3,97%	3,90%	3,90%	4,26%	4,60%	4,73%	Social Insurance
2	Sigurimi Shendetesor	0,40%	0,46%	0,46%	0,49%	0,52%	0,54%	Health insurance
III.	Te ardhura Jotatimore	1,77%	1,77%	2,47%	1,54%	1,53%	1,48%	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	0,58%	0,52%	0,52%	0,51%	0,48%	0,45%	Profit transfer from BOA
2	Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	0,92%	1,07%	1,07%	0,93%	0,94%	0,93%	Income of budgetary institutions
3	Dividenti	0,00%	0,07%	0,74%	0,01%	0,02%	0,03%	Divident
4	Te tjera	0,27%	0,11%	0,11%	0,09%	0,08%	0,08%	Other/not allocated
	TOTAL I SHPENZIMEVE	28,77%	30,61%	31,53%	34,31%	30,61%	30,99%	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	22,77%	22,92%	24,01%	23,51%	23,56%	23,76%	Current Expenditures
1	Personeli	6,30%	5,96%	6,44%	6,32%	6,09%	6,21%	Personnel expenditures
	Paga	5,07%	4,95%	5,01%	5,31%	0,00%	0,00%	Wages
	Kontributi per Sigurime Shogorore	1,24%	1,01%	1,01%	1,01%	0,00%	0,00%	Social insurance contributions
	Politikat e reja pagash	0,00%	0,00%	0,42%	0,00%	0,00%	0,00%	Of which: Contingency for new policies
2	Interesat	2,78%	3,01%	2,87%	3,10%	3,09%	2,98%	Interest
	Te Brendshme	2,55%	2,59%	2,52%	2,70%	2,59%	2,47%	Domestic
	Te Huaja	0,23%	0,42%	0,35%	0,40%	0,50%	0,50%	Foreign
3	Shpenzime Operative Mirembajtje	2,53%	2,44%	2,53%	2,59%	2,73%	2,89%	Operational & Maintenance
	Nga e cila: Financim i Huaj	0,00%	0,02%	0,02%	0,02%	0,00%	0,00%	From which: Foreign Financing
4	Subvencionet	0,43%	0,27%	0,27%	0,21%	0,24%	0,22%	Subsidies
5	Mbeshtetje per energji	0,00%	0,00%	0,51%	0,00%	0,00%	0,00%	Social insurance outlays
6	Shpenzime per Sig.Shog e Shendet	6,67%	7,11%	7,24%	7,07%	6,98%	6,91%	Social insurance
	Sigurime Shogorore	5,98%	6,08%	6,21%	6,03%	5,94%	5,86%	Social insurance
	Sigurime Shendetesore	0,69%	1,03%	1,03%	1,03%	1,04%	1,05%	Health insurance
7	Shpenzime per Buxhetin Lokal	2,52%	2,63%	2,67%	2,75%	2,88%	2,98%	Local Budget expenditure
	Buxheti lokal (Granti)	0,00%	1,29%	1,31%	1,30%	1,30%	1,30%	Local Budget (Grant)
	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta)	0,00%	1,35%	1,36%	1,45%	1,58%	1,68%	Local Budget (Own revenues)
8	Shpenzime te tjera	1,53%	1,46%	1,44%	1,44%	1,51%	1,52%	Other expenditures
	Pagesa e Papunesise	0,10%	0,11%	0,11%	0,09%	0,10%	0,11%	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike	1,43%	1,11%	1,11%	1,12%	1,15%	1,19%	Social assistance
	Kompensim per ish te perndjekurit politike	0,00%	0,04%	0,04%	0,09%	0,08%	0,08%	Compensation for ex political prisoners
	Kompensim per energji elektrike	0,00%	0,20%	0,18%	0,13%	0,17%	0,15%	Compensation for electricity
9	Kompensim ne vleren e pronareve	0,00%	0,05%	0,05%	0,05%	0,04%	0,05%	Property Compensation
II.	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0,00%	0,59%	0,39%	0,99%	0,91%	0,87%	Reserve fund, Contingency
	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	0,00%	0,17%	0,18%	0,19%	0,21%	0,19%	CoM Reserve Fund
	Fondi Kontigjenca per Politika Pagash dhe Pensionesh	0,00%	0,41%	0,00%	0,43%	0,34%	0,31%	Contingency for Wages and Pensions Increase
	Fondi Kontigjenca per Investime Publike	0,00%	0,00%	0,20%	0,37%	0,36%	0,37%	Contingency for Investments
III.	Shpenzime Kapitale	5,68%	7,10%	7,14%	9,81%	6,15%	6,35%	Capital expenditures
	Financimi Brendshem	3,94%	3,80%	5,00%	3,61%	3,86%	4,37%	Domestic financing
	Nga e cila: Kontigjenca per investime publike	0,00%	0,31%	0,10%	0,37%	0,42%	0,46%	Of which: Contingency
	Grant Konkurses per Arsimin (P. Vendor)	0,00%	0,16%	0,16%	0,19%	0,00%	0,00%	Competition Grant for Education (Loc. Gov.)
	Grant Konkurses per Shendetesine (P. Vendor)	0,00%	0,08%	0,08%	0,04%	0,00%	0,00%	Competition Grant for Health (Loc. Gov.)
	Grant Konkurses per Ujesjeltesa & Kanalizime	0,00%	0,10%	0,10%	0,09%	0,00%	0,00%	Competition Grant for Water Supply (Loc. Gov.)
	Grant Konkurses per Thertore dhe Tregje (P. Vendor)	0,00%	0,00%	0,00%	0,01%	0,00%	0,00%	Competitive Grant for constr. of wholesale agric. markt.
	Financimi Huaj	1,74%	3,30%	2,13%	6,20%	2,28%	1,98%	Foreign financing
	Transferte kapitale	0,32%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	Cash balance
	DEFICITI	-3,26%	-4,77%	-4,63%	-7,93%	-3,90%	-3,63%	Cash balance
	FINANCIMI DEFICITIT	3,26%	4,77%	4,63%	7,93%	3,90%	3,63%	Financing (Cash)
	Brendshem	2,63%	2,65%	3,30%	2,73%	2,43%	2,38%	Domestic
	Te ardhura nga privatizimi	0,22%	0,10%	1,49%	0,38%	0,08%	0,08%	Privatization receipts
	Hua-marje e brendshme	2,31%	2,55%	1,81%	2,3%	2,34%	2,31%	Domestic borrowing
	Te tjera	0,10%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	Other
I	Huaj	0,64%	2,12%	1,33%	5,20%	1,47%	1,25%	Foreign
	Hua afatgjate (e marre)	1,10%	2,67%	1,76%	5,78%	2,02%	1,79%	Long-term Loan(Drawings)
	Ndryshimi i gjendjes se arkesh*	0,04%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-0,51%	-0,55%	-0,52%	-0,59%	-0,55%	-0,54%	Repayments
	Mbeshtetje buxhetore	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	Budget Support
	Produkti i Brendshem Bruto (PBB)	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	Gross Domestic Product (GDP)

C. Programet Buxhetore Afatmesme te Ministrive

C.1 Ministria e Shendetesise

C.1.1 Misioni i Ministrise:

Permiresimi i shendetit te popullates duke ofruar sherbime shendetesore ne pergjigje te kerkesave te saj dhe mbrojtje financiare kundrejt shpenzimeve rrenuese si pasoje e semundjes.

C.1.2 Qellimet e Politikes:

107. Politika e ketij sektori eshte hartuar per te kontribuar ne arritjen e qellimeve te meposhtme afatgjata:

- Nje kuader ligjor i plote dhe modern, nje sistem financimi adekuat, burime njerezore te afta per t'u pergjigjur nevojave te sistemit shendetesor dhe nje sistem informacioni te plote ne te gjitha nivelet e sherbimit shendetesor.
- Akses me i mire per KSHP dhe ofrimi i sherbimeve sipas normave dhe standarteve te percaktuara nepemjet rritjes se autonomise se QSH.
- 100% e territorit te vendit e mbuluar me ambulanca deri ne vitin 2015.
- Niveli i vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç i reduktuar në 10/1000 lindje të gjalla deri në 2015 në krahasim me 20/1000 lindje të gjalla për vitin 2001.
- Vdekshmëria amtare në vitin 2015 e reduktuar me 1/2 nga 2001 (22,7 vdekje për 100 000 lindje të gjalla)
- 90% e popullsisë e edukuar mbi principet e kujdesit shëndetësor të gojës dhe 90% e grupmoshës 0-6 vjeç që do të përfitojë nga fluorizimi deri në vitin 2015.
- Ofrim i modeleve bashkekohore te manaxhimit te spitaleve deri ne vitin 2015, gje qe presupozon sisteme te zhvilluara informacioni klinik dhe financiar si dhe ngritjen e sistemit te monitorimit i cili do te mase performancen spitalore dhe do te lejoje akreditimin e spitaleve. Ofrimi i sherbimeve te munguara.
- Sigurimi me vaksina dhe imunizimi me vaksina të detyrueshme të mbajtur respektivisht në nivelet 100% dhe mbi 95%. 0 raste me poliomielit dhe fruth. Vetëm raste të rralla dhe sporadike për rubeolën, difterinë dhe tetanozin. Seropozitiviteti i hepatit B tek fëmijët nën 1 vjeç i ulur.
- Ulja çdo vit në masën 5% e numrit të disa infeksioneve me burim ujin si rezultat iurvejancës së sëmundjeve infektive dhe monitorimit të ujit të pijshëm.
- Laboratorët e shëndetit publik të fuqizuar totalisht deri në vitin 2015.

C.1.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise

108. Ministria e Shendetesise ka 4 programe:

- Planifikim, Menaxhim, Administrim
- Sherbimet e Kujdesit Paresor
- Sherbimet e Kujdesit Dytesor
- Shendeti Publik

109. Sektori i Shendetesise eshte nje nder sektoret me prioritare te Qeverise. Ministrise se Shendetesise i eshte akorduar nje buxhet ne vitin 2008 prej 29.7 miliarde leke.

110. Ne vitin 2010, buxheti i kesaj Ministrie pritet qe te rritet ne terma nominale me 30% krahasuar me 2008 duke zene rreth 9.6% te buxhetit total te parashikuar ne 2010.

01110 Planifikim Menaxhim Administrim

111. **Politika e ketij Programi** konsiston ne permiresimin e strukture funksionale per nje manaxhim adekuat te sistemit shendetesor; Hartimin e dokumentave politike, strategjive dhe planeve kombetare te zhvillimit te sistemit shendetesor; Ruajtjen e integritetit te piramides se sherbimeve shendetesore duke hartuar "autoritetet shendetesore rajonale" ne nivel qarku; Akreditimin, inspektimin dhe monitorimin e vazhdueshem te sektorit.
112. **Objektivat e politikës për vitin 2008:**
- Sistemi i informacionit për burimet njerezore i ngritur.
 - Kategorizimi i ri për shërbimin infermieristik i ngritur.
 - Zbatimi i planit afat-shkurter të përafrimit të legjislacionit.
113. **Produktet kryesore që do të ofrohen në 2008:**
- Manaxhimi i politikës sektoriale;
 - 11% të nevojave të plotësuara me pajisje mobilimi dhe zyre;
 - 7% të nevojave të plotësuara me ambiente të rikonstruara;
 - 8 Projekte të reja të bera; **Kosto për njësi:** 4,125 mijë lekë
 - 1 Projekt i mbështetur me kontributin e kostos lokale; **Kosto për njësi:** 3,000 mijë lekë
114. **Objektivat e politikës për vitin 2009:**
- Monitorimi i aktiviteteve të ASHR të qarqeve bazuar në standartet shendetesore.
 - Përfshirja në procesin e vendim marrjes e të paktën një përfaqësuesi nga zyra për mbrojtjen e pacientëve në cdo bord ASHR qarku.
 - 5% të tjere të stafit shendetesor të trajnuar nga qendra e formimit të vazhdueshëm profesional.
 - Pilotimi i standarteve, mbikqyrjes dhe procedurave akredituese në tre spitale.
 - Zbatimi i planit afat mesëm të përafrimit të legjislacionit.
115. **Produktet kryesore që do të ofrohen në 2009:**
- Manaxhimi i politikës sektoriale;
 - 7% të nevojave të plotësuara me ambiente të rikonstruara;
 - 8 Projekte të reja të bera; **Kosto për njësi:** 2,500 mijë lekë
116. **Objektivat e politikës për vitin 2010:**
- Monitorimi i aktiviteteve të ASHR të qarqeve bazuar në standartet shendetesore.
 - Shpërndarja e personelit dhe vendosja në institucione sipas kategorive dhe numrit të caktuar në planin kombëtar i përfunduar.
 - 10% të tjere të stafit shendetesor të trajnuar nga qendra e formimit të vazhdueshëm profesional.
 - Zbatimi i planit afat mesëm të përafrimit të legjislacionit
117. **Produktet kryesore që do të ofrohen në 2010:**
- Manaxhimi i politikës sektoriale;
 - 7% të nevojave të plotësuara me ambiente të rikonstruara;
 - 8 Projekte të reja; **Kosto për njësi:** 2,500 mijë lekë

118. Buxheti i ketij programi per vitin 2008 eshte 388 milione leke. Tavanet e propozuara per periudhen 2009-2010 jane si me poshte:

- Viti 2009 305.1 milione leke (reduktim prej 21.36% ne krahasim me vitin 2008)
- Viti 2010 342 milione leke (rritje prej 12.1% ne krahasim me vitin 2009).

07220 Sherbimet e Kujdesit Paresor

119. **Politika e ketij Programi** konsiston ne ofrimin e shërbimeve cilësore të kujdesit shëndetësor parësor të bazuar në komponentet e kujdesit kurativ, parandalues dhe promocial.

120. **Objektivat e politikës per vitin 2008:**

- 10% e fshatrave e mbuluar me ambulanca çdo vit
- 10% e QSH e plotësuar me pajisje mjeksore çdo vit.
- 4% e totalit të infrastruktures të shërbimit stomatologjik publik e përmirësuar
- 7% e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues çdo vit.
- Sistemi i informacionit në KSHP për 6 qarqe i përfunduar.
- Trajnimi i mjekut të familjes në 5 qarqe.
- Rritje ne masen 10% e kontributit te buxhetit per sigurimin e kontraceptiveve ne sherbimet publike te planifikimit familjar.

121. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2008:**

- 4,900,000 Vizita te kryera nga njesite e kujdesit shendetesor paresor; **Kosto per njesi:** 0.5 mije leke
- 54,000 Vizita obstetrikale te kryera ne keshillimoret e grave; **Kosto per njesi:** 22.6 mije leke
- 1,010,000 Vizita te kryera ne keshillimoret e femijeve te moshes 0-6 vjec; **Kosto per njesi:** 0.5 mije leke
- 303,000 Femije deri ne 18 vjec te trajtuar ne sherbimin stomatologjik; **Kosto per njesi:** 0.8 mije leke.
- 18 Projekte te reja te bera; **Kosto per njesi:** 833 mije leke
- 5% e nevojave te plotesuara me pajisje mjekesore;
- 5 Poliklinika te rehabilituara; **Kosto per njesi:** 109 milione leke
- 5% e nevojave te plotesuara me pajisje;

122. **Objektivat e politikës per vitin 2009:**

- 100% e territorit të vendit e mbuluar me ambulanca deri në vitin 2015.
- Niveli i vdekshmërisë së fëmijeve nën 5 vjeç i reduktuar në 10/1000 lindje të gjalla deri në 2015 në krahasim me 20/1000 lindje të gjalla për vitin 2001
- Vdekshmëria amtare në vitin 2015 e reduktuar me 1/2 nga 2001 (22,7 vdekje për 100 000 lindje të gjalla).
- 90% e popullsisë e edukuar mbi principet e kujdesit shëndetësor të gojës dhe 90% e grupmoshes 0-6 vjeç që do të përfitojë nga fluorizimi deri në vitin 2015.

123. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:**

- 4,900,000 Vizita te kryera nga njesite e kujdesit shendetesor paresor; **Kosto per njesi:** 0.5 mije leke

- 54,000 Vizita obstetrikale te kryera ne keshillimoret e grave; **Kosto per njesi:** 23.2 mije leke
- 1,010,000 Vizita te kryera ne keshillimoret e femijeve te moshes 0-6 vjec; **Kosto per njesi:** 0.5 mije leke
- 303,000 Femije deri ne 18 vjec te trajtuar ne sherbimin stomatologjik; **Kosto per njesi:** 0.9 mije leke
- 18 Projekte te reja te bera; **Kosto per njesi:** 2,667 mije leke
- 5% e nevojave te plotesuara me pajisje mjekesore;
- 5 Poliklinika te rehabilituara; **Kosto per njesi:** 24 milione leke

124. **Objektivat e politikës per vitin 2010:**

- 10% e fshatrave e mbuluar me ambulanca çdo vit.
- 10% e QSH e plotësuar me pajisje mjekesore çdo vit.
- Rritje në masën 10% e kontributit të buxhetit të shtetit për sigurimin e kontrceptiveve në shërbimet publike të planifikimit familjar.
- 4% e totalit të infrastruktures të shërbimit stomatologjik publik e përmirësuar
- 7% e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues çdo vit.
- Sistemi i informacionit në KSHP për 6 qarqe i përfunduar.
- Trajnimi i mjekut të familjes në 5 qarqe.

125. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2010:**

- 5,000,000 Vizita te kryera nga njesite e kujdesit shendetesor paresor; **Kosto per njesi:** 0.6 mije leke
- 59,000 Vizita obstetrikale te kryera ne keshillimoret e grave; **Kosto per njesi:** 23.3 mije leke
- 1,100,000 Vizita te kryera ne keshillimoret e femijeve te moshes 0-6 vjec; **Kosto per njesi:** 0.5 mije leke
- 333,000 Femije deri ne 18 vjec te trajtuar ne sherbimin stomatologjik; **Kosto per njesi:** 1 mije leke
- 18 Projekte te reja te bera; **Kosto per njesi:** 833.3 mije leke
- 5% e nevojave te plotesuara me pajisje mjekesore;
- 5 Poliklinika te rehabilituara; **Kosto per njesi:** 40 milione leke

126. **Standartet e Politikës per kete Program jane:**

- Ofrimi i KSHP në nivel QSH:
 - në qytet 1 mjek për 2000 banorë,
 - në fshat 1 mjek për 1700 banorë,
 - një ambulance me infermier për çdo fshat (ku nuk ka mjek).
 - numri i mjekëve të familjes 1,3 mjekë për 1000 banorë.
 - 1 mjek stomatolog për 2500 popullatë të grupmoshës 0-18 vjeç

127. Buxheti i ketij programi per vitin 2008 eshte 14.3 miliarde leke. Tavanet e propozuara per periudhen 2009-2010 jane si me poshte:

- Viti 2009 16.037 miliarde leke (rritje prej 12.1% ne krahasim me vitin 2008)
- Viti 2010 17.203 miliarde leke (rritje prej 7.3% ne krahasim me vitin 2009)

07330 Sherbimet e Kujdesit Dytesor

128. **Politika e ketij Programi** konsiston ne ofrimin e Kujdesit Spitalor ne te gjitha nivelet per nje akses me te mire, cilesi te kenaqshme dhe menaxhim kosto efektiv te ketij sherbimi. Permiresimi i cilesise se sherbimeve me anen e aplikimit te udhezuesve te praktikës klinike, sistemit te akreditimit, trajnimit te personelit, vleresimit te teknologjise mjekesore dhe te performances me ane te treguesve perkates.

129. **Objektivat e politikës per vitin 2008:**

- Permiresim i manaxhimit te burimeve njerezore dhe financiare ne spitalet universitare te Tiranes.
- Plotesim ne masen 70% i nevojave me medikamente per sherbimin e onkologjise, hematologjise, sipas skemave te miratuara nga OBSH.
- 20% me shume paciente te trajtuar per hemodialize me te gjithë komponentet.
- Dyfishim i procedurave diagnostike dhe terapeutike (numri i nderhyrjeve) ne semundjet koronare te zemres.
- Plotesim ne masen 100% i nevojave me gjak te sigurt.
- Plotesim me masen 100% i nevojave per medikamente dhe materiale mjekimi ne te gjithë spitalet e vendit.
- Permiresimi i kushteve jetesore ne spitalet psikiatrike dhe trajtimin okupacional te te semureve.
- Ngritja e tre shtepive mbeshtetese me nga 10 shtreter per te semuret e shendetit mendor ne kuader te deinstitutionalizimit te Spitaleve psikiatrike.

130. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2008:**

- 84,000 Paciente te trajtuar ne sherbimin e patologjise; **Kosto per njesi:** 44 mije leke
- 68,000 Paciente te trajtuar ne sherbimin e Kirurgjise; **Kosto per njesi:** 35.8 mije leke
- 57,000 Paciente te trajtuar ne sherbimin e pediatrie; **Kosto per njesi:** 25.4 mije leke
- 76,000 Paciente te trajtuar ne sherbimin e obsteri-gjinekologjise; **Kosto per njesi:** 17 mije leke
- 8,000 Pajisje dhe infrastruktura spitalore te mirembajtura; **Kosto per njesi:** 78.4 mije leke
- Sherbime mbeshtetese ne spitalet e vendit te siguruar;
- 15% te nevojave te plotesuara me ambjente te rikonstruara
- 23 Projektme te reja te bera; **Kosto per njesi** 1.3 milion leke
- Spitali i rehabilituar nga ana fizike; **Kosto per njesi:** 150.5 milion leke
- Nevojave te plotesuara me pajisje mjekesore;
- 1 Spital i ri i ndertuar; **Kosto per njesi:** 395.8 milion leke
- 1 Klinike e rehabilituar; **Kosto per njesi:** 720.8 milione leke

131. **Objektivat e politikës per vitin 2009:**

- Permiresimi i manaxhimit te burimeve njerezore dhe financiare ne spitalet rajonale.
- Plotesim ne masen 80% i nevojave me medikamente per sherbimin e onkologjise, hematologjise, sipas skemave te miratuara nga OBSH.
- Plotesim ne masen 100% i nevojave me gjak te sigurt.
- Plotesim me masen 100% i nevojave per medikamente dhe materiale mjekimi ne te gjithë spitalet e vendit.
- Shtimi i nje qendre te re hemodialize ne vend me 5 makineri.
- Blerje dhe instalim i 6 inceneratoreve ne spitalet e vendit.

132. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:**

- 84,000 Paciente te trajtuar ne sherbimin e patologjise; **Kosto per njesi**; 54.8 mije leke
- 68,000 Paciente te trajtuar ne sherbimin e Kirurgjise; **Kosto per njesi**; 39.6 mije leke
- 57,000 Paciente te trajtuar ne sherbimin e pediatrie; **Kosto per njesi**; 26.8 mije leke
- 76,000 Paciente te trajtuar ne sherbimin e obsteri-gjinekologjise; **Kosto per njesi**; 20.4 mije leke
- 8,000 Pajisje dhe infrastruktura spitalore te mirembajtura; **Kosto per njesi**; 83.9 mije leke
- Sherbime mbeshtese ne spitalet e vendit te siguruar;
- 15% te nevojave te plotesuara me ambjente te rikonstruktura;
- 23 Projektme te reja te bera; **Kosto per njesi**; 913 mije leke
- Nevojave te plotesuara me pajisje mjekesore;
- 6% e nevojave te plotesuara me pajisje mobilimi dhe zyre;
- 4 Projekte te mbeshtetura me kontributin e TVSH & detyrimin doganor; **Kosto per njesi** 97.5 milion leke
- 1 Spital i ri i ndertuar; **Kosto per njesi**: 200 milion leke
- 1 Klinike e rehabilituar; **Kosto per njesi**: 420 milion leke

133. **Objektivat e politikës për vitin 2010:**

- Permiresimi i manaxhimit te burimeve njerezore dhe financiare ne spitalet e rretheve.
- Plotesim ne masen 90% i nevojave me medikamente per sherbimin e onkologjise, hematologjise, sipas skemave te miratuara nga OBSH.
- Plotesim ne masen 100% i nevojave me gjak te sigurt
- Plotesim me masen 100% i nevojave per medikamente dhe materiale mjekimi ne te gjithë spitalet e vendit.
- Trajtimi i semundjeve te veshkave me anen e transplantit renal.

134. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2010:**

- 88,000 Paciente te trajtuar ne sherbimin e patologjise; **Kosto per njesi**: 58.3 mije leke
- 71,000 Paciente te trajtuar ne sherbimin e Kirurgjise; **Kosto per njesi**: 46.9 mije leke
- 66,000 Paciente te trajtuar ne sherbimin e pediatrie; **Kosto per njesi**: 29.2 mije leke
- 80,000 Paciente te trajtuar ne sherbimin e obsteri-gjinekologjise; **Kosto per njesi**: 21.4 mije leke
- 8,000 Pajisjet dhe infrastruktura spitalore te mirembajtura; **Kosto per njesi**: 112.5 mije leke
- Sherbime mbeshtese ne spitalet e vendit te siguruar;
- 23 Projektme te reja te bera; **Kosto per njesi**: 1.5 milion leke
- Nevoja te plotesuara me pajisje mjekesore;
- 1 Klinike e rehabilituar; **Kosto per njesi**: 100 milion leke
- 1 Spital i ri i ndertuar; **Kosto per njesi**: 300 milion leke
- 1 Spital i ri i ndertuar; **Kosto per njesi**: 200 milion leke

135. **Standartet e Politikës për këtë Program janë:**

- Ofrimi i kujdesit spitalor ne nivel rajoni per nje popullate mbi 200 000 banore.
- Ofrimi i kujdesit spitalor ne nivel rrethi per nje popullate mbi 100 000 banore.

136. Buxheti i ketij programi per vitin 2008 eshte 14.15 miliarde leke. Tavanet e propozuara per periudhen 2009-2010 jane si me poshte:

- Viti 2009 16.358 miliarde leke (rritje prej 15.6% ne krahasim me vitin 2008).
- Viti 2010 19.626 miliarde leke (rritje prej 20% ne krahasim me vitin 2009).

07450 Shendeti Publik

137. **Politika në shërbimet e shëndetit publik** konsiston në ruajtjen, përmirësimin e shëndetit të popullatës, parandalimin e sëmundjeve infektive dhe kronike nëpërmjet sistemit tëurvejancës dhe zbatimit të masave dhe programeve përkatëse në fushën e shëndetit publik në bashkëpunim me shërbimin e mjekësisë familjare.

138. Objektivat e politikës për vitin 2008

- Lista e indikatorëve të shëndetit mjedisor e përgatitur.
- Udhëzuesit e hetimit të shpërthimeve epidemiologjike të përgatitur.
- Raportim i sëmundjeve të caktuara i përmirësuar, proporcioni i rrethëve që raportojnë në kohë dhe me cilësi të lartë i rritur me 10% çdo vit.
- 10% e Epidemiologëve, inspektorëve sanitare dhe profesionistëve të shëndetit publik të ngritur profesionalisht në fushat përkatëse.

139. Produktet që do të ofrohen në vitin 2008

- 50 000 Femije të vaksinuar; **Kosto për njësi:** 1.8 mijë leke
- 62 400 Vrojtme të kryera për kontrollin e situatës epidemiologjike; **Kosto për njësi:** 2 mijë leke
- 12 Laboratore të shërbimeve të shëndetit publik të mirëmbajtur; **Kosto për njësi:** 5.3 milion leke
- 1 Raport përmbljedhës i indikatorëve; **Kosto për njësi:** 35.6 milion leke
- 110 Raste me HIV/AIDS; **Kosto për njësi:** 515 mijë leke
- 24 Kontrollë mjedisorë (ujë, ajër, etj); **Kosto për njësi:** 13.6 milion leke
- 15 Aktivitete promovuese në vit; **Kosto për njësi:** 6.6 milion leke
- 10% të nevojave të plotësuara me pajisje mjekësore;
- 7% të nevojave të plotësuara me pajisje mobilimi dhe zyre;
- 8% të nevojave të plotësuara me ambiente të rikonstruara;

140. Objektivat e politikës për vitin 2009:

- 10% e pajisjeve të zinxhirit ftohës e përmirësuar.
- Raportim i sëmundjeve të caktuara i përmirësuar, proporcioni i rrethëve që raportojnë në kohë dhe me cilësi të lartë i rritur me 10% çdo vit.
- 8% e Epidemiologëve, inspektorëve sanitare dhe profesionistëve të shëndetit publik të ngritur profesionalisht në fushat përkatëse.

141. Produktet që do të ofrohen në vitin 2009:

- 50 000 Femije të vaksinuar; **Kosto për njësi:** 3 mijë leke
- 62 400 Vrojtme të kryera për kontrollin e situatës epidemiologjike; **Kosto për njësi:** 0.6 mijë leke
- 12 Laboratore të shërbimeve të shëndetit publik të mirëmbajtur; **Kosto për njësi:** 7.2 milion leke
- 1 Raport përmbljedhës i indikatorëve; **Kosto për njësi:** 109.9 milion leke
- 24 Kontrollë mjedisorë (ujë, ajër, etj); **Kosto për njësi:** 18.4 milion leke
- 15 Aktivitete promovuese në vit; **Kosto për njësi:** 7.8 milion leke

- 10% te nevojave te plotesuara me pajisje mjekesore; .
- 7% te nevojave te plotesuara me pajisje mobilimi dhe zyre; .
- Ndertimi i programit me subvencionim të pages për kategori të përjashtuara grash si: gra e vajza të trafikuar, të dhunuara, gra afër moshës së pensionit, gra invalide ose me aftësi të kufizuara; **Kosto për njesi:** 1.8 milion leke
- Krijimi i një baze materiale informuese me manuale dhe udhëzues të ndryshëm mbi perkatesinë dhe barazinë gjinore nga perspektiva e mësuesve, prindërve dhe komuniteteve; **Kosto për njesi:** 1.9 milion leke

482. Buxheti i këtij programi për vitin 2008 është 11.3 milionë leke. Tavanet e propozuara për periudhën 2009-2010 janë si më poshtë:

- Viti 2009 12 milionë leke (një rritje prej 6.2% në krahasim me vitin 2008)
- Viti 2010 13 milionë leke (një rritje prej 5.79% në krahasim me vitin 2009)

C.7.4 KOMENTET E MINISTRISE SE FINANCAVE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISE SE PUNES, CESHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TE BARABARTA

Komente te Pergjithshme

Ne pergjithesi problemet e konstatuara gjate procesit ne programet e analizuara, jane si me poshte:

- Misioni i Ministrise eshte paraqitur ne menyre jo te plote.
- Qellimet dhe Objektivat e Politikes nuk jane te percaktuara qarte. Mungon impakti i matshem dhe perkufizimi i tyre ne terma kohore, ne menyre qe te dale qarte ajo cfare synohet te arrihet nga programet ne nje periudhe afatgjate (pertej periudhes se PBA-se) dhe gjate periudhes se PBA-se.
- Produktet: Ka vend per përmirësime ne lidhje me emertimin dhe pershkrimin e tyre ne menyre me te qarte.
- Kosto per njesi: Ne teresi te gjitha produktet e programeve paraqesin probleme ne drejtim te planifikimit te sasive dhe shpenzimeve apo edhe luhate shpesh te pashpjegueshme ne te tre vitet e PBA-se, gje qe i ben plotesisht te pakuptueshme kostot e rezultuara per njesi.
 - Ne disa raste nuk jane dhene sasite perkatese duke mos ofruar asnje informacion lidhur me kostot e tyre per njesi
 - Ne shume raste jane dhene sasia perkatese por jo reale, pasi kosto e tyre per njesi varion se tepermi gjate periudhes se PBA

Rekomandime

- Te realizohet transparenca në programin “Sigurimi Shoqeror”
- Per cdo program duhet të ndërtohen “grupe” të qëndrueshme objektivash të lidhura me fushat kryesore të veprimtarisë së programit perkates, për të cilat të tregohet një evoluim gjatë kohës.
- Te rishikohet kostimi i te gjithë produkteve.
- Kërkesat shtesë te paraqiten ne formatin e kërkuar dhe të shoqërohet nga një transparencë më e madhe.

C.8 Ministria e Integritit European

C.8.1 Misioni i Ministrise

Ministria e Integritit ka per mision drejtimin dhe bashkerendimin e procesit te integritit te Shqiperise ne Bashkimin European, nepermjet perafimit te legjislacionit vendas me ate te Bashkimit European, hartimit te politikave te integritit, programimin e ndihmes financiare nga Bashkimi European dhe informimit te publikut per kete proces.

C.8.2 Qellimet e Politikës

483. Politika e ketij sektori eshte hartuar per te kontribuar ne arritjen e qellimeve te meposhtme afatgjata:

- Perafrimi i legjislacionit dhe i standarteve te tjera me vendet e BE-se.
- Reformimi i plote i struktures dhe i kualifikimit te punonjesve, brenda vitit 2010 per t'iu pergjigjur me se miri sfidave te integritit.
- Ngritja e nje sistemi bashkekohor te IT-se, perditesimi dhe publikimi i vazhdueshem i veprimtarise se Ministrise ne website-n e saj.
- Orientimi dhe drejtimi i politikave shtetërore me qëllim zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA brenda një periudhe 10 vjecare të ndarë në dy faza 5 vjecare.
- Koordinimi dhe monitorimi i reformave të kërkuara në përputhje me realizimin e detyrimeve të MSA për fazën e parë dhe të dytë të zbatimit të saj.
- Forcimi i kapaciteteve prane MIE dhe njesite e integritit evropian prane ministrive te linjes dhe institucioneve te pershira per koordinimin e procesit te integritit evropian;
- Rritja ne publik e ndergjegjesimit per te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga procesi i Stabilizim-Asocimit me theks ato qe rrjedhin nga MSA;
- Vendosja/koordinimi i hapave metodologjike per procesin e perkthimit te acquis communautaire ne gjuhe shqipe.

C.8.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise

484. Ministria e Integritit European ka 3 programe:

- Planifikim, Menaxhim, Administrim
- Drejtesia dhe Tregu i Brendshem
- Mbeshtetja Institucionale per Procesin e Integritit European

485. Per vitin 2008 Ministria e Integritit European ka nje buxhet prej 159 milione leke. Ne vitin 2010 buxheti i kesaj ministrie do te jete 120 milione leke.

01110 Planifikim Menaxhim Administrim

486. **Politika e ketij Programi eshte:**

Zbatimi i planit kombetar per MSA-ne dhe i objektivave te tjera per integrimin evropian, kualifikimi dhe menaxhimi bashkekohor i burimeve njerezore, permiresimi i menaxhimit financiar, permiresimi i infrastruktures se mjediseve te punes dhe sherbimeve ndihmese ne funksion te realizimit te misionit te Ministrise se Integritit.

487. **Objektivat e politikës per vitin 2008:**

- Drejtimi dhe koordinimi i veprimtarise se Ministrise nga autoritetet kryesore drejtuese per hartimin dhe zbatimin e politikës se Qeverise ne fushen e integritit europian dhe zbatimin e MSA-se.
- Drejtimi dhe koordinimi i punes se sektoreve te Drejtorise se Sherbimeve te Brendshme, parandalimi, kontrolli dhe zgjidhja e gjendjeve te konfliktit te interesit.
- Trainimi i nje numri prej 50% te stafit, brenda e jashte vendit gjate vitit 2008, ndertimi i database per punonjesit, si dhe mbeshtetja logjistike per stafin e Ministrise.

488. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2008:

- Miremenaxhimi i burimeve njerezore, ekonomiko-financiare dhe plotesimi i nevojave logjistike te Ministrise; **Kosto per njesi:** 2.2 milion leke
- Plotesimi i database per punonjesit, rekrutimi sipas ligjit, dhe trainimi i nje numri prej 50 % te tyre, mbajtja ne gjendje te mire pune e paisjeve logjistike te Ministrise; **Kosto per njesi:** 9.6 milione leke
- Perditesimi i faqes se internetit, mirembajtja e sistemit te teknologjise se informacionit, energjise elektrike dhe telefonise fikse.; **Kosto per njesi:** 1.17 milione leke

489. Objektivat e politikës per vitin 2009

- Drejtimi dhe koordinimi i veprimtarise se Ministrise nga autoritetet kryesore drejtuese per hartimin dhe zbatimin e politikës se Qeverise ne fushen e integritit europian dhe zbatimin e MSA-se.
- Drejtimi dhe koordinimi i punes se sektoreve te Drejtorise se Sherbimeve te Brendshme, parandalimi, kontrolli dhe zgjidhja e gjendjeve te konfliktit te interesit.
- Trainimi i nje numri prej 30% te stafit, brenda e jashte vendit gjate vitit 2009, ndertimi i database per punonjesit, si dhe mbeshtetja logjistike per stafin e Ministrise.

490. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:

- Hartimi i politikave, drejtimi teknik dhe raportimi per procesin e integritit ne BE;
- Miremenaxhimi i burimeve njerezore, ekonomiko-financiare dhe plotesimi i nevojave logjistike te Ministrise; **Kosto per njesi:** 2.4 milion leke
- Perditesimi i faqes se internetit, mirembajtja e sistemit te teknologjise se informacionit, energjise elektrike dhe telefonise fikse;

491. Objektivat e politikës per vitin 2010:

- Drejtimi dhe koordinimi i veprimtarise se Ministrise nga autoritetet kryesore drejtuese per hartimin dhe zbatimin e politikës se Qeverise ne fushen e integritit europian dhe zbatimin e MSA-se.
- Drejtimi dhe koordinimi i punes se sektoreve te Drejtorise se Sherbimeve te Brendshme, parandalimi, kontrolli dhe zgjidhja e gjendjeve te konfliktit te interesit.
- Trainimi i nje numri prej 20% te stafit, brenda e jashte vendit gjate vitit 2010, ndertimi i database per punonjesit, rekrutimi dhe lirimi nga sherbimi civil, si dhe mbeshtetja logjistike per stafin e Ministrise.

492. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2010:

- Hartimi i politikave, drejtimi teknik dhe raportimi per procesin e integritit ne BE; **kosto per njesi:** 26.6 milion leke

- Miremenaxhimi i burimeve njerezore, ekonomiko-financiare dhe plotesimi i nevojave logjistike te Ministrise; **kosto per njesi:** 2.5 milion leke
- Perditesimi i faqes se internetit, mirembajtja e sistemit te teknologjise se informacionit, energjise elektrike dhe telefonise fikse; **kosto per njesi:** 3.4 milion leke
- Paisje te reja elektrike dhe elektronike ne sherbim te punes se punonjesve; **kosto per njesi:** 6 milion leke

493. Buxheti i ketij programi per vitin 2008 eshte 57.8 milione leke. Tavanet e propozuara per periudhen 2009-2010 jane si me poshte:

- Viti 2009 59 milione leke (rritje prej 2% ne krahasim me vitin 2008)
- Viti 2010 62 milione leke (rritje prej 5.1% ne krahasim me vitin 2009)

01140 Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm

494. Politika e ketij Programi

Përshpejtimi dhe garantimi i procesit të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) me synim përgatitjen e vendit për tu anëtarësuar në Bashkimin Europian .

495. Objektivat e politikës për vitin 2008:

- Mbështetje gjate gjithë vitit për funksionimin dhe monitorimin e rezultateve te 12 njësive të integritetit.
- Institucionalizimi i 20 grupeve ndërmministrore të punës në përputhje me fushat e zbatimit të MSA.
- Adresimi i prioriteteve te reja te dala nga dokumentat themelore te BE (Paketa e Zgjerimit).
- Perafrimi i legjislacionit vendas me ate te BE, per fushat prioritare te fazes se pare 5 vjecar
- Mbështetje për Trajnimin e rreth 900 nëpunësve civilë për çështjet e integritetit evropian.

496. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2008:

- Raporte te monitorimit te zbatimit te detyrimeve qe rrjedhin nga MSA/MN;
- Plani Kombetar per Zbatimin e MSA-së, i rishikuara mbi baze vjetore; **kosto per njesi:** 605 mije leke
- Akte ligjore/nënligjore shqiptare te certifikuara per perputhshmerine e tyre me aktet komunitare;
- Nëpunës civilë që kanë përfituar nga asistenca teknike e TAIEX;
- Nëpunës civilë që kanë përfituar nga trajnime të projekteve të Bashkimit Europian;

497. Objektivat e politikës për vitin 2009:

- Mbështetje gjate gjithë vitit për funksionimin dhe monitorimin e rezultateve te 12 njësive të integritetit
- Adresimi i prioriteteve te reja te dala nga dokumentat themelore te BE (Paketa e Zgjerimit)
- Perafrimi i legjislacionit vendas me ate te BE, per fushat prioritare te fazes se pare 5 vjecar
- Mbështetje për Trajnimin e rreth 900 nëpunësve civilë për çështjet e integritetit evropian.

498. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:

- Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, i rishikuara mbi baze vjetore; **kosto per njesi:** 748 mije leke
- Nëpunës civilë që kanë përfitur nga asistenca teknike e TAIEX;
- Raporte te monitorimit te zbatimit te detyrimeve qe rrjedhin nga MSA/MN;
- Akte ligjore/nënligjore shqiptare te certifikuara për përputhshmërinë e tyre me aktet komunitare; **kosto per njesi:** 25 mije leke
- Nëpunës civilë që kanë përfitur nga trajnime të projekteve të Bashkimit European; **kosto per njesi:** 7 mije leke

499. Objektivat e politikës per vitin 2010:

- Rishikimi i PKZMSA në zbatim të prioritetëve të MSA-së, Partneritetit Evropian, vlerësimeve te Raportit Vjetor te Komisionit European per Shqipërinë dhe rekomandimeve te grupeve te ndryshme te punes.
- Vlerësimi i përputhshmërisë së rreth 270 projektakteve normative shqiptare me legjislacionin komunitar.
- Kontrolli i përkthimit të rreth 170 akteve legjislative komunitare.
- Konsolidimi i nje rrjeti qendror te dhenash mbi procesin e monitorimit te zbatimit te MSA (perfshi aktet ligjore e nenligjore qe transpozohen nga ministritë e linjes), te aksesueshem/interaktiv nga te gjitha ministritë e linjes.
- Mbështetje për Trajnimin e rreth 1200 nëpunësve civilë për çështjet e integritimit evropian.

500. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2010:

- Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, i rishikuara mbi baze vjetore; **kosto per njesi:** 757 mije leke
- Nëpunës civilë që kanë përfitur nga asistenca teknike e TAIEX;
- Raporte te monitorimit te zbatimit te detyrimeve qe rrjedhin nga MSA/MN;
- Akte ligjore/nënligjore shqiptare te certifikuara për përputhshmërinë e tyre me aktet komunitare; **kosto per njesi:** 745 mije leke
- Nëpunës civilë që kanë përfitur nga trajnime të projekteve të Bashkimit European;

501. Standartet e Politikës se Programit jane:

- Aktet ligjore dhe nënligjore shqiptare të përafruara me acquis nuk duhet të jenë më pak se 370
- Forcimi i kapaciteteve administrative në institucionet shtetërore me qëllim përballimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA.

502. Buxheti i këtij programi per vitin 2008 eshte 29.34 milione leke. Tavanet e propozuara per periudhen 2009-2010 jane si me poshte:

- Viti 2009 29.91 milione leke (rritje prej 2% ne krahasim me vitin 2008)
- Viti 2010 31.62 milione leke (rritje prej 5.74% ne krahasim me vitin 2009)

01150 Mbeshtetja Institucionale per Procesin e Integritimit European

503. **Politika e Programit:** Mbeshtetja institucionale dhe financiare e procesit te Integritimit European te Shqiperise per te siguruar kuptimin dhe zbatimin e detyrimeve qe rrjedhin nga procesi i Stabilizimit dhe Asocimit.

504. Objektivat e politikës per vitin 2008

- Permiresimi i cilesise se projekteve te financuara nga asistenca e BE duke siguruar nje lidhje me te mire me prioritetet e procesit te SA
- Intensifikimi i fushatave informuese dhe institucionalizimi i bashkepunimit me grupet e interesit rreth procesit te integritit. Perkthimi i legjislacionit europian

505. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2008:

- Metodologji raportimi;
- Kapacitete administrative te trajnuara per raportimin ne procesin e integritit
- Akte ligjore te perkthyer;
- Marreveshje vjetore Financiare te IPAs;
- Fisha sektoriale te pergatitura ne kuader te programit IPA; **kosto per njesi:** 174 mije leke
- Projekte te Programit CARDS te perfunduara me sukses dhe ne kohe;
- Projekte ne kuader te bashkepunimit rajonal te realizuara me sukses;
- Aktivitete te organizuara per ndergjegjesimin e publikut; **kosto per njesi:** 94.2 mije leke
- Grupe interesi te institucionalizuara; **kosto per njesi:** 281 mije leke
- Qendra komunikimi funksionale; **kosto per njesi:** 283 mije leke

506. Objektivat e politikes per vitin 2009:

- Programimi afat-mesem dhe vjetor i asistences komunitare. Decentralizimi i zbatimit te saj, transferimi i pergjegjesive per implementimin nga KE tek autoritetet kombetare.
- Rritja e njohurive te publikut rreth BE dhe ceshtjeve te BE-se nepermjet zbatimit te strategjise se re te komunikimit rreth procesit te integritit dhe implikimeve te tij.

507. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:

- Kapacitete administrative te trajnuara per raportimin ne procesin e integritit;
- Akte ligjore te perkthyer; **kosto per njesi:** 0.44 mije
- Marreveshje vjetore Financiare te IPA-s;
- Fisha sektoriale te pergatitura ne kuader te programit IPA; **kosto per njesi:** 170 mije leke
- Projekte te Programit CARDS te perfunduara me sukses dhe ne kohe; **kosto per njesi:** 534 mije leke
- Projekte ne kuader te bashkepunimit rajonal te realizuara me sukses; **kosto per njesi:** 256 mije leke
- Aktivitete te organizuara per ndergjegjesimin e publikut; **kosto per njesi:** 106 mije leke
- Grupe interesi te institucionalizuara; **kosto per njesi:** 285 mije leke
- Qendra komunikimi funksionale; **kosto per njesi:** 145 mije leke

508. Objektivat e politikes per vitin 2010:

- Transferimi thuajse i plote i pronesise se programimit dhe zbatimit te asistences se BE autoriteteve kombetare
- Intensifikimi i komunikimit me publikun dhe forcimi i rolit te tij ne politikeberjen dhe ceshtjet e procesit te integritit European te Shqiperise.

509. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2010:

- Metodologji raportimi;
- Kapacitete administrative te trajnuara per raportimin ne procesin e integritit;
- Akte ligjore te perkthyer; **Kosto per njesi:** 0.4 mije leke

- Marreveshje vjetore Financiare te IPA-s;
- Fisha sektoriale te pergatitura ne kuader te programit IPA; **Kosto per njesi:** 171 mije leke
- Projekte te Programit CARDS te perfunduara me sukses dhe ne kohe; **Kosto per njesi:** 118 mije leke
- Projekte ne kuader te bashkepunimit rajonal te realizuara me sukses; **Kosto per njesi:** 64 mije leke
- Aktivitete te organizuara per ndergjegjesimin e publikut; **Kosto per njesi:** 87 mije leke
- Grupe interesi te institucionalizuara; **Kosto per njesi:** 285 mije leke
- Qendra komunikimi funksionale; **Kosto per njesi:** 145 mije leke

510. **Standartet e Politikes** per kete program jane:

- 70% e popullsisë e mireinformuar mbi BE dhe procesin e stabilizim-asocimit
- 30% e Acquis e perkthyer ne baze te programimit dhe nevojave te percaktuara ne Planin Kombetar te Zbatimit te MSA-se
- Nivele te kenaqshme absorbimi (90%) te ndihmes financiare te BE-se per Shqiperine.

511. Buxheti i ketij programi per vitin 2008 eshte 71.84 milione leke. Tavanet e propozuara per periudhen 2009-2010 jane si me poshte:

- Viti 2009 25.38 milione leke (reduktim prej 64.7% ne krahasim me vitin 2008).
- Viti 2010 26.87 milione leke (nje rritje prej 5.9% ne krahasim me vitin 2009).

C.8.4 KOMENTET E MINISTRISE SE FINANCIVE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISE SE INTEGRIMIT EUROPIAN

Komente te pergjithshme

Nga analiza e realizuar per programet e kesaj ministrie, rezulton se jane bere disa perpjekje nga disa prej EMP te Ministrise per nje permiresim te dokumentit ne krahasim me fazen e pare te PBA-se. Misioni i ministrise eshte i sakte dhe gjithepershires. Struktura e Programeve eshte e percaktuar qarte dhe eshte e pershtatshme per te levruar e sherbimet e ministrise sipas deklarates se misionit.

Ne pergjithesi problemet e konstatuara gjate procesit ne programet e analizuara, jane si me poshte:

- Qellimet e Politikes jane percaktuar ne pergjithesi qarte, por mungojne termat kohore.
- Ne pergjithesi, objektivat nuk jane te formuluara qarte, si edhe mungon informacioni per evoluimin e tyre.
- Produktet:
 - Ne shumicen e programeve, produktet duhet te emertohen dhe pershkruhen me qarte.
 - Ne disa raste nuk jane dhene sasite perkatese duke mos ofruar asnje informacion lidhur me koston e tyre per njesi.
 - Ne shume raste jane dhene sasi perkatese por jo reale, pasi kosto e tyre per njesi varion se tepermi gjate periudhes se PBA

Rekomandime

- EMP duhet te sigurojne qe qellimet dhe objektivat te kene masa realizimi si dhe te jene te perditesuara ne menyre qe te reflektojne vazhdimesine e procesit te implementimit te tyre.
- Gjithashtu, EMP duhet te rishikojne ne teresi produktet si nga ana e rikonceptimit te tyre ashtu edhe nga pikepamja e koston per njesi.

C.9 Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve

C.9.1 Misioni i Ministrise:

Mbrojtja, forcimi dhe shpalosja e identitetit kombëtar, përkundrejt sfidave të tregut dhe në veçanti të ekspansionit globalist, parimi bazë i politikës së qeverisë në drejtim të artit dhe kulturës. Mbështetur në këtë parim, M.T.K.R.S. harton, programon dhe zhvillon politikat kombëtare të turizmit, kulturës, rinisë dhe sporteve dhe integrimin kulturor në familjen europiane dhe botërore, në përputhje me këtë program.

C.9.2 Qellimet e Politikës:

- Udhëheqja dhe mbështetja e procesit të ristrukturimit të sistemit të MTKRS, në tërë komponentët e tij të vecantë dhe në bashkëveprim të ndërsjelltë midis Turizmit, Trashëgimisë, Artit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në funksion të krijimit të kushteve dhe një mjedisi të favorshëm për të ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në zhvillimin e tyre.
- Rritja e standarteve të menaxhimit dhe trajtimit të trashëgimisë shpirtërore dhe përafrimi i tyre me standartet e vendeve europiane
- Zbatimi i legjislacionit në fushën e artit dhe të kulturës për mirëmenaxhimin e institucioneve dhe subjekteve të interesuara përmes krijimit të Qendrës së Artit Skenik, sipas implementimit të ligjit “Për artin skenik” me qëllim administrimin dhe menaxhimin e fondeve si krijimtari intelektuale dhe shpirtërore që ndikon në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor kombëtar.
- Mbrojtja e pronësive intelektuale në Shqipëri në nivel të ngjashëm me Bashkimin Europian.
- Mbështetje e artistëve, për rezultatet e niveleve të larta, duke i konsideruar si pasuri kombëtare dhe trajtimi me maksimumin e mundësive për të garantuar arritjen e vazhdueshme të cilësisë së lartë.
- Ruajtja e identitetit të kultures shqiptare në vendet me emigracion të madh, nëpërmjet krijimit të instituteve të kulturës në ato vende.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e sportit, rritja e kontributit të llojarive sportive në financimin e sportit, me synim krijimin e kushteve sa më të mira për rritjen e ushtruesve në sport dhe cilësinë sportive
- Përmirësimin e infrastrukturës sportive aktuale dhe ngritja e një qendre sportive kombëtare, për grumbullimin e sportistëve cilësor, duke rritur cilësinë e shërbimit të ofruar dhe rritjen e cilësisë sportive nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës sportive.
- Adaptimi dhe zhvillimi i kuadrit ligjor dhe rregulloreve përkatëse për turizmin në përputhje me legjislacionin e ri për turizmin dhe standarteve të OBT-së.
- Përmirësimi i imazhit turistik të Shqipërisë dhe realizimi i marketingut dhe promocionit shqiptar me synim krijimin e identitetit dhe të pozicionimit të saj në tregun ndërkombëtar, si destinacion turistik i interesit të vecantë dhe i një kulture të larmishme.
- Zhvillimi i industrisë turistike, në përputhje me drejtimet strategjike të zhvillimit të turizmit

C.9.3 Programet e Shpenzimeve të Ministrise

512. Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve ka 6 programe:

- Planifikim, Menaxhim dhe Administrim
- Trashëgimia kulturore dhe kultet
- Arti dhe Kultura
- Zhvillimi i Sportit
- Programe Specifike Kulturore
- Zhvillimi i Turizmit

513. Kjo ministri ka nje buxhet prej 2.4 miliarde leke ne vitin 2008. Ne vitin 2010, buxheti i kesaj ministrie pritet qe te reduktohet ne terma nominale me 19.3% krahasuar me 2008 duke arritur ne nivelin 1.9 miliarde leke.

01110 Planifikim Menaxhim Administrim

514. Politika e ketij programi

Mbështetja dhe Koordinimi i të gjithë strukturave të MTKRS, nëpërmjet planifikimit të Burimeve Njerëzore, Buxhetore dhe të infrastrukturës akomoduese e shërbimeve ndihmëse, për krijimin e të gjitha kushteve në funksion të realizimit të misionit MTKRS.

515. Objektivat e politikës per vitin 2008:

- Ristrukturimi i aparatit të Ministrisë. Kompletimi i Drejtorive të Politikave me specialistë të kualifikuar të fushës në funksion të zbatimit të objektivave të programit.
- Pajisja me programe informatike financiare të nevojshme për evidentimin e pasqyrave financiare të konsoliduara periodike.

516. Produktet kryesore qe synohet te ofrohen per 2008:

- Lehtësim operativ per realizimin e objektivave funksionale; .
- Shpejtesia ne komunikim, kontrolli ne informacion dhe permiresim ne sherbim; .

517. Objektivat e politikës per vitin 2009:

- Unifikimi i të gjitha programeve të kontabilitetit në të gjitha institucionet e varësisë së MTKRS, lidhja online e të gjitha institucioneve për komunikim dhe ndjekje të shpejtë të të gjitha problematikave të ndryshme krahas komunikimit zyrtar

518. Objektivat e politikës per vitin 2010:

- Rritja e shkallës së transparencës në funksion të luftës kundër korrupsionit.

519. Produktet kryesore qe synohet te ofrohen per 2010:

- Permiresimi i strukturave dhe thithja e kapaciteteve te reja; .

520. Buxheti i ketij programi per vitin 2008 eshte 152.9 milione leke. Tavanet e propozuara per periudhen 2009-2010 jane si me poshte:

- Viti 2009 143 milione leke (rritje prej 6.5% ne krahasim me vitin 2008).
- Viti 2010 166 milione leke (rritje prej 16% ne krahasim me vitin 2009).

08220 Trashegimia Kulturore dhe Kultet

521. Politika e ketij programi

Trajtim i trashegimise kulturore si faktor per zhvillim ekonomik te qendrueshem.

522. Objektivat e politikës për vitin 2008:

- Restaurimi i monumenteve të kultures.
- Katalogimi i pasurive kulturore.
- Permiresimi i menaxhimit të institucioneve të trashëgimise.

523. Produktet kryesore që synohet të ofrohen për 2008:

- Monumente të restauruara; .

524. Objektivat e politikës për vitin 2009:

- Restaurimi i monumenteve të kultures.
- Katalogimi i pasurive kulturore.
- Permiresimi i menaxhimit të institucioneve të trashëgimise

525. Objektivat e politikës për vitin 2010:

- Katalogimi i pasurive kulturore.
- Permiresimi i menaxhimit të institucioneve të trashëgimise.
- Restaurimi i monumenteve të kultures.

526. Produktet kryesore që synohet të ofrohen për 2010:

- Veprimtari artistike kulturore dhe turizëm kulturor.
- Trashëgimia materiale e ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë të tillë që të jetë në funksion të turizmit kulturor.

527. Buxheti i këtij programi për vitin 2008 është 596 milionë lekë. Tavanet e propozuara për periudhën 2009-2010 janë si më poshtë:

- Viti 2009 491.9 milionë lekë (reduktim prej 17.5% në krahasim me vitin 2008).
- Viti 2010 528 milionë lekë (një rritje prej 7.34% në krahasim me vitin 2009).

08230 Arti dhe Kultura**528. Politika e këtij programi është:**

Administrimi i institucioneve që ka nën juridiksion, nepermjet mbështetjes dhe financimit, të aktiviteteve artistike dhe kulturore, që zbatojnë politikën integruese dhe bashkëkohore të MTKRS, si dhe mbështetjes së mbrojtjes së pronësive intelektuale. Orienton dhe koordinon projekte të ideuara në fushën e artit dhe të kulturës nëpërmjet mbështetjes së shoqatave, individëve, shkëmbimit të eksperiencave kulturore, nxitjes së krijimtarisë së lirë..

529. Objektivat e politikës për vitin 2008:

- Zbatimi i ligjit për artin skenik, përmes ngritjes së Qendrës së Artit Skenik dhe të ligjit për librin, përmes ngritjes së Këshillit Kombëtar të librit.
- Mbështetjen financiare të projekteve private, të përbashkëta apo të ideura nga MTKRS, për nxitjen e krijimtarisë së shkrimtarëve dhe artistëve shqiptarë, si dhe krijimi i fondit për të rinjtë, prioriteti i MTKRS për angazhimin e të rinjve në jetën kulturore si dhe zbulimin e talenteve të reja.

- Krijimi fondit për të rinjtë, prioritet i MTKRS për angazhimin e të rinjve në jetën kulturore si dhe zbulimin e talenteve të reja.
- Mbështetje për programe specifike që kanë për qëllim krijimin e një rrjeti kombëtar të shkëmbimit të informacionit në sistemin bibliotekar në vend.
- Inkurajimi i krijuesve shqiptarë nëpërmjet shpalljes dhe vlerësimit në konkurse kombëtare në përputhje me politikat prioritare të MTKRS.
- Persosja e infrastruktures së institucioneve të varesise, me qëllim krijimin e kushteve për një art sa më elitare.
- Forcimi i kapaciteteve administrative për mbrojtjen e pronësive intelektuale përfshirë ngritjen e zyrës së drejtës së autorit.

530. Produktet kryesore që synohet të ofrohen për 2008:

- Investime në 13 objekte kulturore dhe artistike;

531. Objektivat e politikës për vitin 2009:

- Krijimi i një sistemi kualifikues për specialistët dhe menaxherët të rinj me njohuri bashkohore për tju përgjigjur kërkesave që shtrihen rritja e efektivitetit të procesit drejtues dhe menaxhues.
- Krijimi i hapësirave dhe i infrastrukturës së nevojshme në Bibliotekën Kombëtare.
- Dixhitalizimi i vlerave të rralla në Bibliotekën Kombëtare.
- Nxitja dhe mbështetja e projekteve kulturore dhe artistike, si dhe krijimi i hapësirave dhe i infrastrukturës së nevojshme të institucioneve të varesisë, për mbrojtjen dhe pasurimin e veprave që transmetojnë vlera, identitet dhe integritet.

532. Objektivat e politikës për vitin 2010:

- Rritja e numrit të projekteve që lidhen me turizmin kulturor, në funksion të zbatimit të dy strategjive Turizëm – Kulturor.
- Krijimi i hapësirave muzeale monumentale dhe shndërrimi i tyre në Parqe Letrare, me emërtime të njerëzve të shquar në ato qytete të cilat kanë një traditë të pasur kulturore.
- Ngritja e Instituteve të Kulturës Shqiptare në vendet e BE, vende në të cilat ka edhe përqendrimin e numrit më të madh të komuniteteve të shqiptarëve që jetojnë e punojnë në këto vende.

533. Produktet kryesore që synohet të ofrohen për 2010:

- Krijimi i 5 parqeve muzeale, dhe parqeve letrare në qytetet kryesore të vendit ;

534. Buxheti i këtij programi për vitin 2008 është 1.111 miliardë leke. Tavanet e propozuara për periudhën 2009-2010 janë si më poshtë:

- Viti 2009 597.1 milionë leke (reduktim prej 46.3% në krahasim me vitin 2008).
- Viti 2010 628 milionë leke (një rritje prej 5.2% në krahasim me vitin 2009).

08140 Zhvillimi i Sportit

535. Politika e këtij programi është:

Hartoni akte nënligjore duke mbështetur në këtë mënyrë organizatat sportive, për përjashtimin nga detyrimet doganore, sportistët cilësor për rezultate të larta në nivel Europian Botëror dhe Olimpik.

Financon projekte sportive dhe mbështet organizatat sportive me fonde për krijimin e kushteve sa më të mira për sportin, për cilësinë sportive, arritjen e rezultateteve të larta, kualifikimin profesional. Përmirësimin infrastrukturën sportive, jo vetëm nëpërmjet alokimit të fondeve pushtetit vendor për rikonstruksione të objekteve sportive në administrim të këtyre të fundit, por edhe në ndertime të reja të ambienteve sportive, sipas standarteve përkatëse..

536. Objektivat e politikës për vitin 2008:

- Rishikimi i ligjit për sponsorizimin; Studimi i kalimit të klubeve sportive në Sh.A.
- Përsosja e marrëdhënieve financiare në nivelin e organizatave sportive në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare me synim përfaqësimin e Shqipërisë në Lojrat Olimpike “Pekin 2008”, dhe promovimi i sportit me anën e reklamave apo bizneseve të ndryshme.
- Riorganizimi i sportit në shkollë, si baze për përcaktimin e sporteve prioritare.
- Studimi i terreneve sportive në 100 % të territorit të Republikës së Shqipërisë përfshirë edhe atyre të shkollave, për të krijuar një ide më të qartë mbi këto terrene, për të vijuar më tej me studime apo plane konkrete rikonstruksioni

537. Produktet kryesore që synohet të ofrohen për 2008:

- Rikonstruksione në 12 objekte sportive; **Kosto për njësi:** 11.037 milion leke.
- Pjesëmarrja në aktivitete Kualifikuese për Olimpiaden;

538. Objektivat e politikës për vitin 2009:

- Rishikimi i Ligjit për sportin.
- Krijimi i një sistemi kualifikues për specialistët, trajnerët, menaxherët, mjekët me njohuri bashkohore dhe përsosja e atyre aktuale është jetike për një aktivitet në zhvillim të vazhdueshëm siç është sporti.
- Përsosja e funksionimit organizativ të sportit, me synim përsosjen e marrëdhënieve financiare, rritjen e demokracisë në organizatat sportive kombëtare dhe lokale. Mbështetja e aktiviteteve europiane dhe botërore.

539. Produktet kryesore që synohet të ofrohen për 2009:

- 15 objekte sportive në rikonstruksion;
- Mbështetja e aktiviteteve kombëtare, ndërkombëtare;

540. Objektivat e politikës për vitin 2010:

- Venia në zbatim të ndryshimeve në ligjin e sponsorizimit, kalimi i klubeve në SH.A, dhe ndryshimeve të ligjit për sportin.
- Plani i investimeve do të jetë 17 objekte në rikonstruksion (stadione, fusha sporti, pallate sporti, palestër, salla stervitore etj.

541. Produktet kryesore që synohet të ofrohen për 2010:

- Organizimi i aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- 17 objekte sportive në rikonstruksion;

542. Buxheti i këtij programi për vitin 2008 është 268.4 milion leke. Tavanet e propozuara për periudhën 2009-2010 janë si më poshtë:

- Viti 2009 276 milione leke (rritje prej 4.5% ne krahasim me vitin 2008).
- Viti 2010 296.6 milione leke (rritje prej 7.5% ne krahasim me vitin 2009).

08250 Programe Specifike Kulturore

543. Politika e ketij programi eshte:

Ruajtja e identitetit kombetar nepremjet nxitjes se inisiatives private ne fusha te artit dhe kultures, rinise dhe mbrojtjes se pronesis se intelektuale

544. Objektivat e politikës per vitin 2008:

- Mbeshteja e projekteve te fushave art, kulture e shkruar, rini, pronesi intelektuale trashegimise kulturore.

545. Produktet kryesore qe synohet te ofrohen per 2008:

- Realizimi i veprimtarive artistike; .

546. Objektivat e politikës per vitin 2009:

- Rritja e nivelit dhe cilesise se projekte duke i mbeshetur ne perputhje me politikat.

547. Produktet kryesore qe synohet te ofrohen per 2009:

- Mbeshtetja e OJF dhe personaliteteve te artit; .

548. Objektivat e politikës per vitin 2010:

- Terheqja e publikut drejt artit, perfshirja e te rinjve ne jeten artistike dhe lufta kunder piraterise.

549. Buxheti per programin ne 2008 eshte 142.7 milione leke. Eshte propozuar qe buxheti per periudhen e PBA te jete:

- Viti 2009 150.5 milione leke (rritje prej 5.5% ne krahasim me vitin 2008)
- Viti 2010 161.6 milione leke (rritje prej 7.4% ne krahasim me vitin 2009)

04760 Zhvillimi i Turizmit

550. Politika e programit:

MTKRS, në bashkëpunim me aktorët e tjerë, zbaton strategjinë kombëtare të zhvillimit të turizmit, duke qenë mbështetësja kryesore në planet e veprimit për zbatimin e saj. Mbështet, mbron dhe zhvillon burimet turistike, kulturën dhe trashëgiminë e kombit shqiptar me qëllim përmirësimin e produktit dhe imazhit të Shqipërisë në botë. Rregullon veprimtarinë e bizneseve që operojnë në fushën e turizmit, në përputhje me dispozitat ligjore. Ruan dhe zhvillon trashëgiminë kulturore të Shqipërisë, duke siguruar sukses dhe rritje të shpejtë ekonomike

551. Objektivat e politikës per vitin 2008:

- Promovimi i destinacioneve turistike të Shqipërisë, sipas qarqeve nëpërmjet mbështetjes financiare të strukturave të reja që do të ngrihen në nivel lokal, Zyrat e Sherbimit Turistik.
- Rritja me 15 % e numrit të fushatave promovionale, në krahasim me vitin 2007 dhe shtimi i pjesëmarrjes në më shumë panairë ndërkombëtare të turizmit, dhe që konsiderohen të rendesishëm për promovimin e destinacioneve turistike, krahasuar me 2 vitet e mëparshëm.
- Permiresimi dhe vendosja e sistemit të sinjalistikës turistike në të gjithë destinacionet turistike të Shqipërisë.
- Permiresimi i kuadrit ligjor në fushën e turizmit, me synim rregullimin e funksionimit të aktoreve nga sektori publik dhe ai privat në sektorin e turizmit, si dhe zhvillimin e zonave turistike.
- Mbrojtja dhe ruajtja e zonave turistike, si dhe permiresimi i cilësive të shërbimeve në sektorin e turizmit.

552. Produktet kryesore që synohet të ofrohen për 2008:

- Ngritja e 12 zyrave në qendra turistike të qarqeve të Shqipërisë për ofrimin e informacionit nëpërmjet fletëpalosjeve, hartave dhe materialeve të tjera promovionale, si dhe trajtimi i ankesave të turistëve ndaj sipërmarrjeve turistike; .

553. Objektivat e politikës për vitin 2009:

- Rritja e bashkëpunimit me sektorin privat dhe donatorët e huaj për realizimin e projekteve afatshkurtet dhe afatmesëm në fushën e turizmit dhe forcimi i metejshëm i bashkëpunimit me pushtetin vendor në funksion të realizimit dhe monitorimit të këtyre projekteve.
- Rritja e games së materialeve promovionale për turizmin nga ana e cilesore dhe nga ajo sasiore dhe organizimi i një panairi ndërkombëtar të turizmit në Shqipëri.

554. Produktet kryesore që synohet të ofrohen për 2009:

- Njehsimi i punës së finances në të gjitha institucionet e varesive të MTKRS;
- Rritje e numrit të turistëve të huaj, prej sensibilizimit dhe e materialeve cilesore promovionale;

555. Objektivat e politikës për vitin 2010:

- Rritja me 30% e numrit të turistëve, krahasuar me vitin 2009 dhe zgjerimi i sezonit turistik përgjatë gjithë vitit duke diversifikuar produktin. Zhvillimi i produktit të turizmit kulturor dhe natyror dhe turizmit rural, si produkte potenciale për zhvillimin e turizmit në Shqipëri.
- Ngritja e zyrave të informacionit turistik jashtë Shqipërisë dhe rritja e pjesëmarrjes në panairë e subjekteve që operojnë në fushën e turizmit. Prezantimi i sporteve publicitare promovuese për turizmin në rrjetet e njohura ndërkombëtare televizive.

556. Produktet kryesore që synohet të ofrohen për 2010:

- Frekuentim më i lartë i Shqipërisë nga turistët e huaj, nëpërmjet materialeve promovionale me standarte bashkohore;

557. Buxheti i këtij programi për vitin 2008 është 131.9 milione leke. Tavanet e propozuara për periudhën 2009-2010 janë si më poshtë:

- Viti 2009 150 milione leke (rritje prej 13.7% në krahasim me vitin 2008).

- Viti 2010 154.8 milione leke (nje rritje prej 3.2% ne krahasim me vitin 2009).

C.9.4 KOMENTET E MINISTRIVE SE FINANCEVE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRIVE SE TURIZMIT, KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE

Komente te pergjithshme

Ne pergjithesi problemet e konstatuara gjate procesit ne programet e analizuara, jane si me poshte:

- Qellimet e programeve jane paraqitur qarte, por nuk jane specifikuar ne terma kohore.
- Objektivat ne pergjithesi jane identifikuar qarte per cdo program, por ato nuk jane paraqitur ne menyre evoluese.
- Produktet:
 - Per asnje program nuk jane percaktuar sasite perkatese te produkteve duke mos ofruar asnje informacion lidhur me kostot e tyre per njesi.
 - Per disa nga programet, produktet e evidentuara nuk jane kostuar, cka tregon se keto produkte nuk jane te nevojshme per realizimin e objektivave te percaktuar.

Rekomandime

- Programet kane nevojte per permiresime ne aspektet e artikulimit te politikes, cilesise se paraqitjes se objektivave dhe produkteve.
- Theksohet rendesia e vendosjes se sasise dhe kosos per te gjitha produktet ne menyre qe te behet e mundur analiza e kosos per njesi per secilin produkt.

C.10 Ministria e Financave

C.10.1 Misioni i Ministrise:

Misioni i Ministrise se Financave eshte te siguroje mobilizimin dhe perdorimin me eficence dhe efektivitet te burimeve financiare publike per realizimin e qellimeve dhe objektive te politikave te Qeverise.

C.10.2 Qellimet e Politikes:

558. Politika e ketij sektori eshte hartuar per te kontribuar ne arritjen e qellimeve te meposhtme afatgjata:

- Permiresimi ne vazhdimesi i aftesive drejtuese te stafit te Ministrise se Financave dhe niveleve te tjera te vendimarrjes.
- Afrimi i kushteve te punes me standartet e BE. Krijimi i nje sistemi modern te pagesave dhe kontabilitetit brenda vitit 2009.
- Hartimi dhe propozimi i ndryshimeve ne politiken fiskale me qellim mbeshtetjen e vazhdueshme te rritjes ekonomike (te programuar ne nivelet 5-6% deri ne 2013) dhe mbajtjes nen kontroll te inflacionit (intervali 2-4% i synuar).
- Ndertimi i nje sistemi efektiv te programimit buxhetor, mbi baze programesh per te gjitha institucionet buxhetore deri ne vitin 2012.
- Menaxhimi i procesit te zbatimit te buxhetit te shtetit sipas standarteve nderkombetare deri ne vitin 2012.
- Sigurimi i huamarrjes publike nepermjet nje menaxhimi aktiv me baze koston dhe riskun.
- Harmonizimi i politikave te pagesave te programit "Ekzekutimi i pagesave te ndryshme" me programin e Qeverise dhe respektimi rigoroz i kerkesave qe rrjedhin nga marreveshjet dhe aktet e vendimet gjyqesore.
- Sigurimi i menaxhimit dhe perdorimit te fondeve publike me transparence , eficence , ekonomi dhe efektivitet dhe implementimi e zhvillimi i nje sistemi modern e te qendrueshem per kontrollin e brendshem financiar publik -KBFP (Public Internal Financial Control/PIFC) me nje sherbim te pavarur te funksionimit te auditimit te brendshem dhe me nje drejtim dhe organizim qendror dhe te harmonizuar ne Ministrine e Financave, per te siguruar zbatimin e standarteve dhe praktikave me te mira nderkombetare ne kete fushe.
- Krijimi i nje institucioni eficient, brenda nje harku kohor trevjecar, ku te permiresohen ne vazhdimesi aftesite e stafit drejtues, kapacitetet institucionale dhe teknike me qellim administrimin korrekt te fondeve. Afrimi i kushteve te punes te institucionit te sigurimeve shoqerore me standartet e BE, vendosja e personave te siguruar ne qender te kujdesit te politikave sociale.
- Implementimi me sukses i te gjitha standarteve nderkombetare te luftes kunder pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit brenda vitit 2014.
- Hartimi dhe zhvillimi i nje plani kombetar te strategjive te luftes, parandaluese dhe nderjegjesuese te publikut mbi luften kunder pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit brenda vitit 2014.
- Te asistohen dhe nxiten tatim paguesite ne menyre qe te paguajne detyrimet e duhura ne perputhje me kerkesat e legjislacionit tatimor, duke siguruar qe te ardhurat tatimore dhe taksat shkojneper llogari te buxhetit te shtetit, nepermjet ofrimit te nje sistemi deklarimi dhe pagese eficient
- Te maksimizohet mbledhja e te ardhurave nga tatimet, taksat dhe kontributet e sigurimeve, brenda kuadrit te legjislacionit tatimor.
- e minimizohet kostoja e mbledhjes se te ardhurave, pa rrezikuar efektivitetin e mbledhjes se tyre si dhe sasine dhe cilesine e sherbimeve qe duhet tu ofrohen tatimpaguesve.
- Te modernizohen operationet e deklarimit, pagese dhe auditimit te tatimeve dhe taksave nepermjet zgjerimit ekstensiv dhe intensiv te procedurave te informatizuara.

- Te sigurohet zgjerimi i bazes se taksueshme, rritja e numurit te tatimpaguesve kontribues, reduktimi sinjifikativ i elementeve te evazionit dhe mospageses se detyrimeve tatimore.
- Forcimi i auditimit mbi bazen e riskut.
- Garantimi i aplikimit te drejte te legjislacionit doganor qe siguron konkurrence te lire ne treg.
- Forcimi i mireadministrimit te regjimeve doganore ekonomike me impakt ekonomik dhe social.
- Realizmin me sukses te misionit fiskal te sistemit doganor me ane te rritjes se performances ne mbledhjen e te ardhurave.

C.10.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise

559. Ministria e Financave ka 8 programe:

- Planifikim, Menaxhim dhe Administrim
- Menaxhimi i Shpenzimeve Publike
- Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme
- Auditimi i Brendshem dhe Kontrolli i Financave Publike
- Menaxhimi i Sigurimeve Shoqerore
- Lufta kunder Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore
- Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore
- Menaxhimi i te Ardhurave Doganore

560. Ministria e Finances ka nje buxhet prej 6.332 miliarde leke ne vitin 2008. Ne vitin 2010, buxheti i kesaj Ministrie parashikohet te jete 6.05 miliarde leke.

01110 Planifikim, Menaxhim, Administrim

561. **Politika e ketij programi konsiston ne** permiresimin e funksionimit dhe menaxhimit te Ministrise se Financave, zhvillimit te kapaciteteve menaxhuese per implementimin e politikave, qe bejne te mundur permbushjen e standarteve te vendosura nga BE, si dhe ne garantimin e permiresimit te vazhdueshem te burimeve njerezore dhe perdorimit me efektivitet te burimeve financiare te Ministrise.

562. **Objektivat e politikës per vitin 2008:**

- Organizimi i Trajnimeve per stafin e ri ne masen 50% dhe per stafin ekzistues ne masen 25%
- Permiresimi i sherbimeve per punonjesit e Ministrise dhe marredhenieve me te tretet.
- Menaxhimi eficient i burimeve financiare.
- Rritja e cilesise se auditimit per sigurimin e menaxhimit dhe perdorimin me efektivitet te fondeve publike.
- Mirembajtja e sistemit kompjuterik te thesarit.

563. **Produktet kryesore qe synohet te ofrohen per 2008:**

- 20 paisje zyresh te blera; **Kosto per njesi:** 150 mije leke
- 80 Trainime te kryera per stafin e ministrise; **Kosto per njesi:** 312.5 mije leke.
- 40 Auditime te kryera; **Kosto per njesi:** 250 mije leke.
- Mbeshtetje per licensat e oracle-it; **Kosto per njesi:** 4 milione leke.

564. **Objektivat e politikës per vitin 2009:**

- Organizimi i Trajnimeve per stafin e ri ne masen 50% dhe per stafin ekzistues ne masen 25%
- Permiresimi i sherbimeve per punonjesit e Ministrise dhe marredhenieve me te tretet.
- Menaxhim eficient i burimeve financiare.
- Rritja e cilesise se auditmit per sigurimin e menaxhimit dhe perdorimin me efektivitet te fondeve publike.
- Mirembajtja e sistemit kompjuterik te thesarit.

565. Produktet kryesore qe synohet te ofrohen per 2009:

- 20 paisje zyresh te blera; **Kosto per njesi:** 150 mije leke
- Godina e MoF e rikonstruktuar; **Kosto per njesi:** 13 milione leke.
- 80 Trainime te kryera per stafin e ministrise; **Kosto per njesi:** 312.5 mije leke.
- 40 Auditime te kryera; **Kosto per njesi:** 250 mije leke.
- Mbeshtetje per licensat e oracle-it; **Kosto per njesi:** 6.7 milione leke.

566. Objektivat e politikes per vitin 2010:

- Organizimi i Trajnimeve per stafin e ri ne masen 50% dhe per stafin ekzistues ne masen 25%
- Permiresimi i sherbimeve per punonjesit e Ministrise dhe marredhenieve me te tretet.
- Menaxhim eficienti i burimeve financiare.
- Rritja e cilesise se auditmit per sigurimin e menaxhimit dhe perdorimin me efektivitet te fondeve publike.
- Mirembajtja e sistemit kompjuterik te thesarit.

567. Produktet kryesore qe synohet te ofrohen per 2010:

- 20 paisje zyresh te blera; **Kosto per njesi:** 150 mije leke
- Parking i ri i ndertuar; **Kosto per njesi:** 22 milione leke.
- Trainime te kryera; **Kosto per njesi:** 10 milione leke.
- 80 Trainime te kryera per stafin e ministrise; **Kosto per njesi:** 312.5 mije leke.
- 40 Auditime te kryera; **Kosto per njesi:** 250 mije leke.
- Mbeshtetje per licensat e oracle-it; **Kosto per njesi:** 12.5 milione leke.

568. Buxheti per programin ne 2008 eshte 182.8 milione leke. Eshte propozuar qe buxheti per periudhen e PBA 2009-2010 te jete:

- Viti 2009 237.2 milione leke (rritur me 29.8% ndaj vitit 2008)
- Viti 2010 249.3 milione leke (rritur me 5.1% ndaj vitit 2009)

01120 Menaxhimi i Shpenzimeve Publike

569. Politika e ketij programi eshte:

Kryerja e analizave dhe parashikimeve makro-fiskale, permiresimi i menaxhimit te shpenzimeve publike me qellim rritjen e vazhdueshme te eficences dhe efektivitetit te perdorimit te tyre, si dhe permiresimi i menaxhimit te borxhit.

570. Objektivat e politikës për vitin 2008:

- Përgatitja e kuadrit makro-fiskal 2008-2011 si element baze për përgatitjen e Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2009-2011 dhe Buxhetit Vjetor 2009.
- Përmirësimi i programimit buxhetor , përgatitja e PBA 2009-2011, buxhetit vjetor 2009, udhëzimeve për zbatimin e buxhetit udhëzimeve të procedurave mbi aplikimet e reja të sistemit të thesarit, mbi bazën e parimeve të ligjit të ri organik të buxhetit.
- Përgatitja në kohë dhe çilesi e raporteve financiare të konsoliduara të zbatimit të buxhetit 2008, duke zbatuar pjesërisht standartet e GFS 2001.
- Përmirësimi i raportit të borxhit publik në raport me GDP-në duke ndjekur strategjinë e borxhit dhe objektivat e saj.

571. Produktet kryesore që synohet të ofrohen për 2008

- 2 analiza të kuadrit makro-fiskal të kryera;
- Buxheti vjetor i hartuar;
- 12 raporte financiare të konsoliduara;
- Borxhi i shtetit i menaxhuar efektivisht;

572. Objektivat e politikës për vitin 2009:

- Përgatitja e kuadrit makro-fiskal 2009-2012 si element baze për përgatitjen e Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2010-2012 dhe Buxhetit Vjetor 2010.
- Përmirësimi i programimit buxhetor , përgatitja e PBA 2010-2012, buxhetit vjetor 2010, udhëzimeve për zbatimin e buxhetit, sipas standarteve ndërkombëtare.
- Përgatitja në kohë dhe me çilesi e raporteve financiare të konsoliduara të zbatimit të buxhetit 2009, duke zbatuar pjesërisht standartet e GFS 2001.
- Përmirësimin e raportit të borxhit publik në raport me GDP-në duke ndjekur strategjinë e borxhit dhe objektivat e saj.

573. Produktet kryesore që synohet të ofrohen për 2009:

- 2 analiza të kuadrit makro-fiskal të kryera;
- Buxheti vjetor i hartuar;
- 12 raporte financiare të konsoliduara;
- Borxhi i shtetit i menaxhuar efektivisht;

574. Objektivat e politikës për vitin 2010:

- Përgatitja e kuadrit makro-fiskal 2010-2013 si element baze për përgatitjen e Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2011-2013 dhe Buxhetit Vjetor 2011.
- Përmirësimi i programimit buxhetor, përgatitja e PBA 2011-2013, buxhetit vjetor 2011, udhëzimeve për zbatimin e buxhetit, sipas standarteve ndërkombëtare.
- Përgatitja në kohë dhe çilesi e raporteve financiare të konsoliduara të zbatimit të buxhetit 2010.
- Përmirësimin e raportit të borxhit publik në raport me GDP-në duke ndjekur strategjinë e borxhit dhe objektivat e saj.

575. Produktet kryesore që synohet të ofrohen për 2010

- 2 analiza të kuadrit makro-fiskal të kryera;

- Buxheti vjetor i hartuar;
- 12 raporte financiare te konsoliduara;
- Borxhi i shtetit i manaxhuar efektivisht;

576. Standartet e Politikës:

651. Buxheti i alokuar per kete program ne vitin 2008 eshte 1.432 miliarde leke. Propozohet qe tavanet per periudhen e PBA 2009-2010 te jene si me poshte:

- Viti 2009 1.25 miliarde leke (nje ulje prej 12.7% krahasuar me vitin 2008)
- Viti 2010 1.35 miliarde leke (nje ulje prej 1.3% krahasuar me vitin 2009)

04240 **Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes**

652. **Politika e ketij programi** konsiston ne permiresimin e politikave kombetare per ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga permbytja, reformimi i menaxhimit te sistemit te ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga permbytja duke transferuar pergjegjesite e ujitjes tek shoqatat e perdoruesve te ujit dhe pergjegjesite e kullimit e mbrojtjes nga permbytja tek bordet e kullimit.

653. **Objektivat e politikës për vitin 2008:**

- Rehabilitimi dhe permiresimi i infrastruktures se ujitjes (me pjesmarrje ne financim edhe te shpu-ve dhe fshpu-ve) per 25 000 ha, rritja e qendrueshmerise se rezervave ujore dhe e sigurise se digave te rezervuareve nepermjet rehabilitimit te tyre (8 diga) si dhe transferimi i pergjegjesive te operimit e mirmbajtjes te ujitjes edhe per 25 000 ha te rehabilituara tek shoqatat e perdoruesve te ujit
- Rehabilitimi dhe permiresimi i infrastruktures se kullimit e mbrojtjes nga permbytja (ku perfshihen: kanalet kryesore kullues, argjinaturat dhe pendet ne anet e lumenjeve, kanale te ujerave te larta, kolektoret kryesore te kullimit dhe grykederdhjet e tyre ne det) per 30 000 ha kryesisht ne ultesiren perendimore (Shkoder, Lezhe, Durres, Lushnje, Kavaje, Fier, Vlore).
- Garantimi i funksionimit sipas kushteve teknike te 28 hidrovoreve dhe rritja e kapacitetit transportues te tyre ne total me 5% per sigurimin e kullimit te 75 000 ha

- Menaxhimi teknik (O&M, mbikqyrja, transferimi) i infrastruktures se kullimit e mbrojtjes nga permbytja per 280 000 ha dhe infrastruktures kryesore ujtese (diga, veprat e marrjes se ujit ne lumenj) nepermjet Bordeve te Kullimit, shpu-ve dhe fshpu-ve brenda zones se sherbimit te kullimit per 280 000 ha me pjesmarrjen edhe te Projektit te Menaxhimit te Burimeve Ujore.

654. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2008:**

- 30000 ha siperfaqe e tokes bujqesore me rrjet kullues te rehabilituar; **Kosto per njesi:** 14 mije leke
- 25000 ha siperfaqe e tokes bujqesore me rrjet ujites te rehabilituar; **Kosto per njesi:** 38 mije leke
- 5000 ha siperfaqe e tokes bujqesore qe mbrohet nga permbytjet lumore dhe detare; **Kosto per njesi:** 48 mije leke
- 75000 ha siperfaqe e tokes bujqesore qe kullon me hidrovore; **Kosto per njesi:** 4.5 mije leke
- 280000 ha siperfaqe kulluese dhe ujtese e tokes bujqesore e menaxhuar perkatesisht nga Bordet e Kullimit dhe sh.p.u-te dhe f.sh.p.u-te; **Kosto per njesi:** 1.54 mije leke

655. **Objektivat e politikës per vitin 2009:**

- Rehabilitimi dhe permiresimi i infrastruktures se ujitjes (me pjesmarrje ne financim edhe te shpu-ve dhe fshpu-ve) per 26 000 ha, rritja e qendrueshmerise se rezervave ujore dhe e sigurise se digave te rezervuareve nepermjet rehabilitimit te tyre (10 diga) si dhe transferimi i pergjegjesive te operimit e mirmbajtjes te ujitjes edhe per 26 000 ha te rehabilituara tek shoqatat e perdoruesve te ujit
- Rehabilitimi dhe permiresimi i infrastruktures se kullimit e mbrojtjes nga permbytja (ku perfshihen: kanalet kryesore kullues, argjinaturat dhe pendet ne anet e lumenjeve, kanale te ujerave te larta, kolektoret kryesore te kullimit dhe grykederdhjet e tyre ne det) per 32 000 ha kryesisht ne ultesiren perendimore (Shkoder, Lezhe, Durres, Lushnje, Kavaje, Fier, Vlore)
- Garantimi i funksionimit sipas kushteve teknike te 28 hidrovoreve dhe rritja e kapacitetit transportues te tyre ne total me 8 % per sigurimin e kullimit te 75 000 ha
- Menaxhimi teknik (O&M, mbikqyrja, transferimi) i infrastruktures se kullimit e mbrojtjes nga permbytja per 280 000 ha dhe infrastruktures kryesore ujtese (diga, veprat e marrjes se ujit ne lumenj) nepermjet Bordeve te Kullimit, shpu-ve dhe fshpu-ve brenda zones se sherbimit te kullimit per 280 000 ha me pjesmarrjen edhe te Projektit te Menaxhimeve te Burimeve Ujore.

656. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:**

- 32000 ha siperfaqe e tokes bujqesore me rrjet kullues te rehabilituar; **Kosto per njesi:** 13.94 mije leke
- 26000 ha siperfaqe e tokes bujqesore me rrjet ujites te rehabilituar; **Kosto per njesi:** 28.39 mije leke
- 7000 ha siperfaqe e tokes bujqesore qe mbrohet nga permbytjet lumore dhe detare; **Kosto per njesi:** 42.86 mije leke
- 75000 ha siperfaqe e tokes bujqesore qe kullon me stacione pompimi te kullimit -hidrovore; **Kosto per njesi:** 4.67 mije leke
- 280000 ha siperfaqe kulluese dhe ujtese e tokes bujqesore e menaxhuar perkatesisht nga Bordet e Kullimit dhe sh.p.u-te dhe f.sh.p.u-te; **Kosto per njesi:** 0.96 mije leke

657. **Objektivat e politikës për vitin 2010:**

- Rehabilitimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes (me pjesëmarrje në financim edhe të shpu-ve dhe fshpu-ve) për 27 000 ha, rritja e qëndrueshmërisë së rezervave ujore dhe e sigurisë së digave të rezervuarëve nëpërmjet rehabilitimit të tyre (12 diga) si dhe transferimi i përgjegjësisë të operimit e mirëmbajtjes të ujitjes edhe për 27 000 ha të rehabilituara tek shoqatat e përdoruesve të ujit
- Rehabilitimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së kullimit e mbrojtjes nga permbytja (ku përfshihen: kanalet kryesore kullues, argjinaturat dhe pendet në anet e lumenjeve, kanale të ujerave të larta, kolektorët kryesore të kullimit dhe grykëderdhjet e tyre në det) për 35 000 ha kryesisht në ultësirën perëndimore (Shkoder, Lezhe, Durrës, Lushnjë, Kavajë, Fier, Vlorë)
- Garantimi i funksionimit sipas kushteve teknike të 28 hidrovoreve dhe rritja e kapacitetit transportues të tyre në total me 10 % për sigurimin e kullimit të 75 000 ha
- Menaxhimi teknik (O&M, mbikqyrja, transferimi) i infrastrukturës së kullimit e mbrojtjes nga permbytja për 280 000 ha dhe infrastrukturës kryesore ujtesë (diga, veprat e marrjes së ujit në lumenj) nëpërmjet Bordeve të Kullimit dhe shpu-ve dhe fshpu-ve brenda zonës së shërbimit të kullimit për 280 000 ha.

658. **Produktet kryesore që do të ofrohen në 2010:**

- 35000 ha sipërfaqe e tokës bujqësore me rrjet kullues të rehabilituar; **Kosto për njësi:** 14.9 mijë leke
- 27000 ha sipërfaqe e tokës bujqësore me rrjet ujtes të rehabilituar; **Kosto për njësi:** 18.52 mijë leke
- 5000 ha sipërfaqe e tokës bujqësore që mbrohet nga permbytjet lumore dhe detare; **Kosto për njësi:** 45 mijë leke
- 75000 ha sipërfaqe e tokës bujqësore që kullon me stacione pompimi të kullimit -hidrovore; **Kosto për njësi:** 4.67 mijë leke
- 280000 ha sipërfaqe kulluese dhe ujtesë e tokës bujqësore e menaxhuar përkatesisht nga Bordet e Kullimit dhe sh.p.u-te dhe f.sh.p.u-te; **Kosto për njësi:** 0.71 mijë leke

659. **Standartet e Politikës**

- Shërbimi i operimit e mirëmbajtjes (O&M) i ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga permbytja përkatesisht nga shpu-te dhe fshpu-te Projektimi, zbatimi dhe supervizimi i kontratave të rehabilitimit dhe mirëmbajtjes për objektet e infrastrukturës së ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga permbytja bëhet sipas legjislacionit përkates për punimet e ndërtimit dhe standartet shtetërore përkatese të sigurisë si dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik. Aplikimi i normës mesatare të ujitjes me rreth 3500 m³/ ha - sezon ujtes, garantimi i modulit të kullimit në vlerat 5-7 liter/sek-ha, kullimi e mbrojtja nga permbytja me siguri përkatese të projektimit që variojnë nga 20%-1%

660. Buxheti i alokuar për këtë program në vitin 2008 është 2.38 miliardë leke. Propozohet që tavanet për periudhën e PBA 2009-2010 të jenë si më poshtë:

- Viti 2009 2.1 miliardë leke (një ulje prej 11.8% krahasuar me vitin 2008)
- Viti 2010 2 miliardë leke (një ulje prej 4% krahasuar me vitin 2009)

04250 Zhvillimi rural duke mbeshtetur prodhimin bujqesor blegtoral agroindustrial dhe marketingun

661. **Politika e ketij programi** konsiston ne krijimin e mjedisit per modernizimin dhe permiresimin e procesit teknologjik, rritjen e prodhimit dhe konkurshmerine e produkteve agro-industriale, nepermjet permiresimit te cilesise se teknologjise dhe infrastruktures se tregut. Politikat do te fokusohen gjithashtu ne blegtori, nepermjet ruajtjes se resurseve gjenetike autoktone dhe ndertimi i hallkave te reja per zbatimin e programit racor.
662. **Objektivat e politikës për vitin 2008:**
- Rritja e te ardhurave te fermereve nepermjet rritjes se siperfaqeve ne vreshtati, pemtari dhe ullinj me rreth 500 ha,
 - Rritja e siperfaqeve 10% krahasuar me vitin 2007, per prodhimin e fares se duhanit ne stacionin e duhanit Cerrik, i cili eshte i çertifikuar nga E.SH.F.F.Pajisje laboratorit me aparatura te reja: dhome kondicionimi per pergatitjen e mostrave per kontrollin analitik.
 - Permiresimi i tregtimit te produkteve blegtorale duke ndertuar nje thertore me standartet e BE-se, ku nga ana teknike pergjigjet siguria ushqimore.
 - Mbeshtetje per ruajtjen e races autoktone te buajve ne zhdukje nepermjet mbareshtimit dhe ushqimit ne rrethet Fier, Tirane, Elbasan, si dhe krijimi i nje pike kultivimi te linjave te pastra te fares se mendafshit.
 - Permiresimi i tregtimit te fruta-perimeve sipas standarteve te BE-se, duke ndertuar nje treg te fruta-perimeve.
 - Riciklimi i vlerave monetare ne formen e kredise me qellim perdorimin e tyre ne agro-industri per ngritjen e rreth 10 linjave te perpunitimit te fruta-perimeve nga projekti 2KR.
 - Pjesmarrje ne panaiire kombetare dhe nderkombetare, per promovimin e produkteve bujqesore dhe agro-industriale.
 - Ngritja e Agjensise se pagesave e cila do te sherbeje per financimin e fermereve duke identifikuar dhe mbeshtetur inisiativa rurale sipas zonave fermere potenciale per aktivitete si agroturizem etj.
 - Programi i zhvillimit te qendrueshem te zonave malore SDRMA ka objektiv rritjen e te ardhurave per ekonomite fshatare ne zonat malore te Shqiperise.
663. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2008:**
- Futja e kultivareve te mire te fares se duhanit ne stacionin e duhanit Cerrik;
 - Investim per ngritjen e nje thertore te tipit A;
 - Ruajtja e resurseve gjenetike ne ferme per mbrojtjen e races autoktone si dhe krijimi i nje pike kultivimi te linjave te pastra te fares se mendafshit;
 - Pjesemarrje ne panaiiret kombetare dhe nderkombetare;
 - Ngritja e dy tregjeve per fruta perime;
 - Riciklimi i vlerave monetare me qellim perdorimin e tyre;
664. **Objektivat e politikës për vitin 2009:**
- Rritja e te ardhurave te fermereve nepermjet rritjes se siperfaqeve ne vreshtari, pemtari dhe ullinj me rreth 600 ha,
 - Rritja e siperfaqeve 15% krahasuar me vitin 2008 si pasoje e futjes se kultivareve me te mire si dhe pajisje te laboratorit me aparatura te reja per percaktimin e shkalles se ventilimit, materiale konsumi per smoking machine, sherbime nga specialiste etj.
 - Mbeshtetje per ruajtjen e races autoktone te buajve ne zhdukje nepermjet mbareshtimit dhe ushqimit ne rrethet Fier, Tirane, Elbasan si dhe krijimi i nje farishte me sipefaqe 2 ha, per prodhimin e fidanave me varietetet e pershtatshme per krimbin e mendafshit.

- Permiresimi i tregtimit te fruta-perimeve sipas standarteve te BE-se duke ndertuar dy tregje fruta-perime, ku perfitimi nga ana e fermereve eshte lehtesimi i tregtimit te prodhimeve te vendit.
- Riciklimi i vlerave monetare ne formen e kredise dhene bizneseve agro-perpunuese per ngritjen e 10 linjave te perpunimit te fruta-perimeve duke ulur importe dhe rritur eksportet
- Pjesmarrje ne 5 panaiare kombetare dhe 3 nderkombetare per promovimin e produkteve bujqesore dhe agro-perpunuese.
- Permiresimi i tregtimit te produkteve blegtorale duke ndertuar dy thertore sipas standarteve te BE-se ku nga ana teknike do te pergjigjet siguria ushqimore.
- Konsolidimi i Agjensise se Pagesave nepermjet kryerjen e studimit ne zona te tjera pilot per mbeshtetjen e inisiativave rurale jashte fermes si agroturizem etj.
- Programi i zhvillimit te qendrueshem te zonave malore SRDMA ka objektiv rritjen e te ardhurave per ekonomite fshatare ne zonat malore te vendit.

665. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:

- Futja e kultivuesve te mire te fares se duhanit ne stacionin e duhanit Cerrik;
- Ruajtja e resurseve gjenetike ne ferme per mbrojtjen e races autoktone si dhe krijimi i nje pike kultivimi te linjave te pastra te fares se mendafshit;
- Pjesemarrje ne panaiaret kombetare dhe nderkombetare;
- Investim per ngritjen e tregut te fruta-perimeve;

666. Objektivat e politikës per vitin 2010:

- Rritja e te ardhurave te fermereve nepermjet rritjes se siperfaqeve ne vreshtari, pemtari dhe ullinj me rreth 700 ha,
- Rritja e siperfaqeve me 20% krahasuar me vitin 2009 per prodhimin e fares me gjeneracion te larte ne sektorin e duhanit Cerrik dhe kompletimi i laboratorit te AKDC me pajisje te kontrollit cilesor te duhanit. Rritja e nivelit te sherbimeve keshillimore nepermjet seminareve.
- Mbeshtetje per ruajtjen e races autoktone te buajve nepermjet mbareshtimit si dhe krijimi i nje fidanishte meme per te prodhuar ne vitin 2010 rreth 600000 fidana MANI per te furnizuar 5000-10000 fermere ne 5-6 rrethe te vendit.
- Permiresimi i tregtimit te fruta-perimeve sipas standarteve te BE-se duke ndertuar dy tregje te fruta-perimeve, qe do te sjelle si pasoje rritjen e prodhimit dhe uljen e importeve.
- Permiresimi i tregtimit te produkteve blegtorale nepermjet ndertimit te 3 thertoreve me standartet e BE-se ku nga ana teknike pergjigjet siguria ushqimore.
- Pjesmarrje ne 4 panaiare kombetare dhe 4 panaiare nderkombetare per promovimin e produkteve bujqesore dhe agro-perpunuese.
- Riciklimi i vlerave monetare ne formen e kredise me qellim perdorimin e tyre ne agro-industrii nga projekti 2KR.

667. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2010:

- Ruajtja e resurseve gjenetike ne ferme per mbrojtjen e races autoktone si dhe krijimi i nje pike kultivimi te linjave te pastra te fares se mendafshit;
- Pjesemarrje ne panaiaret kombetare dhe nderkombetare;
- Investim per ngritjen e tregut te fruta-perimeve;
- Riciklimi i vlerave monetare me qellim perdorimin e tyre;

668. **Standartet e Politikës:**

- Politikat qe do te ndiqen do te jene sipas normave dhe standarteve te BE-se, per te zbatuar sistemet e sigurise dhe cilesise te mbështetura ne standartet ISO 9001, HACCP ISO 22000, BRC, IFC dhe EUREGAP.

669. Buxheti i alokuar per kete program ne vitin 2008 eshte 1.45 miliarde leke. Propozohet qe tavanet per periudhen e PBA 2009-2010 te jene si me poshte:

- Viti 2009 925 milione leke (nje ulje prej 36.2% krahasuar me vitin 2008)
- Viti 2010 1.13 miliarde leke (nje rritje prej 22.2% krahasuar me vitin 2009)

04860 Keshillimi dhe informacioni bujqësor

670. **Politika e programit:** Konsiston ne mbështetjen me shërbime falas të fermerëve, në funksion të shtimit të prodhimit, rritjes së aftësisë konkurruese dhe rritjes së të ardhurave të fermës në mënyrë të qëndrueshme.

671. **Objektivat e politikës per vitin 2008:**

- Ofrimi i paketave teknologjike bujqësore ne pergjigje te nevojave të fermerëve duke përmirësuar dhe ofruar rreth 20 paketa teknologjike.
- Rreth 6000 fermerë ose 10% e fermerëve të kontaktuar nga Shërbimi Këshillimor implementojnë paketat teknologjike të përmirësuara dhe ofruara nga QTTB-të.
- Sigurimi i aksesit për informacion për fermerët dhe aktorë të tjerë të interesuar të sistemit bujqësor nëpërmjet kontaktimit nga Shërbimi Këshillimor të rreth 60 mijë fermerëve.

672. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2008:**

- 20 Teknologji te reja të gjeneruara/përmirësuara (kërkimi i aplikuar) të zbatuara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë; **Kosto per njesi:** 4.7 milione leke
- 2535 meter katrore (m2) Ambjente te reja te ndertuara; **Kosto per njesi:** 8.76 mije leke
- 1932 Meter katror (m2) Ambiente egzistuese te rikonstruktura; **Kosto per njesi:** 8.7 mije leke
- Blerja e 51 pajisjeve elektronike; **Kosto per njesi:** 90 mije leke
- Traktor 100 kf (kuaj fuqi) dhe 9 agregate shtese; **Kosto per njesi:** 1.1 milion leke
- 30 Kërkime në fermë të zbatuara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë; **Kosto per njesi:** 83.3 milione leke
- 20 llojet më të përshtatshme të bimëve dhe kafshëve të testuara dhe rekomanduara nga QTTB-të; **Kosto per njesi:** 2.1 milion leke
- 60000 fermere të kontaktuar direkt në aktivitetet e ekstensionit; **Kosto per njesi:** 0.03 mije leke
- 21 botime te realizuara; **Kosto per njesi:** 180 mije leke

673. **Objektivat e politikës per vitin 2009:**

- Plotësimi i nevojave të fermerëve me paketa teknologjike bujqësore duke përmirësuar dhe ofruar rreth 22 paketa teknologjike bujqësore
- Rreth 9000 fermerë ose 15% e fermerëve të kontaktuar nga Shërbimi Këshillimor implementojnë paketat teknologjike të përmirësuara dhe ofruara nga QTTB-të.

- Sigurimi i aksesit për informacion për fermerët dhe aktorë të tjerë të interesuar të sistemit bujqësor nëpërmjet kontaktimit nga Shërbimi Këshillimor të rreth 65 mijë fermerëve

674. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:**

- 22 Teknologji te reja të gjeneruara/përmirësuara (kërkimi i aplikuar) të zbatuara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë; **Kosto per njesi:** 4.8 milione leke
- 40600 meter katrore (m2) Ambjente te reja te ndertuara; **Kosto per njesi:** 0.29 mije leke
- 250 Meter katror (m2) Ambiente egzistuese te rikonstruktura; **Kosto per njesi:** 20 mije leke
- 2 Pajisje laboratorit te blera; **Kosto per njesi:** 275 mije leke
- Blerja e 26 pajisjeve elektronike; **Kosto per njesi:** 98 mije leke
- Traktor 100 kf (kuaj fuqi) dhe 4 agregate shtese; **Kosto per njesi:** 150 mije leke
- 30 Kërkime në fermë të zbatuara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë; **Kosto per njesi:** 86.67 milione leke
- 20 llojet më të përshtatshme të bimëve dhe kafshëve të testuara dhe rekomanduara nga QTTB-të; **Kosto per njesi:** 1.1 milion leke
- 60000 fermere të kontaktuar direkt në aktivitetet e ekstensionit; **Kosto per njesi:** 0.03 mije leke
- 21 botime te realizuara; **Kosto per njesi:** 180 mije leke

675. **Objektivat e politikës per vitin 2010:**

- Përmirësimi dhe ofrimi i 25 paketave të reja teknologjike bujqësore
- Rreth 13500 fermerë ose 20% e fermerëve të kontaktuar nga Shërbimi Këshillimor implementojnë paketat teknologjike të përmirësuara dhe ofruara nga QTTB-të gjatë vitit 2008.
- Sigurimi i aksesit për informacion për fermeret dhe aktore të tjera të interesuar. Shërbimi Këshillimor kontakton rreth 70 mijë fermerë.

676. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2010:**

- 25 Teknologji te reja të gjeneruara/përmirësuara (kërkimi i aplikuar) të zbatuara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë; **Kosto per njesi:** 4.4 milione leke
- 30200 meter katrore (m2) Ambjente te reja te ndertuara; **Kosto per njesi:** 0.28 mije leke
- 250 Meter katror (m2) Ambiente egzistuese te rikonstruktura; **Kosto per njesi:** 12 mije leke
- Blerja e 20 pajisjeve elektronike; **Kosto per njesi:** 115 mije leke
- Blerje e 45 pajisjeve dhe orendi zyrash per QTTB Vlore, Shkoder dhe Korce; **Kosto per njesi:** 75 mije leke
- Traktor 100 kf (kuaj fuqi) dhe 6 agregate shtese; **Kosto per njesi:** 916 mije leke
- 25 Kërkime në fermë të zbatuara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë; **Kosto per njesi:** 100 mije leke
- 30 llojet më të përshtatshme të bimëve dhe kafshëve të testuara dhe rekomanduara nga QTTB-të; **Kosto per njesi:** 220 mije leke
- 65000 fermere të kontaktuar direkt në aktivitetet e ekstensionit; **Kosto per njesi:** 0.03 mije leke
- 21 botime te realizuara; **Kosto per njesi:** 180 mije leke

677. **Standartet e Politikës**

- 80 paketa teknologjike të përmirësuara nga QTTB-të deri në vitet 2007–2010; Implementimi i paketave teknologjike nga rreth 20% e fermerëve të kontaktuar nga strukturat e Këshillimit

Bujqësor; Numri i fermerëve të kontaktuar nga Shërbimi Këshillimor (rreth 70 mijë fermerë çdo vit); Numri i Qendrave të Informacionit Bujqësor të pajisura (rreth 50 qendra në vitet 2008 – 2010); rreth 25 projekte të reja të Kërkimeve në fermë të implementuara çdo vit; 20 botime të realizuara çdo vit (6-7 broshura informative, vjetari statistikor, Buletini i Shkencave Bujqësore 2 numra në vit, revista Bujqësia Shqiptare –12 numra në vit).

678. Buxheti i alokuar për këtë program në vitin 2008 është 285.2 milione leke. Propozohet që tavanet për periudhën e PBA 2009-2010 të jenë si më poshtë:

- Viti 2009 207 milione leke (një ulje prej 27.4% në krahasim me vitin 2008)
- Viti 2010 200.1 milione leke (një ulje prej 3.4% në krahasim me vitin 2009)

05470 Menaxhimi qendrueshëm i tokës bujqësore

679. **Politika e programit:** Reforma e tokës, Tregu, Administrim i qendrueshëm dhe Mbrojtja e tokës bujqësore përbejnë strukturën themelore të menaxhimit të tokës si pjesë me rëndësi të drejtimit të strategjisë për zhvillimin afatmesëm të bujqësisë.

680. **Objektivat e politikës për vitin 2008:**

- Për reformën e tokës:
 - Venia në funksion të perfundimit të procesit të ndarjes së tokës të të gjitha strukturave shtetërore të ngarkuara nga ligji për ndarjen e tokës.
 - Harmonizimi i veprimtarisë së organeve të qeverisjes qendrore për zgjidhjen e konflikteve të pronesisë mbi tokën
 - Monitorimi i zbatimit të dispozitave ligjore në ndarjen e tokës.
- Për tregun e tokës:
 - Harmonizimi i veprimtarisë me ZQRPP për vijimesinë e Regjistrimit Fillestar në zonat kadastrale rurale dhe evidentimit të transaksioneve për tokën bujqësore.
- Për administrimin e qendrueshëm të tokës:
 - Vijimi i krijimit të Sistemit të Informacioni Tokësor (LIS) në komuna dhe qarqe të tjera të vendit duke siguruar mbështetje financiare të kësaj veprimtarie.
 - Monitorimi i zbatimit të dispozitave ligjore për kalimet e tokave dhe ndryshimit të kategorisë së resurseve.
 - Permiresime në kuadrin ligjor që rregullon funksionimin e strukturave shtetërore të administrimit të tokës.
- Për mbrojtjen e tokës:
 - Venia në funksion dhe trajnimi i strukturave të mbrojtjes së tokës.
 - Financimi i investimeve dhe shpenzimeve të nevojshme për strukturat e mbrojtjes së tokës.
 - Monitorimi i gjendjes së fondit të tokës bujqësore dhe masat ligjore të mbrojtjes së saj.

681. **Produktet kryesore që do të ofrohen në 2008:**

- Menaxhimi i procesit të reformës së tokës në qarqe;
- Inspektoriati i mbrojtjes së tokës bujqësore; .

682. **Objektivat e politikës për vitin 2009:**

- Për tregun e tokës:

- Monitorimi i dukurive te tregut te tokes dhe ndertimi i polikave ekonomike e ligjore efektive per shmangjen e prirjeve "monopol" mbi token.
- Per administrimin e qendrushem te tokes:
 - Vijimi i krijimit te LIS dhe mbeshtetja financiare e tij.
 - Monitorimi i ndryshimit te resurseve dhe vleresimit te kategorive te tokes.
 - Evidentimi i dukurive pozitive te konsolidimit te tokes dhe programi i masave per intensifikimin e veprimit te faktoreve mbeshtetes te tij
- Per mbrojtjen e tokes:
 - Organizimi i ispektimeve mbi zbatimin e dispozitave ligjore ne te gjithe territorin, aplikimi i saksioneve per shkaktaret e demtimit te tokave dhe mbeshtetja me fonde financiare te nevojshme te veprimtarise se IMT-ve dhe strukturave tjere shteterore te mbrojtjes se tokes.

683. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:**

- Inspektoriati i mbrojtjes se tokes bujqesore;

684. **Objektivat e politikës per vitin 2010:**

- Monitorimi i dukurive te tregut te tokes.
- Azhornimi i informacionit mbi gjendjen e fondit te tokes duke ndjekur kalimet dhe ndryshimet e kategorive te resurseve.
- Sigurimi i financimeve te nevojshme per krijimin e LIS.
- Organizimi i kontrolleve per mbrojtjen e tokes bujqesore.
- Sigurimi i fondeve financiare per mbeshtetjen e veprimtarise se strukturave te mbrojtjes se tokes.

685. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2010:**

- Inspektoriati i mbrojtjes se tokes bujqesore;

686. Buxheti i alokuar per kete program ne vitin 2008 eshte 9.5 milione leke. Propozohet qe tavanet per periudhen e PBA 2009-2010 te jene si me poshte:

- Viti 2009 5 milione leke (nje ulje prej 47.4% krahasuar me vitin 2008)
- Viti 2010 22 milione leke (nje rritje prej 340% krahasuar me vitin 2008)

C.11.4 KOMENTET E MINISTRISË SE FINANCAVE LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2008-2010 TE MINISTRISË SE BUJQESISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT (MBUMK)

Komente te pergjithshme

Ne pergjithesi problemet e konstatuara gjate procesit ne programet e analizuara, jane si me poshte:

- Struktura e Programeve eshte e percaktuar qarte, por mund te konsiderohet shkrirja e programit “Menaxhimi i Tokes Bujqesore” ne nje program tjeter te Ministrise
- Qellimet dhe Objektivat e Politikës nuk jane te percaktuara qarte si dhe nuk reflektojne plotesisht prioritetet e Qeverise
- Produktet:

- Ne shumicen e programeve, produktet duhet te emertohen dhe pershkruhen me qarte
 - Ne disa raste nuk jane dhene sasite perkatese duke mos ofruar asnje informacion lidhur me kostot e tyre per njesi
 - Ne shume raste jane dhene sasi perkatese por jo reale, pasi kosto e tyre per njesi varion se tepermi gjate periudhes se PBA
- Paraqitja e projekteve te investimeve nga kjo ministri ka rezultuar me probleme per sa i perket plotesimit sipas kriterave te percaktuara te projekteve te investimeve. Ne shume raste mungojne kostot totale te projekteve.

Rekomandime

- Te gjitha programet e Ministrise kane nevojte te permiresohen ne aspektet e artikulimit te deklarates se politikave dhe cilesise se paraqitjes se objektivave per te dhene evolimin e tyre nga njeri vit ne tjetrin.
- Duhet te pasqyrohen qarte emertimet e produkteve, sasite e tyre dhe te jepet me shume informacion ne pershkrimin e produkteve dhe te kostos per njesi te tyre.
- Funksionimi i plote i Grupit per Strategji, Buxhet dhe Integrim i Ministrise do te adresonte qartesisht problemet e evidentuara nga analizat e kryera nga Ministria e Financave si dhe permiresimet qe kerkohen per te pasur nje Kerkese per PBA brenda standarteve te kerkuara.

C.12 Ministria e Arsimit dhe Shkences

C.12.2 Qellimet e Politikës

687. Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Përmirësimi i kapaciteteve dhe aftësive menaxhuese në nivelin qendror (MASH), rajonal (DAR dhe ZA), lokal (shkollat) si dhe i institucioneve që varen nga MASH.
- Decentralizimi i shërbimit arsimor.
- Rritja e autonomisë së shkollave.
- Instalimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në shërbimin arsimor (EMIS).
- Përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës së shërbimit arsimor
- Rritja e viteve të shkollimit, duke zgjatur periudhën e arsimit bazë nga 8 në 9 vjet, për të rritur mesataren e viteve të shkollimit të popullsisë nga 9.6 në 11.2 deri në 2015.
- Rritja e raportit të regjistrimit neto (NER) nga 94% në 95% të nxënësve që frekuentojnë arsimin e bazë deri në 2015.
- Rritja e përqindjes së fëmijëve që frekuentojnë arsimin parashkollor në masën 59% në 2010.
- Shtimi i numrit të shkollave dhe klasave si dhe përmirësimi i mjediseve shkollore me synim arritjen e kushteve optimale mësimore dhe pajisja e shkollave me mjete laboratorike didaktike dhe kompjutera si dhe me pajisje të nevojshme shkollore
- Rritja e rezultateve të shkollimit nëpërmjet zbatimit të standardeve të përmbajtjes dhe të arritjes.
- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, nëpërmjet rritjes së motivimit të mësuesve dhe trajnimit e kualifikimit të tyre.
- Sigurimi i kushteve për arsimimin e shtresave të marginalizuara.
- Zhvillimi sasior dhe cilësor i arsimit parashkollor,
- Matja e performances së sistemit arsimor nepermjet vleresimeve.
- Përfshirja në masën 82% (nga 80% që është aktualisht dhe 90% që synohet në vitin 2015) e tërheqjes së nxënësve në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe sigurimi i cilësive së mesimdhënies dhe mesimnxënies.
- Arsimi profesional dhe social-kulturor të përgjigje nevojave të tregut të punës në shërbime si hotelieri-turizem, mirëmbajtje riparim automjeteve, hidro-sanitare etj.
- Hartimi i listës së profesioneve dhe standarteve të tyre, krijimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve Profesionale.
- Futja e sistemit të kualifikimit parapunesimit për specialistët e arsimit profesional dhe social-kulturor.
- Të rritet numri i studentëve në tre ciklet e studimit në masën 15%, në raport me vitin paraardhës.
- Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) të plotësojnë me mirë nevojat e tyre akademike e kërkimore, nepermjet pjesëmarrjes projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Të përmirësohet skema dhe efektiviteti i mobilitetit të studentëve dhe i personelit akademik.
- Integrimi sa i shpejt i të diplomuarve në tregun vendas dhe global të punës, nepermjet reformës në kurrikul, ECTS, si edhe të dhenave shoqërore të Supplementit të Diplomes.
- Të rritet cilësia e studimeve Master dhe Doktorature, si edhe të krijohen kushtet për implementimin e studimeve Master në ato Shkollat të Larta ku garantohen standardet akademike.
- Njohja e të gjitha formave të studimit nepermjet procedurave standarde dhe institucionalizimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.
- Integrimi i Universiteteve dhe Institucioneve kërkimore shkencore në programet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit, si dhe në rrjetin e programeve evropiane të kërkimit shkencor.

- Implementimi i institucioneve dhe i biznesit privat në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit dhe zhvillimit
- Reformimi i sistemit të kërkimit shkencor, menaxhimi i programeve të kërkimit shkencor dhe integrimi i kërkimit shkencor me atë evropian, integrimi i institucioneve dhe biznesit privat në veprimtari kërkimore shkencore.

C.12.3 Programet e shpenzimeve te Ministrise

688. Ministria e Arsimit dhe Shkences ka 6 Programe

- Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi
- Arsimi Baze (perfshi parashkollorin)
- Arsimi i Mesem i Pergjithshem
- Arsimi i Mesem Profesional
- Arsimi Universitar
- Fonde per Shkencen

689. Sektori i Arsimit eshte nje sektor prioritar per Qeverine. Ministrise se Arsimit dhe Shkences i eshte akorduar nje buxhet ne vitin 2008 prej 37.27 miliarde leke qe perben 3.46% te PBB.

690. Ne vitin 2010, buxheti i kesaj Ministrie pritet qe te rritet ne terma nominale me 30.25% krahasuar me 2008 ne 48.5 miliarde leke.

01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

691. **Politika e ketij programi** konsiston ne përmirësimin e skemës së menaxhimit të sistemit arsimor, nëpërmjet menaxhimit me bazë performance dhe rritjes së kapaciteteve në të gjitha nivelet e shërbimit.

692. **Objektivat kryesore per vitin 2008:**

- Planifikimi dhe futja e sistemeve të menaxhimit me bazë performance në të gjitha institutet, qendrat dhe agjencitë që varen nga MASH.
- Zhvillimi i politikave të qarta për funksionet që MASH do të decentralizojë si dhe hartimi i udhëzimeve dhe akteve nënligjore përkatëse për DAR, ZA dhe shkollat lidhur me funksionet e decentralizuara.
- Zhvillimi i politikave të qarta për reformimin e sistemit të financimit dhe rritjen e kapaciteteve përkatëse në të gjitha nivelet.
- Miratimi dhe/ose amendimi i ligjeve dhe akteve nënligjore për të nxitur shkollat që të vjelin të ardhura nga shërbimet.
- Zhvillimi dhe diskutimi i modelit të financimit "për nxënës".

693. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2008:**

- 50 Auditime te institucioneve te sistemit arsimor; **Kosto per njesi:** 200 mije leke.
- 100 Drejtore Shkollash te trainuar; **Kosto per njesi:** 60 mije leke.
- institucione te vleresura nga inspektimi; **Kosto per njesi:** 175 mije leke.
- 100 punonjes te trajnuar ne fushen e finances dhe prokurimeve; **Kosto per njesi:** 130 mije leke.
- 8 Ambiente pune te rehabilituara; **Kosto per njesi:** 9.8 milione leke.
- 12 Pajisje elektronike te blera; **Kosto per njesi:** 250 mije leke.

694. **Objektivat kryesore per vitin 2009:**

- Shtrirja e zbatimit të sistemit të menaxhimit me bazë performance në nivel DAR-i.
- Zhvillimi i politikave të qarta për rritjen reale të autonomisë së shkollave dhe zbatimi i kësaj autonomie në të gjithë rrjetin e shkollave të mesme të vendit.
- Shtrirja e EMIS në DAR, ZA dhe institucionet e varësisë.
- Plotësimi me infrastrukturën kompjuterike dhe internet i të gjitha shkollave të vendit.
- Zbatimi i një sistemi të reformuar financimi në të gjitha institucionet e varësisë.

695. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:**

- 50 Auditime te institucioneve te sistemit arsimor; **Kosto per njesi:** 200 mije leke
- 160 Drejtore Shkollash te trainuar; **Kosto per njesi:** 75 mije leke
- institucione te vleresura nga inspektimi; **Kosto per njesi:** 175 mije leke
- 13 Ambiente pune te rehabilituara; **Kosto per njesi:** 6.5 milione leke
- 13 Pajisje per institucionet arsimore; **Kosto per njesi:** 769 mije leke
- 22 Pajisje elektronike te blera; **Kosto per njesi:** 500 mije leke
- 5 Institucione arsimore te lidhura me sistem LAN; **Kosto per njesi:** 2 milione leke

696. **Objektivat kryesore per vitin 2010:**

- Shtrirja e zbatimit të sistemit të menaxhimit me bazë performance në nivel ZA-je dhe planifikimi i shtrirjes edhe në nivel shkolle.
- Zbatimi i autonomisë edhe në shkollat e tjera të arsimit të detyruar.
- Shtrirja e EMIS në nivel shkolle.
- Zbatimi i sistemit të reformuar të financimit në nivel shkolle.
- Hartimi dhe zbatimi i statusit të mësuesit.
- Funksionimi i një sistemi trajnimi dhe kualifikimi të përshtatshëm dhe promotor të zhvillimit dhe rritjes së cilësisë së procesit mësimor.

697. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2010:**

- 50 Auditime te institucioneve te sistemit arsimor; **Kosto per njesi** 200 mije leke.
- 200 Drejtore Shkollash te trainuar; **Kosto per njesi:** 80 mije leke.
- Institucione te vleresura nga inspektimi; **Kosto per njesi:** 175 mije leke.
- 180 punonjes te trajnuar ne fushen e finances dhe prokurimeve; **Kosto per njesi:** 83.3 mije leke.
- 10 Ambiente pune te rehabilituara; **Kosto per njesi:** 8.1 milione leke.
- 10 Pajisje per institucionet arsimore; **Kosto per njesi:** 1 milione leke.
- 4 Institucione arsimore te lidhura me sistem LAN; **Kosto per njesi:** 2.5 milione leke.
- 10 Mjete transporti te blera; **Kosto per njesi:** 2.5 milione leke.

698. Buxheti i alokuar per kete program ne vitin 2008 eshte 931.1 milione leke. Propozohet qe tavanet per periudhen e PBA 2009-2010 te jene si me poshte:

- Viti 2009 1.04 miliarde leke (nje rritje prej 11.7% krahasuar me vitin 2008)
- Viti 2010 1.14 miliarde leke (nje rritje prej 10.1% krahasuar me vitin 2009)

09120 Arsimi Baze

699. Politika e ketij programi konsiston ne përmirësimin e kushteve të mësimdhënies e mësimnxënies si dhe sigurimi i kushteve të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës. Përmirësimi i kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe sigurimi i kushteve të barabarta për pjesëmarrje në arsimin parashkollor.

700. **Objektivat kryesore per vitin 2008:**

- Ndërtime të reja shkollore dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese, kryesisht në zonat urbane, dhe sigurimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve.
- Hartimi i kurrikulës së re (tekste) për klasën e V, dhe XI të arsimit të bazë. Përmirësimi i kurrikulave të gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze.
- Shtimi dhe përmirësimi i pajisjeve shkollore të reja dhe pajisje me laboratorike për shkencat natyrore si dhe mjete didaktike dhe kompjutera në masën 50%.
- Të pajisen 100% e numrit të nxënësve me tekste shkollore.
- Trajnimi i mësuesve në shërbim për kurrikulën e re të klasave IV dhe VIII. Trajnimi i mësuesve të lëndëve të veçanta në konvertimin e tyre në mësues shumë lëndësh për nivelin fillor, në masën 20%. Trajnimi i mësuesve të shkollave gjithëpërfshirëse, në masën 3%.(12 kopshte dhe 12 shkolla çdo vit)
- Rritja e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor duke arritur tërheqjen e 54% të grup moshës 3-6 vjeç
- Organizimi i vlerësimit kombëtar për klasën V të arsimit bazë

701. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2008:**

- 40 Kurikula te reja te hartuara; **Kosto per njesi:** 250 mije leke
- 115 Libra shkollore te publikuar; **Kosto per njesi:** 2.4 milione leke
- 495073 Nxënës që ndjekin Arsimin Bazë; **Kosto per njesi:** 33.3 mije leke
- 1000 Mesues te trajnuar; **Kosto per njesi:** 5 mije leke
- Ulja e numrit te nxenesve per klase ne qytetin e Tiranes; **Kosto per njesi:** 2.8 milione leke
- Përmirësimi i kushteve ne shkolla; **Kosto per njesi:** 1.6 milione leke
- Ndërtim shkolla te reja; **Kosto per njesi:** 3.5 milione leke
- Rikonstruksioni i shkollave ne shkalle vendi; **Kosto per njesi:** 1.3 milione leke
- Rritja e tërheqjes te femijve 3 deri 6 vjec ne arsimin parashkollor; **Kosto per njesi:** 6.1 milione leke
- 750 Kopshte dhe shkolla me kushte te përmirësuar; **Kosto per njesi:** 266.7 mije leke
- Dixhitalizimi i amzave; **Kosto per njesi:** 166.7 mije leke
- 200 Pajisje kompjuterike dhe mobileri per kabinete informatike; **Kosto per njesi:** 3.2 milione leke
- 40 shkolla qe furnizohen me laboratore; **Kosto per njesi:** 8.5 milione leke
- Krijimi i bibliotekave shkollore; **Kosto per njesi:** 266.7 mije leke.

702. **Objektivat kryesore per vitin 2009:**

- Përmirësimi i kurrikulës së arsimit të detyruar. Rishikimi i standarteve.
- Rehabilitime të shkollave ekzistuese dhe ndërtime të reja me fokus zonat urbane, dhe sigurimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve.
- Pajisja gjerësisht e shkollave të arsimit të detyrueshëm me mjete didaktike, kompjutera, lidhje me internet e pajisje laboratorike për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, në masën 70% .
- Të pajisen 100% e numrit të nxënësve me tekste shkollore.

- Trajnimi 100% i mësuesve në shërbim për kurrikulën e re të kasave V dhe IX. Trajnimi i mësuesve të lëndëve të veçanta në konvertimin e tyre në mësues shumë lëndësh për nivelin fillor, në masën 20%. Trajnimi i mësuesve të shkollave gjithëpërfshirëse, në masën 3%.(12 kopshte dhe 12 shkolla çdo vit).
- Rritja e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor duke arritur tërheqjen e 56% të grup moshës 3-6 vjeç.
- Organizimi i vlerësimeve kombëtare për provimevet e lirit.

703. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:**

- 37 Kurikula te reja te hartuara; **Kosto per njesi:** 378.4 mije leke
- 125 Libra shkollore te publikuar; **Kosto per njesi:** 2.2 milione leke
- 548167 Nxënës që ndjekin Arsimin Bazë; **Kosto per njesi:** 34.4 mije leke
- 1200 Mesues te trajnuar; **Kosto per njesi:** 8.8 mije leke
- Ndertim shkolla te reja; **Kosto per njesi:** 5.1 milione leke
- Rikonstruksioni i shkollave ne shkalle vendi; **Kosto per njesi:** 1.55 milione leke
- Rritja e terheqjes te femijve 3 deri 6 vjec ne arsimin parashkollor; **Kosto per njesi:** 3.5 milione leke
- 750 Kopshte dhe shkolla me kushte te permiresuara; **Kosto per njesi:** 266.7 milione leke
- 150 Pajisje kompjuterike dhe mobileri per kabinete informatike; **Kosto per njesi:** 2.5 milione leke
- 40 shkolla qe furnizohen me laboratore; **Kosto per njesi:** 8.5 milione leke
- Krijimi i bibliotekave shkollore; **Kosto per njesi:** 333 mije leke

704. **Objektivat kryesore per vitin 2010:**

- Rritja e pjesëmarrjes në Arsimin Parashkollor duke arritur tërheqjen e 59% të grup moshës 3-6 vjeç.
- Rehabilitime të shkollave ekzistuese dhe ndërtime të reja me fokus zonat urbane, duke përmirësuar kushtet e 30% të numrit total të nxënësve dhe sigurimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve.
- Pajisja gjerësisht e shkollave të arsimit të detyrueshëm me mjete didaktike e laboratorike, me kompjutera dhe lidhje interneti, për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, në masën 90%.
- Të pajisen 100% e numrit të nxënësve me tekste shkollorë
- Trajnimi i mësuesve të lëndëve të veçanta në konvertimin e tyre në mësues shumëlëndësh për klasën e V të nivelit fillor, në masën 20%. Trajnimi i mësuesve të shkollave gjithëpërfshirëse, në masën 3%.(12 kopshte dhe 12 shkolla çdo vit)
- Organizimi i vlerësimeve kombëtare për provimet e lirit

705. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2010:**

- 48 Kurikula te reja te hartuara; **Kosto per njesi:** 416.7 mije leke.
- 118 Libra shkollore te publikuar; **Kosto per njesi:** 2.5 milione leke.
- 544734 Nxënës që ndjekin Arsimin Bazë; **Kosto per njesi:** 40.2 mije leke.
- 48500 Nxeues te testuar ne arsimin baze; **Kosto per njesi:** 0.3 mije leke.
- 1200 Mesues te trajnuar; **Kosto per njesi:** 10 mije leke.
- Ndertim shkolla te reja; **Kosto per njesi:** 5.2 milione leke.
- Rikonstruksioni i shkollave ne shkalle vendi; **Kosto per njesi:** 3.2 milione leke.
- Rritja e cileise se mesimdhënies ne shkollat e arsimit 9-vjecar; **Kosto per njesi:** 4.5 milione leke
- Rritja e terheqjes te femijeve 3 deri 6 vjec ne arsimin parashkollor; **Kosto per njesi:** 3.9 milione leke.

- 738 Kopshte dhe shkolla me kushte te permiresuara; **Kosto per njesi:** 244 mije leke.
- 220 pajisje kompjuterike dhe mobileri per kabinete informatike; **Kosto per njesi:** 2.5 milione leke.
- Rehabilitim shkolla dhe furnizim me pajisje; **Kosto per njesi:** 4.8 milione leke.
- Krijimi i 300 bibliotekave shkollore; **Kosto per njesi:** 333 mije leke.

706. **Standartet e Politikës**

- Numri i teksteve/ nxënës, plotësimin 100% të nevojave.
- Numri i pajisjeve dhe mjeteve të domosdoshme didaktike, duke arritur 3 laboratorë / 1000 nxënës.
- Plotësimi i standartit 22 nxënës/mësues.
- Plotësimi i standartit 32 nxënës/klasë.
- Vlerësimet e arritjes sipas standardeve duke arritur masën e kalueshmërisë 95%.
- Numri i kompjuterave për nxënës (nje kompjuter per dy nxenes).

707. Buxheti i alokuar per kete program ne vitin 2008 eshte 21.21 miliarde leke. Propozohet qe tavanet per periudhen e PBA 2009-2010 te jene si me poshte:

- Viti 2009 24 miliarde leke (nje rritje prej 13.2% krahasuar me vitin 2008).
- Viti 2010 28 miliarde leke (nje rritje prej 17% krahasuar me vitin 2009).

09230 Arsimi i Mesem i Pergjithshem

708. **Politika e ketij programi** synon reformimin e arsimit te mesem te pergjithshem ne baze te arsimit te detyruar 9-vjeçar, rritjen graduale te terheqjes ne arsimin e mesem te pergjithshem e nxenesve qe perfundojne arsimin e detyruar.

709. **Objektivat kryesore per vitin 2008:**

- Terheqja ne arsimin e mesem e 82% te nxenesve qe mbarojne arsimin baze.
- Hartimi i planit te ri mesimor dhe programeve te reja vendore sipas strukturese se arsimit te mesem dhe arsimit 9-vjeçar.
- Ndertime dhe rehabilitime shkollash, me prioritet zonat urbane, duke ulur numrin e nxenesve qe mesojne ne kushte jonormale me 25% te numrit te pergjithshem, nepermjet ndertimit te 11 shkollave te mesme te pergjithshme dhe reabilitimit te 25% te shkollave.
- Paisja me laborator dhe mjete didaktike e 70% te shkollave
- Paisja me laborator te informatikes e 100% te shkollave dhe lidhja me internet.

710. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2008:**

- Rritja e terheqjes se nxenesve ne AMP; **Kosto per njesi:** 1.8 mije leke.
- Realizimi i programeve te trajnimit; **Kosto per njesi:** 586.9 mije leke.
- 78 Tekste te reja shkollore; **Kosto per njesi:** 551.3 mije leke.
- 65 Programe edukimi te realizuara; **Kosto per njesi:** 54 mije leke.
- Ulja e numrit te nxenesve ne klase; **Kosto per njesi:** 6.5 milione leke.
- Permiresimi i kushteve ne shkollat e ndertuara te reja dhe te rehabilitura; **Kosto per njesi:** 3.9 milione leke.
- 80 Kabinete informatike; **Kosto per njesi:** 225 mije leke.
- 100 Biblioteka shkollore; **Kosto per njesi:** 300 mije leke.

711. **Objektivat kryesore per vitin 2009:**

- Njohja ne masen 100% te mesuesve te shkolles se mesme te pergjithshme me kornizen e re kurrikulare, me programet dhe tekstet e reja te klases 10-te.
- Ndertimi i 14 shkollave te reja dhe rehabilitimi i 25% te shkollave ekzistuese.
- Pajisja e shkollave me mjete didaktike e laboratorike ne masen 80%.
- Permiresimi kurrikular i lendes se informatikes; pajisja e shkollave te mesme me laboratore per lenden e informatikes.
- Ndertimi i laboratoreve te dyte per informatiken ne masen 40% te shkollave te mesme.
- Permiresimi i kurrikules se gjuhes shqipe, permes planit, programit mesimor teksteve te reja e kualifikimit te mesueseve.
- Permiresimi i kurrikules se gjuhes angleze dhe trajnimi i mesueseve te gjuhes angleze.
- Ngritja e laboratoreve te gjuhes angleze ne shkollat me mbi 600 nxenes (30% e shkollave).

712. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:**

- Rritja e terheqjes se nxenesve ne AMP; **Kosto per njesi:** 3 mije leke.
- Realizimi i programeve te trajnimit; **Kosto per njesi:** 732 mije leke.
- 56 Tekste te reja shkollore; **Kosto per njesi:** 589 mije leke.
- 68 Programe edukimi te realizuara; **Kosto per njesi:** 58.8 mije leke.
- Ulja e numrit te nxenesve ne klase; **Kosto per njesi:** 4.8 milione leke.
- Permiresimi i kushteve ne shkollat e ndertuara te reja dhe te rehabilitura; **Kosto per njesi:** 4.5 milione leke.
- 80 Kabinete informatike; **Kosto per njesi:** 600 mije leke.
- 125 Biblioteka shkollore; **Kosto per njesi:** 400 mije leke.

713. **Objektivat kryesore per vitin 2010:**

- Terheqja ne arsimin e mesem te 86% te nxenesve qe mbarojne arsimin e detyrueshem.
- Hartimi dhe botimi 100% i teksteve per klasen e 11-te.
- Zbatimi i kurrikules se re ne klasen e 11-te.
- Trajnimi 100% i mesueseve qe zbatojne kurrikulen e re ne klasen e 10-te.
- Permiresimi i infrastruktures shkollore duke ulur ne nivelin 15% numrin i nxenesve qe mesojne ne kushte jo normale.
- Pajisja ne masen 100% e shkollave me mjete didaktike e laboratore.
- Futjen hap pas hapi ne procesin mesimor i teknologjise informative.

714. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2010:**

- Rritja e terheqjes se nxenesve ne AMP; **Kosto per njesi:** 4.7 mije leke.
- Realizimi i programeve te trajnimit; **Kosto per njesi:** 858 mije leke.
- 58 Tekste te reja shkollore; **Kosto per njesi:** 586 mije leke.
- Ulja e numrit te nxenesve ne klase; **Kosto per njesi:** 3.9 milione leke.
- Permiresimi i kushteve ne shkollat e ndertuara te reja dhe te rehabilitura; **Kosto per njesi:** 1.6 milione leke.
- 80 Kabinete informatike; **Kosto per njesi:** 795 mije leke.
- 125 Biblioteka shkollore; **Kosto per njesi:** 400 mije leke.

715. **Standartet e Politikës:**

- 86% e nxenesve qe mbarojne arsimin baze do te terhiqen ne arsimin e mesem ne fund te trevjecarit.
- Shkolla te ndertuara apo rehabilituara, duke mos kaluar standartin 32nxenes/klase.
- Te arrihet qe per 500 nxenes te jene 3 laboratore.
- Ne vitin 2010 te kete 30 nxenes/kompjuter,

716. Buxheti i alokuar per kete program ne vitin 2008 eshte 5.1 miliarde leke. Propozohet qe tavanet per periudhen e PBA 2009-2010 te jene si me poshte:

- Viti 2009 5.4 miliarde leke (nje rritje prej 5.9% krahasuar me vitin 2008)
- Viti 2010 6.2 miliarde leke (nje rritje prej 14.8% krahasuar me vitin 2009)

09240 Arsimi i Mesem Profesional717. **Politika e ketij programi** konsiston ne rritjen graduale te numrit te nxenesve qe studiojne ne kete lloj arsimimi, permes krijimit te mundesive te reja; zgjerimi i autonomise se shkollave dhe bashkepunimit me komunitetet; ngritja dhe fuqizimi i reparteve dhe kabineteve te reja; ndryshimi i struktures se arsimit profesional dhe social-kulturor; krijimi i mekanizmave institucionale per kualifikimin e personelit mesimdhenes dhe drejtues.718. **Objektivat kryesore per vitin 2008:**

